



"ALMEDICUS" ► Faqe 13-18

- Virusi i Nilit, rrezik edhe për Shqipërinë
- Dhimbja e mesit streçing i shpeshtë



**Amnistia**  
Projektligji, kush lirohet nga burgu për 100-vjetor

► Faqe 21



**Rasti "Xhakja"**  
Letra e kreut të Gjykatës, KLD neglizhoi shkeljet

► Faqe 19

# [SHQIPTARJA.com]

TELEVISIONI MË I RI INFORMATIV NË SHQIPËRI

A1 REPORT!  
origjina e lajmit...

LEKË 30 SHQIPTARJA.com + Suplementi ALMEDICUS

VITI II - NR. 241 E enjte, 11-10-2012

## ÇADRA IZOLOHET QE MBREME

# Dhjetëra uniforma blu te vendi i grevës, frikë për dhunë natën vonë "FLIJIM SI GJERGJI E LIRAKU" POLICIA RRETHON GREVISTET

Rrëfimi i shokëve: Fjalët e fundit të Bejkos para se t'i vinte flakën vetes. Berisha kërkon grupin sabotator dhe akuzon grevistët si kriminelë. Ndërkombëtarët: Duhet dialog. Trakte në Tiranë për Ndrecën

### Lajmi

Lirak Bejko, 47-vjeçari nga Skrapari, baba i dy vajzave, i ka vënë dje flakën vetes me benzinë në shenjë proteste ndaj heshtjes së qeverisë për kërkesat e tyre. Shokët e tij rrëfejnë se ai doli jashtë cadrës duke i thënë se do dilte nga greva, ndërsa janë tmerruar kur e kanë parë të mbuluar nga flakët.

### TIRANE

BRUNILDA GOROVELLI

Akti ekstrem që ka ndërmarrë dje Lirak Bejko, 47-vjeçari nga Skrapari, i cili iu bashkua grevës së urisë vetëm 4 ditë më parë, ka tmerruar edhe vetë grevistët. Si pasojë ai ka pësuar djegie në 50 për qind të trupit dhe është në gjendje shumë të rëndë. Ata na rrëfejnë, se ky veprim ka qenë fare i papritur për ... ► vijon në faqe 2-5



Gjergji Ndreca (foto A1Report)



Lirak Bejko (foto News24)

### BLOGI PERIFERI ► Faqe 9



Evropa, humnera e totalitaristëve

NGA ALBA MALLTEZI

### BLOGI JOGA DHE JU ► Faqe 19



Principet e praktikës së Jogës

NGA ANILDA NOCKA

### QENDRA ► Faqe 8



Xhami e re në qendër të Kavajës

### Koment



NGA FLUTURA AÇA

### Zjarri që (nuk) e shohim

Nuk mjaftuan as njëzet ditë sakrificë për njëzet qytetarë shqiptarë, ish-të përndjekur politikë, të shkurdin shpërfilljen tonë. Madje as akti i vetëfljimit të Gjergji Ndrecës e Lirak Bejkos. Pikërisht... ► vijon në faqe 8

### Koment



NGA AFRIM KRASNIQI

### Një BE për dy Shqipëri

Bashkimi Evropian ka refuzuar dy herë dhënien e statutit të vendit kandidat për Shqipërinë. Më 2010 përgjegjëse u bë problematika elektorale, më 2011 ishte mungesa e dialogut politik. Më 2012 pak gjë ka ndryshuar... ► vijon në faqe 10

## REKOMANDIMET E KE

# Shqipëria status me kushte, ku gabo

Ndër 12 prioritete u realizuan plotësisht vetëm dy. Reagimet në Bruksel dhe Tiranë

**LEXONI NË FAQEN 11**

### TIRANE

JAKIN MARENA

Komisioneri për Zgjerimin në Komisionin Evropian, deklaroi dje dhënien e rekomandimit për statusin e vendit kandidat për Shqipërinë, e cila... ► Faqe 6-7

**NERANXI**  
... gjithmonë një hap përpara...  
**Ushqime aziatike dhe meksikane**  
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 7, Yrshok Tiranë. Tel: 042 406 500; 042 406 501; Fax 042 406 502; e-mail: neranxi@neranxi.com; www.neranxi.com

Dhjetra programe bachelor dhe master në degë ekonomike dhe inxhinierike  
**UMT**  
UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA  
cel: 0696070111  
www.umt.edu.al



## Ministri Vangjel Tavo mbërrin me urgjencë në spital

Menjherë pas ngjarjes tragjike të Lirak Bejkos, ministri i Shëndetësisë, Vangjel Tavo, ka mbërritur në ambientet e reanimacionit të klinikës së Diegie-Plastikës në QSUT për të parë nga afër gjendjen shëndetësore të tij. Sipas Tavos gjendja e grevistit është shumë e rënduar, pasi bëhet fjalë për një djegie të gradës së tretë. "Unë jam këtu si mjek dhe

ministër Shëndetësie. Sipas informacioneve të para që mora nga mjekët, bëhet fjalë për një djegie të gradës së tretë. Pacienti ka dëmtime në masën 40-50 për qind, të përqendruara në krahë, kraharor dhe fytyrë. Sipas protokolleve mjekësore duhet të presim të paktën 72 orë. Shpresojmë dhe urojmë që gjendja të vijë drejt përmirësimit. Pacientit i është

ofruar një ndihmë e kualifikuar. Shërbimi po tregon gatishmëri maksimale, qoftë në medikamente qoftë në personel" - ka deklaruar që nga spitali Vangjel Tavo, Ministër i Shëndetësisë. Ai shprehet gjithashtu se ka parë edhe gjendjen shëndetësore të ish të burgosurit politik, që para dy ditësh tentoi të digte veten e tij, Gjergj Ndreca.

**RRËFIMI/** Ishin çaste të llahtarshme, nuk e kuptuam se ç'do bënte

# Djegia e Lirak Bejkos: Na tha se po linte grevën

Lutfi Kelmendi: Iku duke thënë mos u dorëzoni

■ ■ ■ TIRANE

BRUNILDA GOROVELLI

vijon nga faqja 1

...ta për faktin se Bejko, u ka thënë se po linte grevën, pasi me këtë shtet nuk mund të arrijë gjë. Ngjarja e rëndë ka ndodhur jashtë çadrës ku po zhvillohet greva e urisë në rrugën "Komuna e Parisit" rreth orës 12:50 minuta të mesditës, ndërsa ka pësuar djegie të forta edhe një tjetër grevist, Agim Kollçaku, i cili ka tentuar të shuajë trupin që digjet të Bejkos.

### RRËFIMI

Lutfi Kelmendi, ish i burgosur politik, i cili ndodhej në atë moment në çadrën ku po zhvillohet greva e urisë, na tregon dialogun e fundit me Lirakun si dhe momentin e tmerrit kur ai është përfshirë nga flakët të llahtarshme. "Nuk e prisim një gjë të tillë. Ai u çua, na dha dorën të gjithëve një nga një. Luti unë po iki më thotë, po e lë grevën, se me këta nuk fitohet. Dhe ne menduam se po largohet. Askërkujt nuk i shkoi ndërmend se do të bënte një gjë të tillë, pasi u dha dorën të gjithëve, jo vetëm mua. Askërkujt nuk i shkoi ndërmend se do ta bënte atë veprim, pasi unë s'do ta lejoja. Në momentin që ai u spërkat me benzinë, ne vrapuam, por ai kishte hedhur benzinë aq të fortë, ndoshta ishte benzol, sa u përpi menjherë nga flakët dhe ne nuk mundëm të bënim dot gjë. Ne të gjithë po shikonim TV, pasi donim të shikonim gruan e Gjergj Ndreces që ishte e ftuar në një emision dhe nuk e kuptuam fare që një gjë e tillë do të ndodhte. Liraku, shikon dhe qëndron pas televizorit, merr një shishe me benzinë, ia hedh vetes që nga koka dhe në moment i vë flakën. Pastaj u rreza brenda në çadrë i mbuluar nga flakët" - shprehet Lutfi Kelmendi, ish i burgosur politik. Sipas tij gjithçka ndodhi në një fraksion sekonde dhe nuk kishte mundësi veprimi. "Liraku është tip shumë impulsiv, ngjarja ndodhi në sekondë, aq sa



## Grushta Rusmajlit

Lirak Bejko, është bërë i njohur edhe disa kohë më parë, kur në fillim të muajit shkurt të këtij viti qëlloi me grushta në fytyrë deputetin e PD-së, Ilir Rusmalin, teksa po dilte nga parlamenti. Kjo pasi Rusmali kaloi indiferent para arkivolit të një ish të burgosur politik, që nuk kishte lekë ta varrosnin. Bejko, u arrestua nga forcat e komisarit nr.1, të cilët i vunë prangat edhe Gjergj Ndreces që kundërshtoi arrestimin e Bejkos. Ata u lanë të lirë pas marrjes së deklaramëve me shkrim

## Mjeku Ilir Nezha

# "Lirak Bejko më rëndë se Ndreca 5 ditë që të kalojë rrezikun"

Mjeku reanimator Ilir Nezha, ka deklaruar se gjendja shëndetësore e Lirak Bejkos është shumë e rënduar dhe në gjendje shoku. Ai është më rëndë se sa grevist tjetër Gjergj Ndreca. Sipas mjekut Nezha, djegia trupore është në masën 50% dhe konsiderohet djegie e gradës së tretë. Sipas tij pjesët që janë më të dëmtuara nga flakët janë gjymtyrët e poshtme dhe të sipërme si dhe një pjesë e fytyrës. Mjeku thekson se duhet ditë për të dhënë një përgjigje përfundimtare mbi jetën e tij. "Më të dëmtuara janë gjymtyrët e sipërme dhe ato të poshtme, si dhe një pjesë e fytyrës. Shpresojmë që pacienti të mos krijojë infeksion pasi ai do të rëndonte edhe më shumë gjendjen. Nuk mund

të themi se ai është jashtë rrezikut për jetën, pasi duhet të paktën deri në 5 ditë mjekim dhe kujdes shëndetësor" - thotë reanimatori Ilir Nezha. Ndërkohë që për gjendjen shëndetësore Agim



Lirak Bejko

edhe humbet mendjen, por i dhamë ndihmën si në të tjerët, ashtu edhe policia që gjendej këtu", - rrëfen më tej për "Shqiptarja.com" Lutfiu. Mënyra se si u vetëdij Liraku ishte shumë e shpejtë shprehet ai, ndryshe nga Gjergji që mund ta ndihmoje shumë më lehtë, rezultat i të cilit janë edhe plagët e rënda që ka marrë ish i burgosur politik. "Është shumë guximtar... iku duke thënë "mos u dorëzoni". Ka marrë djegie të rënda 50% - tregon, jo patron-ditje Lutfi Kelmendi, nga Fushë-Kruja. E gjithë ngjarja e ndodhur brenda një çasti dhe para syve të tyre i ka tronditur shumë grevistët që e kanë për-

jetuar me tmerr këtë moment të llahtarshëm. "Nuk tregohet me fjalë ajo që na panë sytë. Lutfiu ishte përfshirë nga flakët dhe 7u rreza për tokë në çadrë. Ndërsa ne tentonim ta shuanim, policë dhe ne të grevës së bashku, ishte thuajse pamundur të shuhej. Ndoshta por shkakt të benzinës së fortë, por edhe sepse në atë moment po frynte erë. Madje edhe njëri nga grevistët e tjerë, duke tentuar të shuante flakët që kishin përfshirë trupin e Lirakut, pësoi djegie të forta edhe vetë. Që

të dy përfunduan në spital. Me siguri është një pamje që nuk mund të harrohet lehtë", - na rrëfen më tej Lutfiu, i cili nuk i është bashkuar grevës së urisë, por që shkon çdo ditë tek çadra si një person që i përket kësaj klase. Pas aktit ekstrem të Lirakut, policët nuk të lënë t'i afrosh çadrës, por një tjetër ish i burgosur politik na afrohet dhe na thotë se ndonëse janë të pangrënë, ata janë të vendosur t'i japin fund kësaj qeverie. "Është rasti i dytë. Jemi në ditën e 19-të dhe jemi

Kollçakut, grevistit tjetër të djegur duke shuar flakët e Bejkos, mjeku shpjegon se ai është në gjendje shumë të mirë shëndetësore dhe mund të dalë nga pavijoni. Gjithashtu edhe për grevistin, i cili u vetëdij para dy ditësh shprehet se gjendja e tij është përmirësuar, por është e nevojshëm dhe e domosdoshëm qëndrimi i tij akoma në ambientet spitalore. "Gjergj Ndreca është jashtë rrezikut për jetën dhe në gjendje të stabilizuar, por do të vazhdojë të qëndrojë ende në repartin e reanimacionit pasi ka nevojë për trajtim" - vazhdon të na shpjegojë mjeku. Të tre grevistët ndodhën në Spitalin Qendror Universitar "Nënë Tereza", pranë urgjencës plastike dhe janë nën trajtimin mjekësor.

të pangrënë, le të vijë ekspertët e globit dhe të shohin nëse ka një miligram bukë tek ne. Gjergji e ka pas një javë tek koka karburatin. Jemi të vendosur t'i japim fund kësaj qeverie", - shprehet Petrit Horjeti.

### NJË DITË MË PARË

Një ditë para veprimit ekstrem të vetëfljimit, paraditen e së martës, Lirak Bejko është shprehur për "Shqiptarja.com" se e ka marrë vendimin për t'u futur në grevën e urisë më shumë nga ana morale, dhe më pas vjen ana financiare. "Ana morale na ka bërë që të futemi në grevë urie deri në vetëfljim, për të pasqyruar të vërtetën dhe posh-

Në foto: Lirak Bejko në momentin kur i vuri flakën vetës afër çadrës së grevës (foto News24)



### ? PYETJE PERGJIGJE

- **Përse ish të burgosurit kanë hyrë në grevë urie?** Ish të burgosurit kanë hyrë në grevë urie, pasi pretendojnë se një pjesë e madhe ose nuk kanë marrë asnjë qindarkë nga lekët e dëmshpërblimit për ditët e burgut që kanë bërë në kohën e monizmit, ose kanë marrë një këst shumë minimal krahasuar me shumën totale që duhet të marrin.
- **Po qeveria a ka reaguar për këtë?** Ministria e Financave, nëpërmjet një dalje publike ka deklaruar se të gjithë ata që janë futur në këtë grevë urie, por edhe një pjesë e madhe e kësaj kategorie, duke filluar nga janari i vitit 2009 deri më 30 shtator 2012, kanë marrë në total 5.6 miliardë lekë. Madje Ministria e Financave ka përmendur me emra konkretë edhe disa prej grevistëve dhe shumën e parave që kanë marrë.
- **Sa është masa e dëmshpërblimit për çdo ditë burgu?** Masa e dëmshpërblimit llogaritet në 18.6 dollarë në ditë.
- **Po grevistët çfarë pretendojnë?** "Ata kanë deklaruar se pjesa më e madhe e tyre u janë miratuar dosjet, por nuk kanë marrë asnjë qindarkë.

tërimin e Sali Berishës për shtrësinë tonë" - është shprehur Lirak Bejko, paraditen e së martës - është shprehur për "Shqiptarja.com" Lirak Bejko, para aktit të vetëfljimit.



**Vetëfljimi, të përndjekurit, trakte për Gjergj Ndrecën**



Pas aktit të vetëfljimit të ndërmarrë katër ditë më parë, Gjergj Ndrecë është kthyer në një hero për të gjithë klasën e të burgosurve dhe të përndjekurve politikë. Gjatë ditës së djeshme, në rrugën "Myslym Shyri" në Tiranë, janë ngjitur trakte për "Shën Gjergji Ndrecë", ku paralajmërojnë se ata

do të jenë të pranishëm çdo ditë, në orën 09:30 minuta të mëngjesit, te çadra ku po zhvillohet greva e urisë, në hyrje të rrugës "Komuna e Parisit". Në foton e këtij 'trakti' duket një shenjtor me shpatë në dorë mbi një kalë dhe poshtë në tokë një kuçedër në grahmat e fundit. Alegoria e këtij "trakti" qëndron në faktin se Shën

Gjergji është një festë pagane që festohet në një pjesë të madhe të vendit tonë dhe simbolizon ilijen e dimrit dhe ardhjen e verës. Edhe fotoja ilustruese, është një figurë fetare mjaft e njohur, ku shenjtori Gjergj duket duke luftuar me kuçedrën, të cilën e ka mundur dhe tashmë ajo përpillet nën këmbët e kalit të tij.

**Deklarata e fortë**

**Grevistët: Akuzojmë Bujar Nishanin si vrasësin e shokut tonë Lirak Bejko**

■ ■ ■ TIRANE

Pas ngjarjes së mesditës së djeshme, ku Lirak Bejko, i vuri flakën vetes te çadra ku po zhvillohet greva e urisë së ish të burgosurve politikë, grevistët kanë akuzuar publikisht Presidentin e Republikës, Bujar Nishanin, si vrasësin e Lirak Bejkos. "Sërisht sot rreth orës 12 të drekës, një nga shokët tanë Lirak Bejko, shkoi drejt vetëfljimit të plotë në ambientet e grevës. Në ndodhinë tragjike, ne grevistët e grevës së urisë në ditën e 19, për rastin e ndodhur deklarim se: dëshpërimi i tejkajshëm dhe zhgënjimi i vazhdueshëm po na çon drejt një vetëfljimit të sigurtë dhe të pae-vitueshëm; deklarimi i papërgjegjshëm i Presidentit të Republikës e rëndoi edhe më shumë gjendjen tonë psikologjike duke sh-



Grevistët gjatë një deklaratë

kuatuar viktimën e radhës si dhe e denoncojmë atë publikisht atë si vrasës të shokut tonë Lirak Bejko; qëndrimi i tij ndaj grevës s'është reflektio vasalitit banal dhe nën-

shtrimin e ulët ndaj kryepushtetarit të këtij vendi, duke treguar edhe njëherë se mbetet shërbëtor i bindur i tij; është akoma i mundshëm reflektimi dinjitos i asaj pjesë të qeverisjes e cila deri tani ka dëshmuar maturi politike në trajtimin e kësaj çështjeje që duhet të bëhet nga sot e tutje, detyrim moral e shpirtëror për të gjithë ata që duan drejtësinë e ligjin, e duan këtë vend me institucione në funksion të demokracisë dhe jo të pushtetit të individëve të caktuar; duke theksuar edhe njëherë se greva jonë është e motivuar vetëm për shkaqe ekonomike, u bëjmë thirrje edhe njëherë, kujtdo qoftë, se nuk do të pranojmë kurrë që greva jonë të përdoret politikisht. Greqa do të vazhdojë deri në plotësimin e kërkesave tona të ligjshme dhe të drejta", - ka përfunduar deklarata e grevistëve.



**INTERVISTA/ Bashkëshortja e Bejkos rrëfen momentet kur e mori vesh lajmin**

**Gruaja: Pse u sakrifikua Liraku**

Edlira Bejko: Nuk më kishte thënë gjë për veprimin, por ishte një gjë e paralajmëruar. Arsyet janë ekonomike, nga 30 mln lekë të vjetra kemi marrë vetëm 3 milionë lekë. Shteti po i shkel me këmbë

■ ■ ■ TIRANE

ESMERALDA KETA

Edlira Bejko, gruaja e Lirak Bejkos ka mbërritur e traumatizuar në spital. Në një intervistë të shkurtër për "Shqiptarja.com" ajo na thotë e çoroditur se e ka marrë vesh për aktin ekstrem të bashkëshortit të saj, ndërsa po blinte një ilaç për të bijën që e kishte me temperaturë, ndërsa shton se ky veprim ishte paralajmëruar me kohë, nga të gjithë grevistët. Ajo kërkon mirëkuptim nga ana e medias në këtë moment të vështirë për të dhe familjen e saj dhe sqaron se nuk është në gjendje të flasë për këtë që i ka ndodhur bashkëshortit. Ndërsa tregon se dy vajzat e sëmurë me grip ua ka lënë të afërmit të saj. Në momentet e para që ne kontaktuam me të, Edlira, nuk kishte mundur ende të shikonte me sytë e saj gjendjen në të cilën ndodhej bashkëshorti, pasi mjekët ende nuk i kishin dhënë leje të futeshin, ndërsa më vonë, pasi mjekët kanë përfunduar procedurat e tyre mjekësore me të vetëdjegurin Lirak Bejko, ajo është lejuar që t'i qëndrojë të shoqit tek koka.



**Deklarata**

Bashkëshortja e Lirakut, Edlira, na rrëfen se ishte në pazar duke blerë ilaç për vajzat që i ka me temperaturë kur një komshie i ka treguar se ka parë në ndodhur me të shoqin e saj

Në foto: Bashkëshortja e Lirak Bejkos, Edlira

**Zonja Edlira, a ju kishte thënë bashkëshorti juaj kur u fut në grevën e urisë se mund të ndërmerre një hap të tillë?**

Nuk ishte nevoja që të ma thoshte, këtë e kanë thënë të gjithë grevistët, që nga dita e parë kur janë futur në këtë grevë. Kjo ishte një gjë e paralajmëruar.

**Zonja Edlira, ju a mund të na thoni se cilat janë arsyet e këtij akti ekstrem që ndërmerri bashkëshorti juaj?**

Arsyet e këtij veprimi, jo vetëm të bashkëshortit tim, por të të gjithë grevistëve, pak a shumë dihet. Arsyet që e kanë çuar drejt këtij akti janë kryesisht ekonomike. Ne jemi 4 veta në familje dhe asnjëri prej nesh nuk punon, jetojmë me vështirësi të madhe. Po përveç arsyes ekonomike, ky akt është ndërmarrë edhe sepse i është shkelur dinjiteti, jo vetëm atij por të gjithë atyre që janë në atë grevë urie. Dhe një arsye shumë e madhe që i çoi drejt këtij akti ekstrem është indifere-

enca shumë, shumë e madhe e këtij shteti demokratik.

**Po ju nuk punoni? Po leket e dëmshpërblimit i keni marrë?**

Jo ne jemi të dy të papunë. Dhe në fakt kemi marrë një kësht lekësh. I takonin të merrte 30 milionë lekë të vjetra, por kemi marrë vetëm një kësht prej 3 mijë lekësh në vitin 2009.

**Ku ishit ju kur e morët vesh lajmin?**

Kisha dalë në pazar të blija

**KËRKESAT E GREVISTËVE**

- Të zhdëmtohen totalisht të burgosurit politikë duke iu logaritur inflacionin 30% që është vlerësuar leku që nga 2007 deri më tani
- Të merren në mbrojtje sociale ata që kanë mbetur vetëm
- Të strehohen të burgosurit politikë
- Ata që janë gjallë t'u akordohet pension sipas ligjit 7703 dt 11.5.93, nëni 5 me procedurë të përshpejtuar dhe të drejtpërdrejtë
- Trajtimi mjekësor të jetë falas për të burgosurit politikë
- Ligjërimi në Parlament i konventës 12 i Këshillit të Evropës për hapjen e dosjeve
- Të hapen dosjet e vonuara të të burgosurve politikë që nuk kanë marrë asnjë kësht si dhe të hiqen nga parlamenti nenet e terrorit për të burgosurit politikë që janë dënuar në revoltën e Spaçit 73 dhe 84
- Të punësohen të burgosurit politikë

diçka për vajzat se i kam me temperaturë, i kam me grip që të dyja. Më tha një komshie ime që e kishte parë në televizor atë që kishte ndodhur me Lirakun.

**Po tani ku i keni lënë vajzat?**

I kam lënë me të afërmit e mi. Madje dhe në këtë moment unë nuk jam në gjendje

as të flas, pasi akoma nuk e kam parë bashkëshortin tim. Ju lutem më mirëkuptoni, unë po pres të afërmit e mi që t'i qëndrojmë te koka Lirakut. Atë çfarë kisha për të thënë ua thashë mediave, por edhe nuk ka shumë nevojë të flas sepse grevistët ka ditë që e paralajmërojnë atë që do të ndodhë me ta.



## Ambasadori Arvizu: Brenda natës të gjendet një zgjidhje për grevën

Ambasadori amerikan në Tiranë, Aleksandër Arvizu, ka reaguuar gjatë mbrëmjes së djeshme pas aktit të vetëdijegjes së ish-të burgosurit të dytë, Lirak Bejko. Ambasadori amerikan Arvizu ka deklaruar se ndihet i shqetësuar dhe i trishtuar për këtë akt ekstrem të grevistit të dytë. "Jam i shqetësuar për atë që ndodhi me

vetëflijimin. Ishte një gjë e trishtuar," - tha Arvizu. Ai deklaroi se do mendohet se si mund të dilet nga situata, pasi sipas tij, nuk mund të vazhdohet në këtë mënyrë dhe duhet doemos që të vijë zgjidhja me e mirë e mundshme për të gjithë. "Do të mendojmë për një reagim gjatë gjithë natës se si mund të dilet nga kjo gjendje", - ka deklaruar Arvizu, duke

komentuar ngjarjen e djeshme ku një tjetër grevist i vuri flakën vetes. Ambasadori amerikan i ka vizituar grevistët e urisë edhe disa ditë më parë në çadrën të "Komuna e Parisit" ku ata janë ngjuar prej 19 ditësh dhe kërkojnë që qeveria të mbajë premtimin dhe t'u japë dëmshpërblimin për vitet e burgut që ata kanë bërë

Uniformat blu spastrojnë çadrën për shishe benzine

# Grevistët: Do flijohemi me grafik, policia i izolon

Skënder Tufa: Pa zgjidhje, s'dalim të gjallë nga çadra

■ ■ ■ TIRANE  
ESMERALDA KETA

## Lajmi

Pas incidentit të rëndë të ndodhur dje me grevistin Lirak Bejko, uniformat blu kanë rrethuar çadrën ku po zhvillohet greva e urisë së ish të burgosurve politikë. Por megjithatë, kjo nuk i ka penguar grevistët që të deklarojnë se nëse nuk vjen një zgjidhje për kërkesat e tyre, ata do të vetëflijohen dhe nuk do të dalin të gjallë nga çadra e harrësës.

Grevistët e mbetur në çadrën e grevës së urisë, të misur 19 ditë më parë, deklarojnë se për ta nuk ka kthim prapa. Madje, sipas Skënder Tufës, koordinatori i grevës së urisë së ish të burgosurve politikë, por që nuk ndodhet vetë në grevë urie, pa ardhur një zgjidhje konkrete, asnjë nga grevistët e ngjuar në çadrën të "Komuna e Parisit" nuk do të dalë i gjallë prej saj. Ai nuk ngurron të deklarojë sërish se vetëflijimet do të vazhdojnë,

pavarësisht se sa policë do ta ruajnë çadrën. Tufa thotë nëse ata nuk do të kenë mundësi të vetëflijohen këtu, për shkak të masave të rrepta që ka marrë policia, do ta bëjnë diku tjetër, pasi janë të vendosur në kërkesat e tyre. "Këtu është bërë një plan dhe

është një listë. Njerëzit këtu do të fillojnë të vetëflijohen. Nesër, pasnesër do të fillojnë të zbatojnë planin. Le të vënë 20 policë këtu, 30 policë, le të vënë sa të duan policë, ata do ta bëjnë atë që kanë për ta bërë. Nëse nuk vjen zgjidhja, një nga një do t'i dëgjojmë kur

njeri të digjet këtu e njëri të digjet në një vend tjetër. Ata grevistë që janë aty nuk do të dalin të gjallë", - deklaroi koordinatori i grevës Skënder Tufa, duke treguar nga çadra ku po zhvillohet greva e urisë. Ai na shpjegon se aktualisht në çadrën ku po zhvillohet greva e urisë janë të ngjuar 11 persona, për të cilët gazeta po publikon edhe skedën personale të secilit prej tyre. Ata janë Ramazan Spahiu, Afrim Biturku, Kujtim Kaziu, Arif Beu, Xhemal Zhuri, Besim Valteri, Lavdosh Begu, Gëzim Kullolli, Fatmir Lame, Llazi Koçi dhe Fatmir Lloshi. Ndërsa më tej ai na shpjegon se 3 të tjerë ndodhen në repartin

e djegieve, 4 grevistë janë ende nëpër pavijone të tjera të spitaleve dhe njëri është në gjendje të rëndë për shkak të problemeve serioze që ka pasur me zemrën. I kontaktuar nga "Shqiptarja.com", Skënder Tufa, thotë se gjatë orëve të vona të mbrëmjes së djeshme, ata kanë pasur jo vetëm presione të ndryshme, por madje kanë vënë re edhe shtim të uniformave blu që kanë blinduar çadrën ku 11 ish të burgosur politikë po zhvillojnë grevën e tyre të urisë. "Këtu situata sa vjen e bëhet më e tensionuar. Kemi presione nga të gjitha anët. Këta kanë blinduar në qdo cep çadrën, janë nga 20-30 policë



Në foto: Ish-të përndjekurit politik në grevën e urisë

gjithshje. Por ajo që kemi vënë re ne është se me largimin e medias kanë filluar e vijnë edhe persona që kanë grada të larta në polici, madje kemi dyshimet tona se gjatë mesnates mund të ketë edhe ndërhyrje me forcë brenda në çadrë. Por ne jemi të vendosur dhe nuk trembe mi ndaj asgjëje", - thotë për "Shqiptarja.com", koordinatori i grevës së urisë, Skënder Tufa.



### GUXIM KULLOLLI, 9.5 vite burg

Mosha: 52 vjeç, 1960  
Arsyeja e burgosjes: Propagandë, tentativë për arratisje  
Vendi i dënimit: Spaç 1981 dhe në Qafë Bari 1982 deri më 1990  
Qyteti: Elbasani  
Familja: i martuar, me katër fëmijë, i papunë  
Liruar: 1991



### LAVDOSH BEGU, 15 vite burg

Mosha: 81 vjeç, 31 tetor 1931  
Vendi i dënimit: Spaç, Qafë Bari  
Arsyeja e dënimit: shpërndarje traktesh  
Qyteti: Vlora  
Familja: i pamartuar  
Liruar: 1989



### BESIM VALTERI, 6 vite burg

Mosha: 51 vjeç, 10 janar 1961  
Vendi i dënimit: Spaç 1985, Burrel 1988, Kosovë të Lushnjës 1990  
Arsyeja e dënimit: tentativë arratisje, propagandë  
Qyteti: Nga Burreli, banues në Tiranë  
Familja: i martuar, me katër fëmijë, i papunë, i pastrehë  
Liruar: në vitin 1991



### AFRIM BITURKU, 5 vite

Mosha: 46 vjeç, 1968  
Vendi i dënimit: Spaç 13 qershor 1986, Sarandë nga 17 qershor - 7 gusht 1990  
Arsyeja e dënimit: Përgatitje për tentativë arratisje  
Qyteti: Kavajë  
Familja: i divorcuar, me 1 vajzë  
Liruar: 7 gusht 1990



### ARIF BEU, 5 vite burg

Mosha: 54 vjeç, 1957  
Vendi i dënimit: Spaç nga 1975-1979  
Arsyeja e dënimit: Arratisje jashtë  
Qyteti: Kavajë  
Familja: i martuar, tre fëmijë, i papunë  
Liruar: Me 1991



### RAMAZAN SPAHIU, 12 vite burg

Mosha: 71 vjeç, 1941  
Arsyeja e dënimit: Propagandë, ndiqej nga lufta e klasave për persekutim  
Vendi i dënimit: 1974 në biruçin Peshkopi, Spaç 1975-1982, në Qafë Bari 1984  
Qyteti: Burrel  
Familja: i divorcuar, pa pension  
Liruar: më 1991



### VLLASI KOÇI, 13 vite burg

Mosha: 56 vjeç, 8 janar 1956  
Vendi i dënimit: Spaç 1983, Qafë Bari 1984, Burrel 1991  
Arsyeja e dënimit: tentativë arratisje, propagandë  
Qyteti: Vlora  
Familja: i martuar me dy fëmijë, i papunë  
Liruar: në vitin 1991



### KUJTIM KAZIU, 10 vite burg

Mosha: 55 vjeç, 1958  
Vendi i dënimit: Spaç 10 vjet 1984, Bulqizë e re 3 vjet 1987, Kampin e Tëmovës, kompleksin Dinamo, Bardhoren e Kavajës, Kavalencën e Durrësit 1990  
Arsyeja e dënimit: propagandë, për ikje nga ushtria  
Qyteti: Fushë Krujë  
Familja: i martuar, me tre fëmijë, i papunë  
Liruar: 31 mars 1990



### XHEMAL ZHURI, 13 vite burg

Mosha: 54 vjeç, 11 qershor 1959  
Vendi i dënimit: Spaç dhe Qafë Barë 1978  
Arsyeja e dënimit: Agjitacion e propagandë  
Qyteti: Tirana  
Familja: i divorcuar, me tre fëmijë  
Liruar: në vitin 1991



### FATMIR LLOSHI, 7 vite burg

Mosha: 48 vjeç, 1965  
Vendi i dënimit: Kukës më 1983, Spaç më 1985, Burrel më 1989, Sarandë më 1990  
Arsyeja e dënimit: Propagandë, përgatitje për arratisje, sabotim ekonomik  
Qyteti: vendlindja Kukës, vendbanimi Tiranë  
Familja: i martuar, me tre fëmijë, i papunë  
Liruar: 1990

## SHTETRRETHIMI

Ndonëse çadra ku po zhvillohet prej 19 ditësh greva e ish të burgosurve politikë, ruhej nga uniformat blu, pas aktit ekstrem të grevistit tjetër Lirak Bejko gjatë ditës së djeshme, ajo është blinduar nga dhjetëra policë. Blutë kanë për detyrë që të ruajnë jetën e grevistëve dhe të mos i lejojnë ata që të ndërmarrin hapa ekstremë të vetëflijimit, siç bëjnë më parë dy shokët e tyre Gjergj Ndreca dhe Lirak Bejko. Ka qenë kjo arsyeja që pas veprimit në mesditë të grevistit Bejko, forca të shumta të policisë kanë bërë edhe spastrimin e çadrës duke kërkuar për shishe benzine dhe hequr ata për të shmanjur përsëritjen e një tjetër veprimi ekstrem vetëflijimi. Pas veprimit ekstrem të Bejkos një kordon uniformash blu kanë rrethuar çadrën, në të cilën tashmë është e pamundur të futesh dhe të kontaktosh me grevistët. Shtettrrethimi që policia i ka bërë çadrës ku po zhvillohet greva e urisë vlen edhe për mediat, që duke filluar nga mesdita e djeshme, e kanë pasur shumë të vështirë të kontaktojnë dhe bisedojnë drejt për së drejti me grevistët, dhe e vetmja mundësi komunikimi me ta kanë mbetur numrat e telefonit.



**FRESHH, protestë në mbështetje të grevistëve të urisë**

Forumi i Rinisë Eurosocialiste të Shqipërisë dhe i është bashkuar grevës së urisë së ish-të përndjekurve politikë në një protestë me qindra të rinj. Ashtu sikurse e ka mbështetur dhe më parë, këtë herë i gjithë FRESHH ka dalë në mbështetje të kauzës së grevistëve. Nën moton "FRESHH është me ju", qindra të rinj të forumit kanë qëndruar për 2 orë në mbështetje të grevistëve. "Të dënuar nga

sistemi komunist, të poshtëruar, burgosur dhe të internuar me një mijë e një vuajtje, ata mbeten ende një shtresë e shoqërisë që Qeveria nuk i ka dhënë dinjitetin që meriton. Ministria e Financave me një dalje të turpshme një ditë më parë ka mashtuar hapur të gjithë opinionin publik duke thënë se kjo shtresë është dëmshpërblyer, por e kundërta është e vërtetë", u deklaruar nga të rintë socialistë. Sipas tyre, vetëflijimi i

ish-të burgosurve politikë në mënyrë demonstrative tregon qartë se s'ka më asnjë mënyrë tjetër për të kërkuar atë që i takon. "Indiferenca e skajshme e Kryeministrit, Presidentit e Kryetares së Parlamentit është për të ardhur turp! Madje ata shkojnë akoma më larg, duke u tallur me këtë grevë vetëflijuese", shprehet FRESHH. Duke paralajmëruar mbështetje deri në fund të grevës.



Kryeministri: Greva, politike. Kriminal zjarrvënësi i Ndrecës

# Berisha: Benzinë tek greva, s'do ndodhë më

"Rasti i dytë shkelje. Grevistët duhet të mbrohen"

**TIRANE**  
JAKIN MARENA



Kryeministri Sali Berisha

**BE:**

"Delegacioni i BE-së shpreh keqardhjen dhe shqetësimin në vijim të incidenteve serioze që ndodhën më 8 dhe 10 tetor gjatë grevës së urisë nga një grup ish-të burgosurish dhe ish-të burgosurish politikë.

jëherë fjalën të rasti i vetëdijegjes që Gjergj Ndrecës. "Në rastin e parë ai që i vuri zjarrin shokut të tij, ai që e futi në shtëpinë e vet, e futi për ta djegur dhe është një kriminel që duhet të përballlet me të gjithë forcën e ligjit", paralajmëroi Berisha. Njëherësh ai ka dhënë përgjigje dhe në lidhje me kujdesin që ka treguar për të përndjekurit politikë që në fillimet e PD, teksa ka nënvizuar se që nga dita e themelimit, kjo parti në axhendën e saj më të parë ka qënë lirimi i të burgosurve politikë si dhe mbështetja e tyre me pasardhjes në pushtet.

**Historiku**

## Greva e urisë, nga Valiasi, Arbnori, PS tek ish-të burgosurit

**TIRANE**



Pjetër Arbnori

Nuk është se Shqipëria nuk ka pasur greva urie dhe grevistë urie me sfond të theksuar politik dhe ekonomik. Pavarësisht se nuk ka shumë detaje për publikun, kanë qënë të zakonshme grevat e urisë nëpër burgjet famëkeqe të diktaturës në Spaç, Burrel, Qafë Bari ku jo pak kanë shkuar në zgrip të vdekjes, ndërkohë që pjesa tjetër për shkak të revoltës janë pushkatuar. Por në mënyrë publike, grevat e urisë kanë filluar me atë të minatorëve të Valiasit në vitin 90-91 që sollën rrëzimin e simboleve komuniste, dhe që një pjesë e të cilëve vijojnë dhe sot, por në barrikadën e kundërt t'i rikthehen herë pas herë kësaj greve, siç është rasti i ish-grevistit të Valiasit Xibri asokohe kundër Nanos, sot është kundër Berishës. Kështu, ish-të përndjekurit politikë të kryesuar nga Kurt Kola në vitin 1994 hynë masivisht në të gjithë vendin në grevë urie për dëmshpërblymim moral dhe financiar, duke marrë nga pushteti i atëherëshëm i PD dhe ndëshkimin fizik, por dhe atë moral, pasi u cilësuan ish-spiunë të Sigurimit dhe komunistë. Kësaj greve iu bashkua

asokohe lideri i dhjetorit, i ndjeri Azem Hajdari, gjë që solli përjashtimin e tij nga strukturat e PD. Ndërkohë që kjo grevë u pasua nga ajo e kandidatëve për deputetë të PS pas zgjedhjeve të 26 majit, për tu pasuar më pas me grevën e Memisë, Hajdarit dhe Minarollit, të PD këta, para TVSH për terrin informativ e për t'u vënë vullën më grevën e "mandelës" shqiptar, Pjetër Arbnori. Më pas u vijua me grevën e urisë së deputetëve socialistë për hapjen e kutive dhe tashmë me grevën e ish-të burgosurve politikë, një cikël i gjatë grevash që për hir të së vërtetës, përjashtuar grevën e Arbnorit, i cili mori për PD atë që kërkonte, barazi në TVSH, asnjë grevë tjetër nuk arriti qëllimin, pasi hasnin në veshin e shurdhër të qeverisë përballë.

Kryeministri Berisha ka deklaruar para media se në rastin vetëdijegjes me benzinë ditën e djeshme të ish-të burgosurit grevist urie, Lirak Bejko ka patur shkelje nga ana e forcave të ruajtjes së rendit, pasi nuk kanë mundur të pengojnë futjen e benzinës bashkë me shishet e ujit. Duke krijuar në këtë mënyrë dhe idenë e një komploti kompromentues nga ana e organeve të caktuara për mbrojtjen e grevistëve, që sipas tij do të mbajnë përgjegjësitë e tyre. Ndërkohë që ai ka deklaruar se një gjë e tillë nuk do të ndodhë më, zjarrvënësin e Gjergj Ndrecës kreu i qeverisë e ka cilësuar një kriminel i cili do të marrë dënimin e merituar. "Duhet të dini një gjë, jo një i vuajtur në burgjet e diktaturës por lëndimi, vuajtja e sakrificave e çdo njeriu më lëndon thellë. Dhe gjëja e parë që kam bërë i kam kërkuar ministrit të Shëndetësisë që të tregojë kujdesin maksimal për

të. Dua ta them këtu se sigurimi i grevës e kushtete të saj në rastin e dytë ka qënë jo në lartësinë e duhur, personat përgjegjës duhet të nxjerrin përgjegjësitë", deklaroi Berisha para mediaeve. Por ka shkuar më tej teksa ka evidentuar faktin se duhet të parandalohet futja e

shisheve me benzinë të grevistët e urisë, të cilët kishin paralajmëruar vetëflijimin. "Në rastin e dytë, duhej të mbroheshin grevistët. Ka pasur një shkelje sepse është futur benzinë bashkë me ujë, çka nuk duhet të ndodhë më", nënvizoi kreu i qeverisë. Duke e kaluar men-

**KABINETI SALAJ**

**APARATE DËGJIMI**

Mbi bazën e një experience 10-vjecare në fushën e vendosjes së APARATEVE të dëgjimit kabineti "SALAJ" ju vjen në ndihmë në këto shërbime:

- Matjen e dëgjimit (audiogram) FALAS.
- Marrjen e masës si dhe përgatitjen e saj (silikon apo akrilike) në kohë rekord brënda dy ditëve.
- Përcaktimin dhe programimin e aparatit sipas shkallës së dëgjimit.
- Shërbime (servis) për të gjitha tipet e aparateve.

**Adresa: Pallatet e Shallvareve, Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit, përballë Taiwan Nd. 24, Shk. 4, Ap.5 - Tiranë**  
**Tel: +355 4 2262 304 / Mob: 068 23 800 95**  
**E-mail: info@salajakustik.com**  
**Website: www.salajakustik.com**

## Sami Repishti Shoqëria shqiptare po tregon dobësi

Një nga disidentët më të njohur të regjimit komunist në Shqipëri, prof. Sami Repishti, që jeton në SHBA, ka kritikuar dje ashpër presidentin e Republikës, kryeministrin, kryetaren e Kuvendit dhe Ministrinë e Financave për qëndrimin që kanë mbajtur ndaj grevës së ish të persekutuarve politikë. "Pushteti nuk po dëgjon sepse nuk kupton heshhtjen e randë të kriminit që bahet ndaj ish të burgosurve, ish të persekutuarve. Presidenti bani një deklaratë jo dinjitoze dhe thotë se duhet një dialog, por unë nuk mund të përfshihem. Kush mund të përfshihet në qoftë se presidenti

nuk mund të përfshihet? Kryeministri heshet sepse nuk ka ç'të thotë përveç sharjeve. Kryetarja e Parlamentit ka la duart si Ponc Pilati, "unë nuk kam gjë për të thanë" thotë, edhe vjen nga familje e persekutuarve. Të gjithë ata që kanë sakrifikuar për Shqipërinë janë për t'u respektuar jo vetëm tani, por edhe nga gjeneracionet e ardhshme, sepse kështu ndërtohet shoqëria, kështu ndërtohet kompaktësia e një kombi. Shoqnia shqiptare po tregon dobësinë e saj morale për mendimin tim, ajo mban një heshhtje, një heshhtje që vret, ajo tregon një indiferencë që ofendon.



### Nishani:

Pasi i vlerësoi rekomandimet e mbetura, plotësisht të arritshme, Presidenti shprehu bindjen se klasa politike shqiptare dhe të gjithë aktorët e përfshirë do të përmbushin këto rekomandime.



### Berisha:

"Komisioni kërkon që të votohen 3 ligje. Angazhohem të bëj çdo gjë që është e mundur brenda parimeve të një sistemi demokratik e ato ligje të votohen që javën që vjen. Jam tepër i vendosur".



### Rama:

"Shqipëria kalon me kushte provimin e vjeshtës! KE vlerëson lart kontributin e opozitës për statusin e kandidatit. Pas fitores 2013 do jlojmë procesin e integritit, hapin faqe të re".

Komisioneri për Zgjerimin Fyle dorëzon rekomandimin e KE

# Shqipëria me status të kushtëzuar, ku dështoi

Nga 12 prioritetet, u realizuan plotësisht vetëm dy

## Lajmi

**Komisioneri për Zgjerimin në Komisionin Evropian, deklaroi dje dhënien e rekomandimit për statusin e vendit kandidat për Shqipërinë, e cila ka afat deri në dhjetor për të plotësuar 4 kushtet. Nga 12 prioritetet, Shqipëria plotësoi vetëm dy.**

■ ■ ■ TIRANE

JAKIN MARENA

Shqipërisë i jepet statusi i vendit kandidat në BE vetëm nëse plotëson reformat në drejtësi, miraton pr/ligjin për Gjykatën e Lartë, reformën në administratë, reformën parlamentare dhe përforcon luftën kundër korrupsionit e krimit të organizuar. Këto janë kushtet që Komisioni Evropian i ka vënë Shqipërisë për të plotësuar deri në muajin dhjetor, kur rekomandimi i KE shkon në tryezën e Këshillit të BE, dhe vendet anëtare duhet të marrin një vendim përfundimtar nëse Shqipëria i ka plotësuar ato. Ndërkohë që në total nga 12 rekomandimet, janë realizuar vetëm dy prej tyre plotësisht, reforma zgjedhore dhe zgjedhja e Avokatit të

Presidentit në mënyrë të njëanshme me votat e mazhorancës dhe pa përfshirjen e opozitës, ndonëse kushtetuese, solli një ngadalësim të dialogut që u reflektua në ngadalësimin e reformave. Nga ana tjetër është kërkuar në mënyrë eksplicite që të zbardhet ngjarja e 21 janarit dhe autorët të vihen para drejtësië. Ndërsa në fund pasi ka renditur realizimet dhe mosrealizimet e kushteve, këto të fundit në shumicë, Fyle ka dhënë dhe vendimin përfundimtar të rekomandimit të KE. "Shqipëria ka bërë progres të rëndësishëm vitin e kaluar sa i përket marrëveshjes ndërpartiake dhe ka përmbushur një sërë reformash në prioritetet kyçe. Në këtë kuadër KE rekomandon t'i japë Shqipërisë statusin kandidat me kushtet që të përfundojnë reformat dhe reformën parlamentare", deklaroi dje Fyle në komisionin e Jashtëm të PE, teksa ka dorëzuar dhe rekomandimin për dhënien e statusit. Ku Shqipëria ka si afat për përmbushjen e kushteve të reja të vëna deri në fund të dhjetorit të këtij viti. Njëherësh në

progres raport është nënvizuar se Shqipëria ka bërë progres të moderuar në përmirësimin e aftësisë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, në veçanti në fushat e konkurrencës, taksave, statistikave, drejtësisë, lirisë e sigurisë, edukimit dhe

kulturës dhe unionin e doganave. Por progresi ka qenë i kufizuar në fusha të tjera si liria e lëvizjes së punëtorëve, prokurimet publike, e drejta e autorit, siguria ushqimore, peshkimi, energjia, ambienti dhe ndryshimet klimatike.



Bujar Nishani me Ettore Sequi

## KUSHTET

- Miratimi i reformës parlamentare
- Miratimi i Ligjit për Gjykatën e Lartë
- Miratimi i Ligjit për Shërbimin Civil
- Lufta kundër krimit dhe korrupsionit

REALIZIMI DHE MOSREALIZIMI I 12 PRIORITETEVE TË KOMISIONIT EVROPIAN	
<b>I POSHTË</b>	<b>FUNKSIONIMI I PARLAMENTIT</b> <b>S'është realizuar</b> (Reforma parlamentare nuk është miratuar, ngërcj tek votimi i fshehtë në Kuvend dhe koha e balancuar për mazhorancën e opozitën në Kuvend)
<b>LARTË</b>	<b>MIRATIMI I LIGJEVE ME 3/5</b> <b>Realizuar pjesërisht</b> (Ligji për Gjykatën e Lartë dhe për Shërbimin Civil nuk janë miratuar)
<b>I POSHTË</b>	<b>ZGJEDHJEN E AVOKATIT TË POPULLIT DHE SIGURIMI NJË SEANCE TË RREGULLT DËGJIMI E VOTIMI PËR KANDIDATURAT E PRESIDENTIT PËR GJYKATËN KUSHTETUESE DHE GJYKATËN E LARTË</b> <b>Pjesërisht</b> (Nuk është garantuar seanca degjimore për kandidaturat për Gjykatën Kushtetuese e Gjykatën e Lartë. Jo kandidatura politike)
<b>LARTË</b>	<b>REALIZIMI I REFORMËS ZGJEDHORE</b> <b>Realizuar</b>
<b>LARTË</b>	<b>ZGJEDHJE SIPAS STANDARDEVE EVROPIANE DHE NDRËKOMBËTARE</b> <b>Pritet</b>
<b>I POSHTË</b>	<b>DEPOLITIZIMI I ADMINISTRATËS PUBLIKE</b> <b>S'është realizuar</b> (Problem emërimet politike, nxjerrja jashtë funksionit e Këshillit Civil, mosmarrja parasysh e vendimeve të tij, pushimet nga puna për efekt të respektimit të marrëveshjeve me aleatët, marrja në punë me kontratë të përkozhme)
<b>I POSHTË</b>	<b>TË FORCOHET SHTETI I SË DREJTËS, TË RRIETET PAVARËSIA E GJYQËSORIT</b> <b>S'është realizuar</b> (Nuk ka një ligj për Gjykatën Kushtetuese, dhënia e kompetencave Ministrisë së Drejtësisë në kurriz të Prokurorisë së Përgjithshme, drafte të miratuara nga Ministria e Drejtësisë, por të paraqitura. Miratimi i strategjisë për drejtësinë, i pamjaftueshëm)
<b>I POSHTË</b>	<b>REGJISTËR ME TË DHËNA BINDËSE PËR LUFTËN NDAJ KORRUPSIONIT</b> <b>S'është realizuar</b> (Nuk është zbatuar strategjia antikorruption, pavarësisht akuzave dhe dërgimit në organet e drejtësisë, ende nuk ka zyrtarë të lartë të dënuar. Ligji për kufizimin e imunitetit që kërkon ndryshime kushtetuese nuk është miratuar)
<b>I POSHTË</b>	<b>TË FORCOHET LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR</b> <b>S'është realizuar</b> (nuk është zbatuar strategjia kundër krimit, vendi akoma burim trafiku e tranziti për lëndët narkotike. Nivel i lartë krimi)
<b>I POSHTË</b>	<b>TË ZGJIDHET PROBLEMI I PRONAVE</b> <b>S'është realizuar</b> (Nuk është realizuar e drejta e kthimit dhe kompensimit të pronave për ish-pronarët. Jo vetëm që s'ka konsultime me Gjykatën e Strasburgut, por s'janë zbatuar as vendimet e Strasburgut. Ka penalizime)
<b>I POSHTË</b>	<b>HAPA PËR TË MBROJTUR TË DREJTAT E NJERIUT, TË GRAVE, FËMIJËVE DHE ROMËVE</b> <b>Pjesërisht të realizuara</b> (Ka përpjekje të Avokatit të Popullit, por romët mbeten të diskriminuar, të pashkolluar dhe objekt trafikimi. Është bërë hap pozitiv për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të fëmijëve)
<b>I POSHTË</b>	<b>TË PËRMIRËSOHEN KUSHTET NË QELITË E PARABURGIMIT DHE NË BURGJE</b> <b>Pjesërisht të realizuara</b> (Ka progres në trajtimin e minoriteteve dhe ndarjen e tyre në qelita e paraburgimit, por mungesa e stafëve të përgatitura dhe kryesisht mbipopullimet për shkak të mungësës së investimeve sjellin shqetësime)

This section also monitors compliance with international obligations, regional cooperation and good neighbourly relations with enlargement countries and Member States.

It analyses fulfilment of the 2010 Opinion's key priorities in particular.

### 2.1. Democracy and the rule of law

The ruling majority and opposition reached a political agreement in November 2011 which marked the end of the political stalemate stemming from the 2009 parliamentary elections. This agreement established a plan and timetable for carrying out electoral reform, for improving the parliament's rules of procedure and for adopting all pending laws requiring reinforced majority.

The ruling majority and opposition remained generally committed to the key political reforms stemming from this agreement and political dialogue has improved considerably ever since. The process of working on the implementation of the 12 key priorities has, overall, been an inclusive one. Yet there were short periods of confrontational rhetoric between government, opposition and other state institutions, notably in relation to investigations into the events of 21 January 2011 and to the nomination by parliament of a member of the High Council of Justice. Since November 2011, significant progress has been made by adopting pending reinforced majority laws, appointing an Ombudsman, adopting amendments to the electoral code, and towards revising parliamentary rules of procedure. This created a climate of cross-

The presidential elections in June 2012 were conducted in line with the Constitutional process surrounding them did not build on the positive cross-party dialog in November. Yet, constructive dialogue resumed shortly thereafter as demons by the completion of electoral reform, a key element of the November political a

### Parliament

From November 2011, following the political agreement, dialogue and rhetoric in the parliament improved significantly, and a more constructive atmosphere was noted, in particular during committee and plenary meetings. This allowed progress in a number of areas.



**Meta:**

"Raporti i KE ishte një sukses për vendin. Statusi, një arritje e vonuar por një akt historik. Duhet të vijojë me përbushjen e 3 kushteve. Apeloj të mos vonohemi më tej për marrjen e statusit".



**SHBA:**

"Ambasada mirëpret Raportin që rekomandon miratimin e statusit kandidat për Shqipërinë me kusht përbushjen e reformave të tjera kyçe. Dëshmi e politikave konstruktive të ndjekura nga partitë politike".



**Uollfarth:**

"Përpjekjet e përbashkëta të vijueshme nga të gjitha kampet politike mund ta çojnë vendin përpara, në të mirë të të gjithë qytetarëve shqiptarë. OSBE vijon të ofrojë mbështetje në proces".

Komisioneri për Zgjerimin në KE: Votimet, një test thelbësor

# Fyle dhe Sequi: Zgjedhjet 2013 kusht për negociatat

Ambasadori: Kushtet e zgjedhjet, të arritshme

TIRANE

JAKIN MARENA

Pas rekomandimit të kushtëzuar për statusin, që lidhet me votimin e disa ligjeve, për prioritetet e mbetura që fokusohen më shumë tek zbatimi, vlerësohet se janë bërë disa hapa, ndërsa plotësimi i tyre përfshirë zgjedhjet e vitit 2013, do kushtëzojë çeljen e negociatave për anëtarësim. "Një fokus i veçantë kërkohet për: zhvillimin e zgjedhjeve në përputhje me standartet europiane dhe ndërkombëtare; përfortimin e pavarësisë, efikasitetit e llogaridhënies së institucioneve gjyqësore, përpjekjet e vendosura në luftën kundër korrupsionit dhe kimit të organizuar, përfshirë hetimet proaktive dhe ndjekjen penale, masat efektive për forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe politikave anti-diskriminim, dhe zbatimin e së drejtës së pronës", saktësoi Fyle, duke dhënë në mënyrë të përmblodhur tërë kushtet e vëna për Shqipërinë deri në çeljen e negociatave, ku ptohet nëse në dhjetor të këtij viti Këshilli i Ministrave të BE vendos dhënie e statusit për Shqipërinë. "Zhvillimi i suksesshëm i zgjedhjeve parlamentare të vitit 2013 do jetë një test thelbësor për angazhimin ndërpartiak e reformën e re zgjedhore e një parakusht për çfarëdolloj rekomandimi për çeljen e negociatave. Dialogu i qëndrueshëm politik e vijimi i përpjekjeve në të gjitha fushat e mbuluara nga prioritetet kyçe do të mbetet thelbësor për zbatimin e reformave dhe garantimin e të ardhmes europiane të Shqipërisë", nënvizoi komisioneri. Por për komisionerin Fyle fakti se nëse Shqipëria do të marrë statusin në dhjetor, varet nga vetë ajo.



Stefan Fyle


ratimi i këtyre ligjeve, reformave. Besoj që mund të arrihet reformat me dëshirë dhe vullnet për dialog, me frymë kompromisi me

respekt të ndërsjelltë dhe të kuptuarit se cili është interesi i vendit dhe të ardhmen që për mua është integrimi europian", ka deklaruar Sequi. Edhe ambasadori i BE në Shqipëri, si komisioneri Fyle e ka vënë theksin tek zgjedhjet e vitit të ardhshëm. Sipas Sequi, krahas klimës së mirë politike që ka karakterizuar këtë kohë një nga parakushtet që Shqipërisë t'i çelen negociatat për në BE, janë edhe zgjedhjet e vitit 2013 në të cilat duhet të sundojë ligji dhe shteti i së drejtës. Sipas tij, Shqipëria do ta marrë plotësisht statusin në dhjetor me tu përbushur reforma në gjyqësor, ajo për administratën publike e rishikimi i rregullores së Kuvendit.

Shpjegimi

Pas status nuk ka negociata

Ambasadori i BE-së, Ettore Sequi deklaroi dje se korrektesitë në zgjedhjet e vitit 2013, do të jenë kushtet paraprake për të hapur më pas negociatat për në BE. Po çfarë diference ka mes statusit të vendit kandidat, për të cilin dje Brukseli dha një "OK" të kushtëzuar, dhe që Shqipëria mund ta marrë në dhjetor dhe negociatave me BE, për të cilat foli Sequi? Ndryshimi është i thjeshtë. I ashtuquajtur status është kushti për të filluar negociatat, të cilat duhet të mbyllet, pas disa vitesh, me hyrjen e plotë të vendit si anëtare e BE. Pa status nuk mund të ketë as negociata. Me status mund të nisë negociatimi, por me kushtin që zgjedhjet 2013 të jenë të lira dhe të drejta. Nëse zgjedhjet do të bëhen në mënyrë pak transparente, statusi i marrë dje nuk ka asnjë vlerë.



ation, but the  
gave launched  
rated notably  
greement.

Kafe në Bllok

Harmonia në Kuvend për statusin e kandidatit



Kur duheshin vetëm pak orë për të dalë lajmi që vendi ynë mundi të fitonte të drejtën për marrjen e statusit të vendit kandidat për në Bashkimin Europian, një frymë e fortë harmonie ndihet mes deputetëve të opozitës dhe mazhorancës në Kuvend. Edhe pse dje në punimet e Kuvendit u mbajtën vetëm tre komisione parlamentare, gjithë bisedat e tyre ishin të koncentruara te progresi i raportit të KiE. Duket se çështje të tilla që kanë interesin e përbashkët në politikë mbledhin opozitarët dhe mazhoritarët edhe në ambientet e kafeneve në zonën e Bllokut. Menjëherë pas punimeve të Kuvendit deputetët nuk kanë nguruar të qërasin njëri-tjetrin për hapin që hodhi vendi ynë drejt familjes europiane.

AMBASADORI SEQUI

Ambasadori i BE Sequi i ka dorëzuar kryeministrit Berisha, Presidentit Nishani, kryeparlamentares Topalli, Ministrit të Jashtëm Panariti dhe sot kreut të PS, Rama progres raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë. Ambasadori i BE në ceremoninë e dorëzimit ka kërkuar nga Shqipëria që të përbushë kushtet e kërkuara nga Komisioni, të cilat do t'u adresohen Këshillit të Evropës në muajin dhjetor, kur Këshilli i Ministrave të BE do të marrë në analizë realizimin e reformave dhe do të vendosë për dhënie e statusit të vendit kandidat. "Besoj që këto reforma janë afër përfundimit, rëndësi ka mi-



A1 REPORT!

NJOFTIM

Televizioni "A1Report" kërkon korrespondentë dhe kameramanë për të përfortuar rrjetin e gazetarëve në të gjitha qytetet e vendit. Kudo që ti jeton, jashtë Tiranë dhe veçanërisht në qytetet:

- DURRES
- SHKODER
- VLORE
- KUKES
- LEZHE
- LAÇ
- GJIROKASTER
- POGRADEC

Dëshiron të punosh si gazetar?

na shkruaj në adresën: staf.a1report@hotmail.com



## Qendra e qytetit

# Xhami e re në qendër të Kavajës

Elvis Rroshi: Qendra e qytetit do të ketë një fytyrë të re, që do t'u përgjigjet zhvillimeve duke ndërthurur traditën me modernen. Do jetë një konkurs i hapur, ku qytetarët do të thonë fjalën e fundit

### Lajmi

Një xhami e re, një shëtitore e re, një qendër pedonale e po ashtu dyqane të rikonstruara të sahatit të Kavajës. Këto janë disa nga elementët që bashkia e Kavajës ka shpallur për projektin e ri të qendrës së qytetit një konkurs që do të përfundojë në 31 dhjetor

### KAVAJË

Shumë shpejt bashkia e Kavajës do të hapë konkursin që do të ndryshojë pamjen e sheshit kryesor të qytetit.

"Pikësëpari, ajo do të jetë një zonë tërësisht pedonale. Njerëzit mund të dalin lirshëm, të shikojnë qendrën e qytetit, të qëndrojnë në kafene, lulishte, shatërvan, mund t'i rikthehen shëtitjeve me këmbë. Qendra është planifikuar të bëhet me

kalldrëm tradicional. Pamja e qendrës së Kavajës, do të ketë një fytyrë të re, që t'i përgjigjet nevojave të kohës, sa tradicionale, aq edhe moderne" tha dje për shqiptarja.com, kreu i Bashkisë së Kavajës, Elvis Rroshi.

Ajo që të bie në sy në projektin e kërkuar nga Bashkia Kavajë ka të bëjë me xhaminë e re. Bashkia në projektin e shpallur, ku kërkon që të marrin pjesë firma të mëdha projektuese për të dhënë idetë e tyre, te xhamia ekzistuese kërkon të ndërtojë



Rruga hyrese e re, e mbjelle me palma ne hyrje te Kavajes. (Lart), kreu i bashkise Elvis Rroshi

një tërësisht të re, e po ashtu, në sinkron të plotë me ndërtimin e xhamisë së re (ajo që është ndërtuar aktualisht është përfunduar në vitin 1904) të bëhet edhe rikonstruksioni i të gjitha dyqaneve që janë rreth kullës së sahatit.

Në zyrën e urbanistikës së Bashkisë së Kavajës, ka ditë që

punohet me mënyrën sesi administrata e re e kësaj bashkie planifikon të bëjë qendrën e qytetit. Reabilitimi i gjithë zonës së qendrës përfshin një sipërfaqe prej 2.5 hektarësh. Do të ndërhyhet sipas tyre në lulishten kryesore, "duke e kthyer atë në një vlerë të shtuar të qendrës së qytetit, në shërbim të qytetarëve të

Kavajës" të thonë ekspertët në zyrën e urbanistikës. Po ashtu, sheshi kryesor parashikohet të jetë i shtrirë në mënyrë gjatësore nga gjimnazi "A.Moisiu" deri te rruga "Jurgen Trade".

"Qendra do të jetë pedonale për të pasur akses sa më të gjerë nga të gjithë qytetarët. Përpara xhamisë do të parashikohet

edhe një shesh për falje" thonë në zyrën e urbanistikës.

Në këtë mënyrë, Bashkia e Kavajës ka shpallur konkursin për "Projekt-idenë e Rikonstruksionit të qendrës së qytetit të Kavajës" që konsiston në paraqitjen e një planimetrije të funksionimit të qendrës dhe objekteve që mendohet të ndërtohen në të (shatërvanë, lulishte rruge etj), paraqitje tredimensionale, dhe idetë e zhvillimit afatmesdhë afatgjatë të funksionimit të qendrës. Madje, duke dashur që të ketë sa më shumë projekte të cilat do të kalojnë në filtrin e një konkursi të hapur, në debat me publikun, bashkia ka vendosur që të gjithë të interesuarit të kontaktojnë në infokavaj@yaho.com dhe të gjitha dokumentet mund të dërgojnë pranë institucionit deri në 31 dhjetor 2012.

### Analiza

## Zjarri që (nuk) e shohim

nga FLUTURA AÇKA

vijon nga faja 1

...sot, kur fanfarat do të lajmërojnë festën e fitoreve tona të përgjigjes së të vakët, "gëzim" tonë e përtym një zjarr, të cilin, ose nuk e shohim, ose bëjmë sikur nuk e shohim, ose bëjmë sikur nuk ka lidhje me ne. Sigurisht zëri i të ngjuarve të grevës së urisë sot, në atë çadër që na kujton turpin tonë të indiferentizimit, do të vaktet nga tam-lamet e propagandës së Integritimit, por nuk ia shlyen dot kësaj Shqipërie të lodhur njollën e këtij çnderimi publik të demokracisë së saj. Mijafton ai zjarr, i komentuar ndonjëherë edhe me cinizëm, në që qytetare, si shkirimtare të solidarizohem me një kauzë të tillë qytetare, edhe pse jam kundër ndërmarrjeve dhe sakrificave të tilla ekstreme. Pavarësisht motivimit politik, apolitik, ekonomik e përtejekonomik i grevës, besoj se ka vend për t'u marrë seriozisht me ta dhe kërkesat e tyre.

E kam ndjekur gjithë këto ditë me një shqetësim njerëzor e qytetar fatin e atij grupi të vogël (por që padyshim përfaqëson një grup të madh) të ish-të dënuarve të ndërjegjes, mes tyre skenën e djegies së Gjergj Ndreçës e Lirak Bejkos, zjarr i cili nuk besoj se ka lënë ndonjë shqiptar, në thellim e tij si qytetar, pa e prekur. Kur këtë shqetësim e shpreh me disa miq të mi, me të cilët demokracia është treguar tejet "bujare", m'u hodhën në fytyrë mburset e më shkollën në mendje duke i mbrojtur "bukëshkelësit" e grevës, disa miq të tjerë, për të cilët demokracia nënkupton barazi para së drejtës dhe ligjit, ngjarja ishte bregosëse.

E ndërmest mes këtij kaosi gjykimesh të kundërta dhe njoftimesh mediatake (një pale ekstreme madje e cilësonte gënjeshhtar, hipokrit dhe të marrë Gjergj Ndreçën, falë që do të skruqin çdo gazetar të përgjegjshëm, veç shërbëtorëve të tillë shqiptarë të politikës), besova se të paktën, një njeri i vetëm si Presidenti i Republikës, do të dinte të ngrihej mbi këtë gjithnjë bëmash e fjalësh, dhe si qytetar të ndalej dhe të vizitonte

dhe të kërkonte zgjidhje për qytetarët e vet. Qoftë, edhe një i vetëm, qofshin edhe pesëmbëdhjetë qytetarë, për një shtet të paanshëm raportit me të drejtën e jetës dhe të drejtën qytetare, është një përgjegjësi e madhe. Nëse një presidenti të tillë, nuk i bën përshtypje të digjen dy qytetarë të tij, për çfarëdo arsye qoftë, e drejta e tij për të qenë president i këtyre qytetarëve, shtegton.

Por zhgënjimi nga fjalët e presidentit, ishte më e rëndë nga ç'e mendoja. Dhe, pavarësisht respektit personal që kam për figurën e tij (si më e buta mes asaj katrahure që na u servir në teatrin presidencial disa muaj më parë), ai mbetet një figurë politike, dhe demonstroi përkundër bindjes dhe shpresës sonë, se është një figurë politike. Por kjo është një zgjedhje e tij, dhe përgjegjësi e tij përtej asaj politike, është edhe historike.

Por të ndalem të çështja në fjalë, te greva e urisë, te Gjergj Ndreca e Lirak Bejko dhe motivimi politik me të cilën u përligj shpërfillja e plotë e pushtetit ndaj tyre. Shqetësimi im, si një qytetare e paangazhuar politikisht, është thjesht shqetësim qytetar, që nuk mund ta pranjojë që një zjarr si i Gjergj Ndreçës e Lirak Bejkos të jetë kryelajm në të gjithë botën, që Shqipëria të jetë sërish vend i zjarreve kaçaqe, ngaç që nuk ka mendje të qeta që të ulen e ta zgjidhin, që Tirana jonë është ende vend shatoreshë e sofrash, ngaç që nuk ka tryezë për t'u ulur, sepse ata që duhet të ulen në të dy anët e saj, nuk janë palë që duhet të bashkëpunojnë, por armiq të betuar.

A është në fakt greva e urisë së këtij grupi ish-të burgosur politikë, grevë politike?

Një ish-të burgosur politik si Gjergj Ndreca, Lirak Bejkos dhe kolegeve të tij të grevës, nuk besoj se ka ndonjë politikë që mund t'i marrë e t'i bëjë pjesë të saj. Nëse duhet të akuzohen për ndonjë anë politike të tyre, është pikërisht dedikimi i tyre ndaj së djathtës për gati dy dekada, me të drejtën e tyre për të qenë pjesë e ndryshimit të madh politik. Përtej kësaj të vërtete të qartë, pati mes tyre edhe nga ata që u bënë palë me politikën majtas e djathtas për përfitime personale, duke e minuar kauzën e tyre të drejtë, ose duke e penguar atë për t'u realizuar plotësisht, deri në ditën e përbaljes

me ngjarjet e fundit. Nëse opozita e përdor, apo e keqpërdor këtë grevë urie, qoftë edhe nën petkun e të drejtave të njeriut, si pjesë të kauzës së vet, nëse partitë e reja politike gjenden këto ditë pranë këtyre njerëzve, qoftë edhe për kapital politik, kjo nuk arsyë që shteti (që është skajmërisht politik dhe s'duhet të jetë politik para qytetarit të thjeshtë) t'i braktisë dhe të mos gjejë vend për të folur dhe negociuar, aq më keq t'i fyejë e t'i poshtërojë.

Personalisht, nëse opozita e sotme (e cila kur ka qenë në pushtet e ka injoruar totalisht këtë shtresë) e ka parë të udhës ta përfshijë në programin e vet edhe raportin me ish-të përndjekurit politikë, e shoh si një hap pozitiv, si një prirje për t'u ndarë nga e shkuara e saj kriminale në raport me këtë shtresë. Në nuk mund të gjykojmë dhe akuzojmë grevistët dhe grevën e tyre si grevë politike, kur ekspozitë të opozitës, të asaj opozite politike me të cilës pozita punon çdo ditë për t'i bërë me dije Evropës bëmat tona (shpesh sa për sy e faqe), i takojnë edhe interesohen për ta. Opozita është në të drejtën e saj të kërkojë shpjegime nga Ministria e Drejtësisë, nga Ministria e Financave, të kërkojë që çështja e ish-të përndjekurve politikë të diskutohet në Parlamentin shqiptar, por nuk është kurrësi në nderin e opozitës të lërë nga një tyrxhemet në çadrat për të monitoruar kush hyn e kush del në to (siç më ndodhi të shihja kur personalisht e vizitova grevën) dhe as është në nderin e shtetit-politik që për shkak të pranisë së tyrxhemit apo vizitave dhe solidarizimeve të të papërgjeshmëve, t'i braktisë qytetarët e vet.

Por le t'i quajmë të mirëqena akuzat e sulmet se kjo grevë urie është një grevë politike. A mundet një grevë e pesëmbëdhjetë vetëve qartësisht të varfër, të jetë aq agresive sa të çojnë skalonet politike? Sot e gjithë ditën: Jo. A mundet një grup i tillë që kanë vaujat në burgjet e diktaturës të pranojnë të përdoren nga një palë që ende nuk është pastruar tërësisht nga ish-ekspozitët kriminalë që janë në përbërje të saj ende? A mundet të jenë të qetë ish-të burgosurit politikë kur zërit të tyre nuk u jepet akses i plotë në disa ekrane të njohur për shërbimin e tyre të devotshëm ndaj qeverisë

(qeverive), dhe në të njëjtën kohë i lihet hapësirë pafund të derdhë ende grafmën e saj prej kufome e veje e diktaturitë dhe pinjollët e diktaturës? Përse nuk u bë deri tani asnjë përpjekje nga mazhoranca në pushtet për t'u neutralizuar i ashtuquajturit sens 'politik' i grevës?

Fundja, mes dy kampeve politike, mazhoranca i ka të gjitha mundësitë, edhe të drejtën, të themi, historike, të bëjë marrëveshje dhe të ulet me ish-të përndjekurit politikë. Përpara se të mendojnë për t'i asfaltuar gjarpërimet e rrugëve të fshatrave rrotull Tiranës deri te vilat e tyre, mund të mendojnë për vitet e jetës që u kanë mbetur këtyre njerëzve të shkatërruar nga diktatura, përpara se të mendojnë legalizimet dhe lejet e ndërtimeve nëpër tokave të okupuara pa kurrfarë kritere anembanë Shqipërisë së militantëve të tyre (majtas e djathtas), le të mendojnë si t'i kompensojnë ish-pronarët që kanë 22 vite që rreken të na kujtojnë se kërkojnë veç gjënë e tyre të grabitur dhe që besuan do t'u kthehej bashkë me lirinë dhe të drejtën për të cilën iu bashkuan ndryshimit të madh politik.

Për sa kohë të drejtat e kësaj shtrese, ish-të përndjekurve politikë, që me format ekstreme dhe të dhimbshme që po ndërmerr, po përpiqet të na thotë se ka nevojë për përfilljen tonë, nuk do të merren në konsideratë, tunelit të gjatë të tranzicionit nuk do t'i duket lehtë drita anës tjetër dhe Atdehur tone do të vazhdojë t'i mbetet damka ndër evropianë si Atdeh i frikshëm, ku njerëzit ngaç që shpërfillen plotësisht nga shteti i tyre, i vënë zjarrin vetes, por edhe pasi i vënë zjarrin vetes, shteti ende nuk e sheh zjarrin, pasi është i zënë me çështjet e Evropës, shoqëria ende nuk e sheh se është e varfër dhe është e ndarë majtas e djathtas, dhe intelektualët ende nuk e shohin sepse nga nëpunësia të shtetit, mund t'u duhet t'i bëjnë shoqëri kolegeve të tyre të papunë të sheshi Partizan i Panjohur.

Zjarrin e shohin vetëm të huajt, që druhën se po ta lënë të zgjerohet, ka të ngjarë t'ua çojë tymin deri në ndenjëset e tyre dhe nxitojnë ta fusin në vathën e Evropës këtë aradhië noprane delësh të pabindura e me civilizim të cunqur.



**Sot votohet KQZ**  
**e re, shtyhet sërish**  
**Gjykata e Lartë**

Seanca e sotme plenare pritet që të miratojë përbërjen e Komisionit të ri Qendror të Zgjedhjeve. Ky institucion, ashtu siç është bërë e ditur më parë nga PS, pritet që të rikonfigurohet pjesërisht me konsensusin e opozitës, kjo pasi PS shprehu votën kundër për kryetarin e KQZ. Bëhet fjalë pikërisht për dy kandidaturat e përzgjedhura për kreun e KQZ, Lefterie

Lleshi dhe Marsdia Xhaferllari. PS i konsideron politike këto dy emra. Ndërkohë që deputetët e majtë do të votojnë "pro" vetëm për anëtarët e KQZ, ku do të votohen pikërisht dy kandidaturat e prozuara nga PS (Albana Shtylla dhe Denar Biba) si dhe dy kandidaturat e ripropozuara nga PD (Hysen Osmanaj dhe Vera Shtjefni). Gjatë seancës së sotme pritet që të përzgjidhen edhe dy

anëtarët e tjerë të KQZ, për të cilët do të hidhen në votim 4 kandidatúra (2 kandidatúra nga LSI dhe dy kandidatúra të propozuara nga PBDNJ). Sot pritet të shtyhet sërish votimi i ligjit për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë, pasi PS i qëndron vendimit të saj për zhbllokimin e Qarkut të Fierit, dhe më pas votimin e këtij ligji që kërkon 84 vota.

**Kërkohet dorëheqja e Tafajt për propogandën partiake të kryeministrit**

# PS: Berisha po përdor fëmijët

Opozita sulmon turin në shkolla. Tafaj: Kryeministri në shkolla ka folur për integrimin e vendit, hiqni dorë ngë errësimi dhe nxirja e realitetit shqiptar. Mos akuzoni pa baza

**Lajmi**

Deputetët e opozitës akuzuan ministrin e Arsimit se nuk ka reaguar lidhur me propogandën politike që bën kryeministri me nxënësit e shkollave. Për këtë të majtë kanë kërkuar dorëheqjen e Tafajt.

**TIRANE**  
**ARTEMISA HOXHA**

Komisioni i Medias dhe Edukimit gjatë seancës së djeshme dëgjimore me ministrin e Arsimit, Myqerem Tafaj është përbalhur me debate dhe akuzat nga ana e deputetëve të opozitës lidhur me nivelin e arsimit në vend, përdorimin e nxënësve në fushata partiake si dhe me problemet që kanë të bëjnë me emërimet dhe përzgjedhjen e teksteve shkollore në mënyrë klienteliste. Për të gjitha këto probleme, deputetët e opozitës kanë kërkuar dorëheqjen e ministrin nga ky post, pasi propogandanda partiake e bërë nga kryeministri Berisha në shkolla është jo vetëm në shkelje të Kushtetutës, por edhe dhunon nxënësit. "Ju ministër nuk po zbatoni ligjin për arsimin. Moszbatimi i këtij ligji vjen dhe nga ana e kryeministrit, i cili shkon nëpër shkolla dhe u bënë nxënësve fushatë elektorale. Së bashku me kryeministrin janë dhe disa drejtues të tjerë vendorë që po

shkeln këtë ligj. Ne nuk do të lejojmë që shkollat, institucionet, ku arsimohen nxënësit dhe fëmijët tanë të kthehen në arena partiake. Një tjetër problem që dua të ngre është pikërisht dhe bllokimi i fondëve për pushtetin vendor, i cili prek drejtëpërdrejtë fondet për shkollat. Qeveria ka bllokuar këto fonde, duke e vështirësuar edhe më shumë nivelin e arsimit dhe kushtet në të cilat zhvillohet", tha deputeti i PS, Agim Leka. Akuzat të forta janë drejtuar edhe nga deputetja e PS, Ledi Shamku,

**"Ju ministër nuk po zbatoni ligjin për arsimin. Moszbatimi i këtij ligji vjen dhe nga ana e kryeministrit, i cili shkon nëpër shkolla dhe u bënë nxënësve fushatë elektorale"**

e cila ka theksuar se fushata e kryeministrit Berisha në shkolla është e turpshme. I menjëherëshëm ka qënë reagimi i ministrit Tafaj, i cili ka theksuar se kryeministri në shkolla ka folur për integrimin e vendit dhe nuk ka bërë fushatë. "Kryeministri nuk ka folur në shkolla për fushata



Komisioni Parlamentar i Medias

elektorale, por për integrimin e vendit. Hiqni dorë ngë errësimi dhe nxirja e realitetit shqiptar", u kundërpërgjigj ministri i Arsimit. Gjithashtu një tjetër shtetësim që ngriti opozita ishte mungesa e infrastrukturës dhe lënia e shkollës në mëshirë të fatit në kohën kur flitet për internet në të gjithë vendin. Deputetët e PS thanë se në shumicën e shkollave në zonat rurale, mësuesit dhe nxënësit nuk dinë të ndezin kompjuterët dhe jo më që të kenë akses në internet.

**EMËRIMET NË ARSIM**

Gjatë fjalës së tij, ministri i Arsimit reagoi pas akuzave për emërimet dhe për mungesën e profesionalizimit të mësuesve në shkolla. Ai theksoi se niveli i arsimit në vend është rritur, duke hedhur në këtë mënyrë poshtë akuzat e deputetëve socialistë se niveli i arsimit në vend ka rënë. "Drejtoritë

Arsimore Rajonale janë të qarta se çdo emërim i mësuesve që është bërë jo konform ligjit, është i jashtëligjshëm. Po bëhen verifikime në çdo shkollë për të verifikuar mësuesit me arsimin përkatës. Cilësia e arsimit është rritur, këtë e ka pohuar dhe Banka Botërore. Nuk mund të pretendojmë që për 3 vite, të kemi nivelin që dëshirojmë në arsim. Ne do të përmirësojmë shpërblymjet për këtë profesion, i cili ka qënë i braktisur. Në asnjë shkollë nuk do mbetet asnjë mësues pa arsimimin përkatës", tha ministri i Arsimit. Ndërkohë që deputetja Ledi Shamku akuzoi qeverinë se e ka rritur nivelin e analbetizimit në vend. "Zoti ministër, ju e keni katandisur vendin në një përqindje të madhe të analbetëve. Kjo shifër kap 15 % të popullsisë. Pra janë 15% analbetë", tha Shamku dhe në Komisionin e Medias.

**DEBATET TE KOMISIONI I MEDIAS**

**Agim Leka:** Ju ministër nuk po zbatoni ligjin për arsimin. Moszbatimi i këtij ligji vjen dhe nga ana e kryeministrit, i cili shkon nëpër shkolla dhe u bënë nxënësve fushatë elektorale. Së bashku me kryeministrin janë dhe disa drejtues të tjerë vendorë që po shkelin këtë ligj. Në nuk do të lejojmë që shkollat, institucionet ku arsimohen nxënësit dhe fëmijët tanë të kthehen në arena partiake. Një tjetër problem që dua të ngre është pikërisht dhe bllokimi i fondëve për pushtetin vendor, i cili prek drejtëpërdrejtë fondet për shkollat. Qeveria ka bllokuar këto fonde, duke e vështirësuar edhe më shumë nivelin e arsimit dhe kushtet në të cilat zhvillohet.

**Fidel VIII:** Zoti ministër, po si mund të flisni këtu për rritjen e nivelit të arsimit dhe për internetin kur në vend ka shkolla që nuk kanë çati e dritare?! Ju thoni që do të fusni italishtin apo dhe kinezin si gjuhë të dytë, por për kë, kush do ta mësonte? Me këta mësues që nuk dinë të ndezin kompjuterat?! As shkollat në Afganistan nuk kanë këto kushte që kanë shkollat në vendin tonë, sidomos ato në zonat rurale, ku ka klasa me nga një nxënës.

**Alfred Dalipi:** Niveli i arsimit ka rënë. Mësuesit në shkollat e fshatrave të Ersekës japin biologji, por që në të vërtetë janë me profesion veterinerë apo dhe ndonjë profesion tjetër.

**Myqerem Tafaj:** Drejtoritë Arsimore Rajonale janë të qarta se çdo emërim i mësuesve që është bërë jo konform ligjit, është i jashtëligjshëm. Po bëhen verifikime në çdo shkollë për të verifikuar mësuesit me arsimin përkatës. Cilësia e arsimit është rritur, këtë e ka pohuar dhe Banka Botërore. Nuk mund të pretendojmë që për 3 vite, të kemi nivelin që dëshirojmë në arsim. Ne do të përmirësojmë shpërblymjet për këtë profesion, i cili ka qënë i braktisur. Në asnjë shkollë nuk do mbetet asnjë mësues pa arsimimin përkatës.

**Ledi Shamku:** Niveli i arsimit ku është këtu, se vetëm për nivel të lartë nuk mund të flasim. Ju po silleni barbarë me arsimin në vend. Ju z ministër plotësoni kushtet për t'u akuzuar, keni shkelur ligjin dhe plotësoni kushtet tashmë për t'u akuzuar. Ky organizim i juaj qonkë bandë. Jepni dorëheqje.

**Myqerem Tafaj:** Kryeministri nuk ka folur në shkolla për fushata elektorale, por për integrimin e vendit. Hiqni dorë ngë errësimi dhe nxirja e realitetit shqiptar.

**Fatmir Toçi:** Duhet kthyer vëmendja te shkollat në fshatra, përfshirë këtu edhe ata të Vlorës që nuk kanë dyer dhe dritare. Nuk ka as minimalisht mjedise sanitare dhe jo më të bëhet fjalë për mjedise dhe pajisje laboratorike. Dhe ju flisni për internetin në shkolla. Ku është ky internet?

**Blog/ Periferi**



NGA ALBA MALTEZI

## Evropa, humnera e totalitaristëve

Ruga e vështirë drejt statusit Rvënd kandidat për në BE, edhe pse me kushte, në të vërtetë është një përmirësim dhe inkurajim për të gjithë. Ky moment nuk e ka shkëlqimin e marrjes së vizave, të huton mes ingranazheve të gjuhës diplomatike, por ka një mesazh të qartë e

të vlefshëm për ne: duhet të punojmë akoma fort për ta merituar. Detyrat e lëna nuk janë të vogla, janë shtylla të forta për mbajtjen në këmbë të Shtetit. E tha që një ditë më parë në editorialin e tij shpërndarë për të gjitha mediat komisioneri për Zgjerimin dhe politikën Evropiane të Fqinjësisë, Stefan Fule: "Nëse do të zgjidhja vetëm tre prej tyre (reformave parësore), do të theksoja nevojën për të përfunduar reformën në Administratën Publike,

për të përforëcur gjyqësorin dhe për të luftuar me efektivitet korrupsionin dhe krimin e organizuar...". Hatat e vështirë, të ngadaltë, me trastat mbushur me kushte dhe afate, që vendi ynë po bën drejt Evropës, janë kilometra të tjerë të bërë përpara drejt lirisë për shumë prej nesh dhe nga ana tjetër, një rrugë e pashmangshme drejt humnerës për figurat totalitariste që ende ushqejmë. Përkatësia evropiane sjell shanse të paimaginueshme

për ne dhe brezat e ardhshëm për t'u çliruar e zhvilluar individualisht e për të arritur një tjetër status, në të rëndësishmin e rëndësishmëve: Atë të individëve të lirë në një shoqëri me rregulla demokratike. Nuk ka asgjë tjetër, veç dashurisë për t'u përmirësuar, për të qënë të lirë, që na shtyn të afrohem gjithnjë e më shumë drejt civilizimit modern të njerëzimit: Drejt Evropës. Të gjithë e ndjejmë sa e vështirë është; për ne shqiptarët

akoma më e mundimshme se çdo vend tjetër i Ballkanit. E dimë shumë mirë se jemi ndryshe edhe nga fqinjët tanë, por këto vështirësi na inkurajojnë që të mos dorëzohemi. Mbi 80 përqind e shqiptarëve dëshirojnë të shkojnë në Evropë. Dhe është kjo dëshirë e madhe që do të na bëjë të kapërcëjmë pengesat që na nxjerrin në këtë rrugëtim të eturit për totalitarizëm. Evropa do të jetë stacioni i fundit i tyre dhe mundësia për përmirësim i ne të gjithëve.



Analiza

# Një BE për dy Shqipëri



NGA **AFRIM KRASNIQI**  
vijen nga faqja 1

...ndaj BE është detyruar të shpikë një formulë të re në raportet me Shqipërinë: statutet me kushte. Janë dy faza vlerësimi: katër kushte për në dhjetor dhe nëse ato realizohen, janë disa kushte të tjera deri me 30 qershor 2012 kur do të zhvillohen zgjedhjet parlamentare. Në historinë e BE-së ky është rasti i parë që aplikohet ky model vlerësimi. Shqipëria gjithashtu është vendi i parë ish komunist që nuk arrin tre herë radhazi të fitojë statutin e plotë për bisedimet e vendit kandidat. Për BE, kancelaritë perëndimore dhe ekspertët e politikës mesazhi është i qartë: Shqipëria ende nuk meriton të jetë përbërëse e Evropës Politike. Për Tiranën zyrtare mesazhi lexohet ndryshe: e kaluam edhe këtë radhë. SHBA dhe BE folën për shans historik, kurse Kryeministri, kryetarët e partive aleate të tij, por edhe disa deputetë, ministrat e militant të tjerë të administratës së (de)politizuar mbushen dje median dhe rrjetet sociale për "ngjarjen historike", "suksesin historik", etj.

Dallimi midis shansit dhe suksesit historik përbën edhe dallimin themelor midis dy Sh-

qipërive, asaj virtual dhe asaj reale; asaj që përjeton inagurime e jetë luksoze dhe asaj shumice që mbijeton në varfëri e mjerim; asaj që e sheh BE-në si interes madhor dhe asaj që e sheh atë si mjet për qëllime elektorale; asaj që beson në parime, moral e vlera dhe asaj që për synime pragmatiste nuk kanë rëndësi vlerat dhe as mjetet. Mbi të gjitha, midis asaj Shqipërie që Evropa prët të jemi dhe asaj Shqipërie që në jemi në gjendje të ofrojmë. Bruksel prët që në Shqipëri të ketë zgjedhje të lira, të burgosen të korruptuarit, të veprojnë shteti i së drejtës, të garantohen liritë kushtetuese, të ketë administratë dhe institucione kushtetuese të pavarura, të bëhet reformë në gjyqësor dhe politika të bashkëpunojë për çështje me interes publik. Ajo që Shqipëria e detyron është diçka tjetër: zgjedhjet ku lejohen shkelje sepse "edhe në SHBA ka probleme numërimi", zyrtarë të korruptuar që fitojnë pafajësi për shkaqe procedurale, shtet në funksion të një klike të ngushtë njerëzish me pushtet, liri selektive kushtetuese dhe të drejtë të qeverisë ti kufizojë ato, administratë militante të gatshme për mitingje dhe institucione kushtetuese që emërohen nga kryeministri, dialog politik për të detyruar opozitën të votojë gjithçka propozon mazhoranca. Nuk janë fiction, por janë kushtet që BE ka përmendur dhe ka kërkuar të përmbushen deri në dhjetor 2012. Diferenca del e qartë dhe midis tyre ndodhet edhe rruga e vërtetë e Shqipërisë për në Evropë.

Paradoksi midis një Bashkimi Evropian dhe dy Shqipërive u përsërit edhe dje në fjali-

met patetike të parisë së Tiranës. Në retorikën e mazhorancës janë plotësuar të gjitha standardet e anëtarësimit dhe se kushtet (vota në parlament, rregullorja parlamentare, reforma në drejtësi, zgjedhjet 2013, dialogu politik) janë çështje e opozitës, e cila nëse e do integrimin duhet ti votojë dhe ti pranojë ashtu siç ofrohen nga qeveria. Vota kritike apo vota kundër konsiderohen votë anti-BE. Sipas kësaj logjike parademokratike, edhe grevisti i urisë që dje tentoi vetëvrasje në shenjë proteste për refuzimin e qeverisë në zbatimin e ligjit për kompensim financiar nuk ka bërë asgjë tjetër vetëm sa ka dashur të errësojë arritjen historike të qeverisë. Të gjithë ata që e kritikojnë atë, që nuk mendojnë njësoj si kryeministri, që shprehin pakënaqësi për politikën e qeverisë apo që janë pesimistë për ecurinë e vendit, - sipas kryeministrit dhe qeverisë, - nuk janë asgjë tjetër përveçse "fundërrina" që duan të pengojnë integrimin në BE! Një gjuhë dhe mentalitet ideologjik e dëgjuar për dekada nga Enver Hoxha, Ramiz Alia dhe bashkëpunëtorët e tyre. Nga ana tjetër, një opozitë që mban me ushqim pushtetin, refuzon ta luajë rolin e saj kushtetues dhe parlamentar dhe në fund përmes twitter apo blackbarron ofron zgjidhjen universal: gjithçka do të zgjidhet dhe bota do të jetë më e mirë kur unë të vij në pushtet!! Imagjoni Shqipërinë pas 10-15 vitesh, atëherë kur aktorët e sotëm do të jenë në muzetë e historisë. Me siguri do të ndjehemi të turpëruar kur të kujtojmë se më 2012 nuk morën ftesën në BE sepse

patëm probleme me rregulloren e parlamentit apo se nuk flisnin së bashku Berisha e Rama, siç ndjemi sot me turp kur kujtojmë se më 1996 humbën shansin e integritetit se doktori deshi mandat të dytë presidencial dhe se Sudja na rrezoi sistemin bankar!

Shansi për BE-në kërkon diçka tjetër; atë që SHBA dje me të drejtë e quajtën përgjegjësi për reforma dhe demokracinë. Pra, një kurs të ri politik dhe institucional, që nuk matet me hijen e vetes por me standardet e familjes ku duam të shkojmë. Një qeveri që nuk u nxjerr fëmijët nga mësimi për tu mbajtur leksione kundër opozitës; një mazhorancë që nuk i ndan institucionet kushtetuese dhe administratën në përqindje tregtie mes partive aleate; një President që mendon më shumë për qytetarët sesa për kryeministrin; një sistem drejtësie që prodhon besim dhe jo vendime selektive politike e korruptive; një parlament nuk bëhet politikë jo sherre e mizaskena nga ato të pazarit të Rrogzhinës; një proces zgjedhor që heq dorë nga tradita bizantine se populli voton por qeveria numëron; një vend ku njerëzit nuk vetëvriten me kërkesë për tu dëgjuar nga qeveria, por ku qeveria nuk resht se dialoguari me qytetarët dhe se angazhuari për ruajtjen e jetës së tyre. Pra, BE pret një Shqipëri tjetër nga ajo që jemi, një Shqipëri normale dhe një klasë politike të përgjegjshme, të aftë dhe me sjellje qytetare, - cilësi të cilat në Tiranën tonë, në tetor e në dhjetor, në janar e në qershor, për faj të atyre që marrin vendime në emrin tonë - janë e mbeten ende të huaja.

JOB ANNOUNCEMENTS



Bankers Petroleum Albania Ltd (Bankers) is a subsidiary of Bankers Petroleum Ltd, a Canadian oil & gas company headquartered in Calgary, Alberta. We are listed on the Toronto stock exchange and also on AIM London. Our web address is [www.bankerspetroleum.com](http://www.bankerspetroleum.com)

Bankers had its plans for the development of the Patos-Marinza and Kucova oilfields approved by the Government of Albania. We are also pursuing additional oilfield development opportunities in Albania. The Shareholders, Management and Employees of Bankers are extremely excited by the challenging prospects and opportunities which lie ahead. Having already experienced eight successful years and established ourselves as the leading crude oil production company in Albania, Bankers will continue to make significant investment in its oilfields in the years to come, with demanding targets for increases in reserves, production, and sales.

To help us meet our objectives, we are continually looking to add suitably qualified people who can demonstrate qualities including enthusiasm, initiative, team-working, leadership and humility. Bankers offers competitive compensation and benefits and has a culture of rewarding good performance. We are committed to the principle of equal opportunity in employment and promote a fair and non-discriminatory work environment.

We are currently looking for qualified candidates to fill one vacant position for **Instrumentation Technician**

Key Requirements:

- University Diploma in Electrical/Electronic Engineering
- Preferably experience on instrumentation, electrical and/or electronics background
- Preferably experience in configuring and programming of SCADA systems and PLC's
- Intermediate or Advance level of English language
- Proficient computer skills, knowledgeable in programming and instrumentation
- Excellent verbal and written communication skills
- Ability and willingness to learn and work in a team environment ,organized, focused
- Ability to establish priorities, meet deadlines, and concentrate on detailed information
- Driving license

Applications including a C.V. and cover letter, in English, should be sent in a sealed envelope to the Human Resources Department at the following address:

Lagja "Sheq i Madh", Rr."Leonardo Murialdo", Fier, Albania.  
Tel: +355 34 2208 45 /6/7/8  
Fax: +355 34 220850

or by E-mail to: [humanresources@bankerspetroleum.com](mailto:humanresources@bankerspetroleum.com)

The deadline for submitting applications is 26 October 2012. All applications will be considered, and responses sent out as soon as possible.



Institucioni i specializuar në gjuhën angleze me përvojë 12 vjeçare suksesi

email. [info@london-tirana.com](mailto:info@london-tirana.com) [www.london-tirana.com](http://www.london-tirana.com)

• KURSE PER FEMIJE

Nga moshë 5 vjeç vetëm me pedagogë të huaj (anglezë ose amerikanë).

• KURSE PER TE RRRITUR

Mësimdhënie e fokusuar në komunikim nga pedagogë të kualifikuar dhe me experencë

• CERTIFIKATAT NDERKOMBETARE

Përgatitje për provime si:

- FCE
- CAE
- IELTS
- TOEFL (iBT) + (ITP) **New**
- TOEIC **New**
- SAT **New**

• MESIME INDIVIDUALE

Kurse të përshtatura sipas nevojave të çdo individi.

SHKOLLE/ERORE

Kurse dyjavore në Londër, Angli.

London Language Institute

Adresa: Bulevardi "Bajram Curri", Pall.114, Tiranë, Shqipëri

Tel. +355 (4) 22 30 180  
Tel. +355 (4) 22 42 745  
Mob. +355 69 21 42 188





**EKONOMI**

**Qeveria garanton kredinë 50 milionë euro për KESH-in**

Dje Këshilli i Ministrave miratoi një garanci bankare, për të garantuar si qeveri huanë ndërmjet bankës Raiffeisen, bankës Intesa Sanpaolo dhe Korporatës Elektroenergetike Shqiptare, në masën totale prej 40 milionë eurosh. Në mbledhjen e qeverisë, kryeministri Berisha u shpreh se qëllimi i parë i kësaj garancie është mundësia të KESH-it për të

kryer importin e energjisë. "Për të përballuar situatën e krijuar nga mospërbushja e këtij detyrimi shumë të rëndësishëm, autoritetet shqiptare duhet të autorizojnë KESH-in për të importuar energji dhe, natyrisht, të garantojnë edhe shumën e domosdoshme për importin e saj. Një pjesë të kësaj kredie, KESH është i autorizuar ta përdorë për të blerë

energjinë që prodhojnë hidrocentralet e reja, të cilat kanë bërë investimin dhe tani janë shndërruar në një burim të rëndësishëm furnizimi me energji të vendi, një burim gjithnjë në rritje" tha ai. KESH-i ka grumbulluar aktualisht një borxh të madh financiar ndaj këtyre kompanive, disa prej të cilave madje kanë hapur ndaj tij edhe një gjyq civil.

Hapen ofertat për licensën e tretë e të katërt të shërbimit 3G në celularë

# Licensa 3G, "Plus" ofron 1 euro

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare "rrudh" kërkesën, me çmimin dysHEME 4 milionë euro, tre vjet më parë e njejta licensë solli 31 milionë euro në buxhetin e shtetit

■ ■ ■ TIRANE

GENC KONDI


Janë hapur dje ofertat për marrjen e licensave 3G nga kompanitë celulare, të cilat ende nuk e kanë këtë shërbim. Kompania Eagle ka ofruar për të marrë licensën 4.355.000 euro, ndërsa Plus ka ofruar shumën prej vetëm një euro, duke treguar qarta se synon të hyjë në treg kur shteti ta ulë edhe më tej çmimin. Në fakt, tre vjet më parë, Vodafone pagoi 31 milionë

**Lajmi**

**Kompania e celularëve Plus ka ofruar dje vetëm 1 euro për të blerë licensën 3G, ndërkohë që kompania tjetër Eagle ofroi 4.3 milionë euro, pak më shumë se çmimi dysHEME. Licensa eparë e internetit në celular u shit për 31 milionë euro kompanisë tjetër Vodafone**

euro dhe një vit më pas AMC-ja gati 14 milionë euro, kur çmimi dysHEME i vendosur nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP) ishte në të dyja raste 12.5 milionë euro. Pasi përpjekja e tretë për të shi-

tur licensën me të njëjtin çmim dështoi (kompanitë e vlerësuan Plus 2.2 milionë euro dhe Eagle 3.4 milionë euro), Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare në korrik të këtij viti vendosi të përsërisë sërish ten-



derin e radhës më 10 tetor, duke ofruar njëkohësisht për shitje dy licensat e mbetura, me çmim minimal prej 4 milionë eurosh. Eagle ka bërë një ofertë mbi kërkesën prej katër milionësh, por që është gjashtë herë më e ulët se ajo e kompanisë që e para bleu shërbimin. AKEP duket se është i interesuar më shumë për fondet që do të përfitonte nga shitja e licensave. Në kriteret e tenderit, AKEP vlerëson me 90 pikë ofertën që do të paraqitet me çmimin më të madh, kurse kohën e mbu-

limit me shërbimin në shkallë gjeografike me 10 pikë. Periudha minimale e mbulimit me rrjet do të jetë minimalisht: Deri në fund të 6-mujorit të parë, jo më pak se 35 për qind të territorit; deri në fund të 12 muajve jo më pak se 65 për qind të territorit dhe deri në fund të 18 muajve, jo më pak se 85 për qind të territorit. AKEP duket se ka bërë gjithshka që dy kompanitë e mbetura ende pa licensën në treg të sjellin oferta shumë të ulta. Me këtë logjikë, licensa e katërt mund të falej.

**Energjetika**

# CEZ: Shërbim cilësor për klientët e rregullt

■ ■ ■ TIRANE

Si çdo vit, ekipi më i lartë menaxhues i kompanisë së shpërndarjes së energjisë elektrike, CEZ Shpërndarje, ka organizuar takime me punonjësit e terrenit në kryeqendrat e katër rajoneve kryesore të Shqipërisë, sipas ndarjes zonale, që ka bërë vetë kjo kompani. Këtë vit, këto takime, të njohura si "Road Show", u zhvilluan në Tiranë, Shkodër, Elbasan dhe Vlorë. Gjatë zhvillimit të tyre diskutohen arrijtet, problematikat e ndryshme që janë hasur përgjatë vitit, objektivat, si edhe shkëmbehen informacione në mënyrë të drejtpërdrejtë, midis ekipit menaxhues në nivel të lartë të kompanisë dhe të gjithë punonjësvë. Gjatë këtyre takimeve, të kthyerat tashmë në një traditë për kompaninë, drejtues të CEZ Shpërndarje, përveç diskutimeve mbi përmirësimin e performancës, uljen e humbjeve dhe rritjen e arkitimeve si objektiva kryesore të kompanisë, kanë paralajmëruar se në vazhdimësi do të ketë masa të rrepta disiplinore ndaj atyre punonjësvë që abuzojnë me postet e tyre dhe evidentojnë raste të një sjelljeje jokrrekte ndaj klientëve të kompanisë.

Në kuadër të kësaj, prej disa muajsh kompania monitoron gjatë gjithë kohës punën e punonjësvë të saj, me qëllim përmirësimin e ndjeshëm të cilësisë të shërbimit që u ofrohet klientëve të CEZ Shpërndarje.

"Në bazë të kësaj analize të përgjithshme mbi performancën e



**Objektivat**

Ekipi menaxhues i CEZ Shpërndarje ka shuar kureshtjen në lidhje me fjalët në qarkullim, për një largim të mundshëm të kompanisë nga Shqipëria, duke theksuar se kompania do të arrijë objektivat e vendosura për një kompani të suksesshme sipas të gjitha standardeve evropiane

**Prej disa muajsh kompania monitoron gjatë gjithë kohës punën e punonjësvë të saj, me qëllim përmirësimin e ndjeshëm të cilësisë të shërbimit që u ofrohet klientëve të CEZ Shpërndarje**

punonjësvë", kanë theksuar drejtuesit e lartë të CEZ Shpërndarje, "gjatë gjithë kësaj kohe janë marrë masa përkatëse disiplinore për punonjësit problematikë, deri në pushimin nga puna dhe ndjekjen e tyre penale".

Ekipi menaxhues i CEZ Shpërndarje, në Road Show-t (udhërrëfyesit) e organizuar këtë

vit ka shuar dhe kureshtjen në lidhje me fjalët në qarkullim, për një largim të mundshëm të kompanisë nga Shqipëria, duke theksuar se kompania do të arrijë objektivat e vendosura për një kompani të suksesshme sipas të gjitha standardeve evropiane. Sipas menaxhmentit të lartë të CEZ



Shpërndarje, ofrimi i një shërbimi sa më cilësor për klientët e kompanisë, ulja e humbjeve në rrjet dhe rritja e arkitimeve për zonat problematike duhet të jenë në vendmendjen e secilit punonjës të kompanisë, ku edhe performanca e secilit vlen për përmbushjen e këtyre objektivave.

Në kuadër të këtyre synimeve, CEZ Shpërndarje ka nisur para disa muajsh një fushatë të fortë për ndërprerjen e furnizimit me energji për të gjithë klientët debitorë dhe lidhjet e paligjshme. Duke qenë se ulja e vjedhjeve në rrjet është një përgjegjësi që u përket të

gjithë punonjësvë të CEZ Shpërndarje, kompania ka vendosur një objektiv të caktuar për të gjithë punonjësit e terrenit dhe ka marrë masa disiplinore për të gjithë ata që nuk kanë realizuar punën e tyre.

Duke theksuar se kompania është e vendosur në misionin e saj për të ulur ndjeshëm vjedhjet në rrjet dhe, për rrjedhojë, të rritë nivelin e arkitimeve, drejtuesit e lartë të CEZ Shpërndarje kanë vënë në pah lidhjen e drejtpërdrejtë mes pagesës për energjinë e konsumuar dhe garantimit për një furnizim normal me energji për klientët e rregullt.

# University of New York Tirana

*Educating Tomorrow's Leaders!*



Real American & European Education leading to the authentic degrees of the partner Universities

Rr. "Medar Shtylla"

(ish Komuna e Parisit)

Tirana, Albania

Tel: + 355 42 441 330

Email: admissions@unyt.edu.al

**University of New York Tirana**

## BACHELOR's

### Economics & Business

- Finance
- Business Administration
- Management
- Marketing
- Economics
- Accounting

### Computing

- Computer Science
- Information Systems
- Computer Networking
- Infrastructure Engineering

### Humanities & Social Sciences

- Political Science & International Relations
- Law
- Communication & Journalism
- English Language & Literature
- Psychology

## MASTER's (MSc)

- LL.M. (Master of Law) in International & Commercial Law
- M.A. in International Affairs
- MSc in Computer Science
- MSc in Finance & Accounting

## MBA's (MSc)

- General
- Management
- Banking
- Marketing
- Human Resource Management
- Management of Information Systems

## Ph.D

### Ph.D in Business Administration

with concentration in:

- Economics
- Finance
- Accounting
- Management
- Marketing
- International Business

### Ph.D in Computer Science

with concentration in:

- Computer Science
- Management Information System

### Ph.D in Humanities and Social Sciences

with concentration in:

- Law
- Political Science / International Relations
- Psychology
- Education



Find us on: [www.unyt.edu.al](http://www.unyt.edu.al)



TOKESORE  
KANALI 48

*Do na ndiqni në gjithë Shqipërinë*



SATELITOR  
KANALI 51

*Do na ndiqni në gjithë Shqipërinë, Maqedoni, Kosovë, Itali, Greqi dhe në pjesën tjetër të Europës*



NË PREFEKTURAT:  
TIRANE - DURRES - LEZHE - FIER



ALBANIAN BROADBAND COMMUNICATION  
KANALI 158

# WORLD REPORT

**Çdo ditë në**

**A1 REPORT!**

*Origjina e Lajmit*

**Video dhe lajme nga e gjithë Bota**



## Dhimbja e mesit: Streçing i shpeshtë

Nëse i përgjigjeni me po ndonjëres prej pyetjeve të mësipërme ose të gjithave, atëherë ju mund të jeni duke vuajtur nga tendosja e muskullit...

Faqe 16

## Pyetje doktorit pas birrës së tretë

Këto lloje ereksionesh të pavetëdijshme Kndodhin gjatë fazës REM të gjumit. Ajo karakterizohet nga një lëvizje e shpejtë e syve dhe është periudha...

Faqe 18



# A SUPLEMENTI MJEKESOR ALMEDICUS S

[SHQIPTARJA.com]  
Origjina e Lajmit

Nr.36

BOTIM I PËRJAVSHËM I GAZETËS SHQIPTARJA.COM

E ENJTE 11.10.2012

## ALARM/ 1 NE 150 VETA ZHVILLON FORMEN E RENDE

# Virusi i Nilit rrezik edhe për Shqipërinë

Shkak, lëvizjet migruese e ndryshimi klimaterik

■ ■ ■ TIRANE

JANA NANO

Në lajmet e javës së fundit, Instituti i Shëndetit Publik në Tiranë deklaroi se ethet e virusit të Nilit Perëndimor kanë prekur edhe Shqipërinë. Numërohen rreth 5 raste të dyshuara në vendin tonë që priten ende të konfirmohen. Duket se kriza ekonomike evropiane ka shfaqur pasojat e saj edhe në shëndetësi. Shumë emigrantë Shqiptarë rikthehen në vendin e tyre duke mbaruar me vete "kartelat klinike" të vendeve nga vijnë. Dy vite më parë Ministria e Shëndetësisë greke shpall gjendjen e jashtëzakonshme ku Virus i Nilit Perëndimor numëroi 11 të vdekur, 150 të tjerë në gjendje të rëndë dhe rreth 15 000 të infektuar. Pas valës së...  
Faqe 14



## Dieta

Faqe 15




## Veza, tableta multivitaminike natyrale

Veza bën pjesë në listën e 10 superushqimeve dhe jo pa arsye! Pavarisist përmasave të saj ( përveç vezës së strucit) ajo përmban një sasi të madhe substancash ushqyese themelore për shëndetin tonë. E vërdha e vezës, por edhe e bardha esaj përmbajnë një sasi të madhe proteinash dhe kolinë duke u përdorur...

## Estetikë

Faqe 17



## 5 rregulla për të zgjedhur specialistin

Disa procedura kozmetike, si injeksionet e Botoksit, vërtet nuk bëjnë pjesë tek ndërhyrjet kirurgjikale, por kjo nuk do të thotë që nuk kanë risqe dhe efekte anësore. Si fillim, duhet t'i drejtoheni dikujt që eksperiencën e duhur në këto procedura. Procedurat kozmetike jo kirurgjikale përfshijnë produkte (si botoksi) dhe teknika...

## Lodhja nga kompjuterat: Ja disa ushtrime

Kompjuterat tashmë janë pjesë e kësaj pandarë e ambienteve tona të punës. Kombinimi i posturës...  
Faqe 18



## Ju ka pickuar gjarpri? Kështu mund të shpëtoni

Fatkeqësisht kjo nuk është më një praktikë e pranuar. Thithja e pickimit jo vetëm që është inefektive...  
Faqe 18



# ALARM

## Virusi i Nilit Perëndimor rrezik edhe për Shqipërinë

Shkaku, lëvizjet migruese dhe ndryshimet klimaterike

JANA NANO

Në lajmet e javës së fundit, Instituti i Shëndetit Publik në Tiranë deklaroi se ethet e virusit të Nilit Perëndimor kanë prekur edhe Shqipërinë. Numërohen rreth 5 raste të dyshuara në vendin tonë që priten ende të konfirmohen. Duket se kriza ekonomike evropiane ka shfaqur pasojat e saj edhe në shëndetësi. Shumë emigrantë Shqiptarë rikthehen në vendin e tyre duke mbartur me vete "kartelat klinike" të vendeve nga vijnë. Dy vite më parë Ministria e Shëndetësisë greke shpalli gjendjen e jashtëzakonshme ku Virus i Nilit Perëndimor numëroi 11 të vdekur, 150 të jtrë

në gjendje të rëndë dhe rreth 15 000 të infektuar. Pas valës së infeksionit në Bukuresht të vitit 1996, në Rusi në 1999, pastaj në Hungari në 2008 e Austri tashmë duket se po përhapet edhe në vende të tjera



të Evropës. Dinamika e lëvizjeve demografike po zgjon nga gjumi sëmundje të ndryshme që po vihen re vetëm vitet e fundit. Gjithashtu është rritur ndjeshëm edhe lëvizja e tregut të punës me vendet aziatike apo procesi i integritimit të kontinentit afrikan me misionet e shumta nga vendet e Evropës. Një vend në zhvillim si Shqipëria është pjesë e këtyre valëve të emigruesve që reflektohen edhe në hartën epidemiologjike të sëmundjeve të vendit. Për të gjithë ata persona që për arsye të ndryshme janë të detyruar të udhëtojnë në vende endemicke të shumë infeksioneve si Azi, Afrikë, Lindje e Mesme etj-ësh-

të rreptësisht e këshillueshme të informohen dhe të marrin të gjitha masat preventive dhe kuruese përpara se të nisen. Para pak ditësh Shoqata e Infektologëve në Shqipëri bëri të ditur ekzistencën e 7 rasteve të reja me Malarie në Shqipëri, e cila mendohet të jetë importuar nga vendet fqinje si Italia e Greqia. Gjithsesi autoritetet shëndetësore deklarojnë se situata është nën kontroll dhe sygjerohet përforcim të kontrollove në pikat doganore. Deri para viteve '70' Shqipëria ka qënë një zonë endemike e Malaries duke patur parasysh gjeografinë e saj kënetore sidomos në Lezhe, Lushnjë, Vlorë etj.

### Virusi dhe SH.B.A

## Hipoteza: Shkaktarë ndryshimet klimaterike. 41 të vdekur në SHBA

Epidemia e Virusit të Nilit Perëndimor të verës së këtij viti në SH.B.A qe një nga më të këqijat të kaluara ndonjëherë. Në kontinentin e largët u regjistruan rreth 1118 raste të reja të sëmundjes duke shënuar 41 vdekje. Që kur u zbulua në vitin 1999, është hera e parë që vërehet një epidemi e tillë mbarëbotërore.

Punonjësit e Qendrës Komëbëtare të Kontrollit të Sëmundjeve në Amerikë u shprehën se kjo epidemi është një nga më të kërcënueset që ka parë njerëzimi nga ky virus. "Nuk e dimë ende çfarë e shpërtheu këtë epidemi. Supozojmë se ndryshimet klimaterike luajnë një rol të rëndësishëm: tani pranvera e vera vijnë më shpejtë e dimri është më i butë. Temperaturat e larta dhe luhajtjet shi-thatësirë krijojnë kushte ideale të cilat kanë impakt biologjik te mushkonjat transmetuese. Duke qënë së dimri është më i butë dhe pranvera vjen më shpejtë, cikli i jetës së mushkonjave rritet. Normalisht ato do të kishin "vdekur në dimër. Kjo u lejon të riprodhohen me shpejtësi në pranverën që pritet. Koha e ngrohtë e përshpejton akoma më shumë këtë proces"

Teksasi qe një nga shtetet më të prekura. Aty thatësira është shumë më e lartë se vendet e tjera të Amerikës. Eksperitë epidemiologë shpjegojnë se në këto modele klimaterike edhe uji është më i ndotur duke stimuluar krijimin e ambienteve ushqyese për mushkonjat.

Alarm për profesionistët e Shëndetit Publik përbën edhe fakti që këto sezona thatësire mund të

përbëjnë një faktor precipitues për shfaqjen edhe të mushkonjave vektore të sëmundjeve të tjera. Nuk do të ishte aspak çudi. Akoma më pak edhe ndonjë epidemi e re e malaries. Nuk është e vështirë të parashikosh këto ndryshime kur tashmë është studiuar fare mirë lidhja që ekziston midis ciklit biologjik të mushkonjave dhe motit. Sëmundja transmetohet në njerëzit nëpërmjet pickimit të mushkonjave të infektuara. Këto të fundit e

marrin virusin kur ushqehen me zogj të infektuar nga i njëjti virus.

### PROFILI I VIRUSIT

Virusi i Nilit Perëndimor është një virus i cili transmetohet te njerëzit nëpërmjet pickimit të mushkonjave. Ato përbëjnë të vetmin vektor të sëmundjes dhe e marrin virusin nga ushqyerja me zogjtë e infektuar. Virusin nuk transmetohet nga njeriu te njeriu apo



### Drejtijuni mjekut!

Momentalisht sëmundja është endemike në Afrikë, Azi, Lindjen e Mesme dhe në disa zona të SHBA-së. Virus i zbulua për herë të parë në vitin 1937, në Nilin Perëndimor, në Uganda. Në SHBA u shfaq për herë të parë në vitin 1999. Personat të cilët shfaqin shenja apo simptoma të sëmundjes dhe dinë që janë pickuar nga ndonjë sëmundja sidomos në vendet gjeografike të sipërpërmendura duhet t'i drejtohen menjëherë mjekut. Kini parasysh se simptoma të tilla si ethe, shtangësi e qafës, ndjeshmëri ndaj dritës, gjendja e alteruar e koshiençës si dhe dobësia muskulare duhet t'u alarmojnë për të shkuar në spital pa humbur kohë.

### Cili është trajtimi?

Nuk ka një trajtim specifik për infeksionin. Në rastet kur simptomat janë të moderuara mund të përdoren medikamente për të reduktuar temperaturën apo dhimbjet. Kujdes përdorimin e Aspirinës në fëmijët e vegjël pasi paraqet risk për zhvillimin e sindromës Reye. Në rastet kur infeksioni paraqet klinikën e tij më të rëndë kërkohet mbikqyrja mjekësore në spital.

## Malaria 7 përgjigje nga mjeku

### 1. Cilat janë simptomat e para të Malaries?

Simptomat përfshijnë ethe, të dridhura, dhimbje koke dhe muskujsh, lodhje e përgjithshme. Mund të shoqërohet me nauze, të vjella dhe diarre. Malaria mund të shkaktojë anemi, duke i dhënë pacientit një ngjyrë të zbehtë. Nëse nuk trajtohet, infeksioni përqendrohet me pamfufueshmëri të veshkave, konfuzion, koma dhe vdekje.

### 2. Si transmetohet Malaria?

Malaria mund të transmetohet vetëm nëpërmjet pickimit të mushkonjës së infektuar Anopheles. Kur një mushkonjë pickon një person të infektuar, ajo merr bashkë me gjakun e tij edhe parazitët e Malaries. Pas një javë, këta të fundit pasi bashkohen në pëshëtimin e mushkonjës i transmetohen një individ tjetër gjatë. Parazitë vendosen në qelizat e kuqe të gjakut, kështu që mund të transmetohet edhe gjatë transfuzioneve të tij.

### 3. Si bëhet diagnoza?

Gjaku i pacientit ekzaminohet me anë të mikroskopit për praninë e parazitëve të malaries. Nëse keni udhëtuar kohët e fundit në një vend ku ky infeksion është endemik, ky ekzaminim duhet bërë menjëherë.

### 4. Kur është e nevojshme t'i drejtohem mjekut?

Sëmundja duhet të trajtohet sa më shpejt gjatë dekurit të saj, përpara se të shndërrohet në një sëmundje jetë-kërcënuese. Ka shumë medikamente kundër malaries. E rëndësishme është të mendoni gjithmonë për këtë sëmundje nëse vendosni të udhëtoni në një vend endemik në mënyrë që të diagnostikohet dhe trajtohet menjëherë.

### 5. A është ngjitëse për familjarët e mi?


Jo. Malaria nuk mund të transmetohet nga individ në individ siç ndodh për shembull me viruset e grupit. Nuk transmetohet as nëpërmjet kontaktit seksual apo për shembull kontakt fizik me dikë të infektuar. Të riskuar janë ata që udhëtojnë në vende ku Malaria është endemike. Shtatzënat mund të transmetojnë parazitin fëmijëve të tyre gjatë lindjes.

### 6. Nëse do të udhëtoj në një vend endemik të Malaries çfarë mjekimi parandalues duhet të marr?

Ka një listë medikamentesh kundër Malaries në varësi të vendit endemik ku do të shkoni. Mjeku juaj ju këshillon cili është më i përshtatshëm për ju bazuar në historinë tuaj mjekësore. Kontakti me mjekun duhet bërë 4-6 javë përpara se të niseni për udhëtim.

### 7. Sa kohë pas kthimit në shtëpi mund të shfaq simptomat e Malaries?

Çdo udhëtar i cili sëmurët me simptoma të ngjashme me një të ftohur të thjeshtë deri në një vit pas kthimit në shtëpi duhet të drejtohet menjëherë për të marr kujdesin shëndetësor për tu mjekuar kundër Malaries.



# Dieta

## Veza, tableta multivitaminike natyrale

Maksimumi i vlerave ushqyese në minimum kalorish

FJORDA KOROMANI

**A bëjnë mirë vezët për kolesterolin?**

Veza ka kolesterol dhe dieta e pasur me kolesterol rrit nivelin e tij në gjak. Megjithatë, sesa ndikon kolesterolin i marrë nga ushqimet në rritjen e nivelit të tij në gjak, varion nga personi në person. Konsumimi i tepërt i vezës mund të çojë në rritje të kolesterolit në gjak, por studime kanë treguar se 4 të verdha veze në javë nuk e rrisin rrezikun për sëmundje të zemrës. Kur vendosni të futni vezën në dietën tuaj, merrni parasysh kufijtë dorë të rekomanduar të kolesterolit:

- Nëse jeni i shëndetshëm, kufiri dietetik i kolesterolit është 300 mg në ditë.
- Nëse keni sëmundje kardiovaskulare, diabet ose nivel të lartë të LDL (kolesterolin i keq) kufiri dietetik është më pak se 200 mg në ditë.
- Një vezë ka 186 mg kolesterol, e gjitha ndodhet tek e verdha e vezës (e bardha nuk ka) që do të thotë, nëse konsumoni një vezë në ditë, duhet të kontrolloni kolesterolin në ushqimet e tjera gjatë ditës.

Veza bën pjesë në listën e 10 super-ushqimeve dhe jo pa arsye! Pavarësisht përmasave të saj (përveç vezës së strucit) ajo përmban një sasi të madhe substancash ushqyese themelore për shëndetin tonë. E verdha e vezës, por edhe e bardha esaj përmbajnë një sasi të madhe proteinash dhe kolinë duke u përdorur gjerësisht në recetat e gatimit. Për shkak të përmbajtjes në sasi të mëdha të proteinave, Departamenti i Agrikuturës së Shteteve të Bashkuara i fut vezët në kategorinë e mishit në piramidën

**E verdha e vezës, por edhe e bardha esaj përmbajnë një sasi të madhe proteinash dhe kolinë duke u përdorur gjerësisht në recetat e gatimit.**

ushqimore. Pavarësisht të mirave ushqimore që ka veza, këto mund të prishen dhe të japin efekt të kundërt nëse ajo nuk është ruajtur në kushte të mira (në temperaturë të ulët), nëse pula nuk është e vaksinuar si dhe nëse dikush ka alergji prej saj. Por cilat janë përfitimet nga konsumimi i vezës?

### 1. PËRMIRËSON PËRQËNDRIMIN

Ushqyerja e mirë ndikon drejtpërdrejt në aftësinë e fëmijës suaj për të mësuar. Kërkimet kanë treguar se konsumi i një mëngjesi të mirë dhe të ekuilibruar përmirëson përqëndrimin dhe vëmendjen e fëmijës, aftësitë e tij në matematikë dhe rezultatet në provime. Nisja e ditës me një mëngjes të shëndetshëm që përfshin dhe vezët, i jep organizmit tuaj dhe të familjes suaj pikërisht vaktin e balancuar. Kjo sepse pothuajse të gjithë substancat ushqyese themelore që i duhen trupit tuaj gjenden te veza. Veza është e mbushur me 14 ushqyese themelore dhe vetëm 5 gram yndyrë e 70 kalori.

### 2. SHIJE

Veza ka shije shumë të mirë, por nëse nuk ju pëlqen, ka një mijë mënyra për ta futur në recetat gatimi dhe ti përshtatën shijëve të secilit.

### 3. MENAXHIM I PESHËS

Proteina që ndodhet në vezë mund tju ndihmojë të bini në peshë, duke i kontrolluar vlerat me të cilat trupi juaj thith kaloritë. Një studim i kohëve të fundit ka treguar se një mëngjes me bazë veze ka të njëjtat kalori si një mëngjes me bazë gjevreku. Ata që hanin vezë në mëngjes, konsumonin 163 kalori më pak në drekë, kishin më pak uri dhe në harkun kohor të 24-orëve, konsumonin 418 kalori më pak. Kur mundoheni të menaxhoni peshën tuaj, zgjidhni ushqimin që ju jep maksimumin e vlerave ushqyese për



minimumin e kalorive. Veza është e rëndësishme për ata që po mundohen të bien në peshë sepse ka 14 substanca themelore ushqyese dhe përmban vetëm 70 kalori.

### 4. ZHVILLON TRURIN

Veza i jep energji trurit. Koli-

na, substancë që gjendet tek e verdha e vezës, nxit zhvillimin dhe funksionin e trurit. Kolina njihet si një nga ushqyjet themelore të organizmit tonë, por nuk prodhohet dot nga trupi ynë në sasi të duhura, është e nevojshme marrja e saj nëpërmjet ushqimit.

Mjaftojnë dy vezë për të marrë sasinë e nevojshme ditore të kolinës për organizmin tonë.

### 5. MBRON SYTË

Vezet ndihmojnë për të mbajtur sytë të shëndetshëm. Luteina dhe zeaksantina që ndodhen në të, i mbrojnë sytë nga dëmtimi i rrezëve ultravjollcë dhe dielli. Këta dy antioksidantë mbrojnë nga degjenerimi i makulës për shkak të moshës (shkaku kryesor që çon në rënie ose verbim në njerëz mbi 65 vjeç) sidhe ul rrezikun për kataraktë.

### 6. ENERGJI QË ZGJAT

Futja e vezëve në vaktet tuaja, ndihmon në furnizimin me energji dhe ngopjen tuaj duke evituar kështu urinë dhe ngërën pa orar. Proteina është substance më ngopëse dhe kontrollon vlerën me të cilën trupi thith kaloritë. Një vezë përmban 6 gram të proteinës më cilësore dhe ndodhet si tek e bardha edhe tek e verdha, por që të përfitoni plotësisht duhet ti konsumoni të dyja.

Veza është një nga ushqimet e pakta që kanë proteina komplete. Një proteinë komplete i ka të nënta aminoacidet themelore (esenciale) që trupi juaj nuk i prodhon dot. Aminoacidet quhen ndryshe tullat ndërtuese të trupit sepse formojnë proteinat dhe rrjedhimisht janë jetësore për trupin dhe shëndetin e tij. Përveç energjisë (kalorive) që i japin trupit, proteina është themelore për ndërtimin dhe riparimin (korrigjimin) e indeve të dëmtuara sidhe mbajtjen e trupit të fortë dhe të shëndetshëm. Muskujt, organet, lëkura, flokët, madje dhe antitruajt, enzimat, hormone janë të gjitha të përbëra nga proteinat. Ato gjithashtu ndihmojnë në luftimin e infeksioneve, mbajtjen e ekuilibrit të lëngjeve sidhe ruajtjen e metabolizmit.



- **Kolina**
- **Folatet**
- **Hekuri**
- **Luteina dhe Zeaksantina**
- **Niacina**
- **Acidi yndyror omega-3**
- **Proteina**
- **Riboflavina**
- **Vitamina A**
- **Vitamina B12**
- **Vitamina D**
- **Vitamina E**
- **Zink**

Merr pjesë në zhvillimin e trurit, funksionin e tij sidhe në kujtesë  
Ndihmojnë në krijimin dhe mirqënien e qelizave të reja sidomos të qelizave të kuqe të gjakut  
Transporton oksigjenin në qeliza dhe mban gjakun të shëndetshëm  
Ndihmon në mirqënien e shikimit, ul rrezikun e kataraktës dhe mbron sytë nga rrezatimi ultravjollcë  
Mban funksionin normal të nervave dhe ndihmon në çlirimin e energjisë P  
Përmirëson kolesterolin në gjak dhe ul rrezikun për sëmundjen Alzheimer  
Mban trupin të fortë dhe të shëndetshëm  
Mban indet e organizmit të shëndetshëm  
Ngadalëson procesin e plakës dhe mbron kundër disa kancerave  
Mbron kundër disa sëmundjeve të zemrës  
Ndihmon në mbajtjen e kockave dhe dhëmbëve të fortë  
Vepron si antioksidant dhe mbron qelizat kundër disa kancerave  
Mban sistemin imun të fortë

### 7. MULTIVITAMINI

Ka vetëm 70 kalori dhe plot 14 ushqyese esenciale dhe përveç kësaj, konsumi i vezës është si të merrni një tabletë multivitaminike natyrale.

### 8. PRAKTIKE

Vezet janë lëndë e parë në shumtësi. Me vezët në frigorifer gjithmonë mund të sajohet një vakt i shpejtë, i shijshëm dhe i ushqyeshëm. Kombinojini vezët me ushqime të tjera që mund tju kenë ngelur nga vakti paraardhës, pak kreativitet dhe mund të bëni omleta, frittata etj. Fatmirësisht, natyra na i ka dhënë vezët në porcione të gatshme, secila në zhgallin e vet.

### 9. FRESKI

Freskia e ushqimit që konsumoni është shumë e rëndësishme dhe për vezët në veçanti. Vezet pasi mblidhen në fermë, lahen, maten, paktohen dhe shpërndahen nëpër dyqane. Kjo procedurë merr rreth 3-7 ditë. Vezet janë nga të paktat burime të proteinave që mund të mbahen në frigorifer për 4-5 javë dhe të mos prishen. Data e skadencës që shkruhet mbi paketim tregon periudhën më të mirë që mund të konsumohet duke i ruajtur vlerat ushqyese në nivelin A. Për të ruajtur mirë, vendosini në frigorifer bashkë me kartonin e tyre paktes.

### 10. EKONOMIKE

Duke konsideruar faktin që janë shumë të ushqyeshme, të shijshme, praktike, lehtësisht të gatueshme, kostoja duhet të ishte e lartë, por nuk është kështu. Ndërkohë që gatime me bazë veze të blear mund të kushtojë shumë, një paketim standard ka kosto më të ulët dhe shpesh cilësi më të mirë.

# Fundshpina

## Shkaku: Qëndrimi ulur për një kohë të gjatë

Zgjidhja, streçing i shpeshtë dhe vaji i peshkut

TAULANT MUKA

**P**ërjetoni periudha të shkurtra dhimbjeje të mesit? Vëreni ngurtësi dhe dhimbje kur lëvizni nga një pozicion ulur në këmbë? Rrini ulur më shumë se 4 orë në ditë?

Nëse i përgjigjeni me po ndonjëherë prej pyetjeve të mësipërme ose të gjithave, atëherë ju mund të jeni duke vuajtur nga tendosja e muskulit fleksorë të kofshës. Muskujt që sjellin gjurin drejt gjoksit tuaj marin fillimin në pjesën e ulët të shpinës suaj dhe mund të jenë shkak kryesor i dhimbjes së pjesës së poshtme të saj.

### MUSKUJT FAJTORË

Muskuli iliopsoas është kombinim i tre muskujve të trupit që konvergjojnë në një muskul në kofshë, iliacus, psoas major dhe psoas minor. Këta muskuj fiksohen në pjesën e poshtme të shpinës e pelvisit duke u lidhur në majën e kockës së femurit. Muskuli psoas major fillon në pjesën lumbare të shpinës ku origjinet nga vertebra dhe disqet nga L1-L5 përpara së të kalojnë poshtë dhe të lidhet me moksujt e tjerë.

### FUNKSIONI I TYRE

Muskuli iliopsoas është jetik për sigurimin e posturës dhe lëvizjes. Ky muskul është më i fuqishmi ndër muskujt flektorë të kofshës dhe siguron ecjen, vrapin dhe qëndrimin në këmbë. Një shënjë e zakonshme e përfshirjes së muskulit iliopsoas është dhim-



## Zgjidhje të tjera natyrale për dhimbjen e mesit

Acidet yndyrore omega 3 janë anti-inflamator natyral dhe mund të gjenden në vajin e peshkut dhe midhje. Disa ushqime mund të shkaktojnë te njerëzit dhimbje mesit. Shumë persona kuptojnë se kur zbulojnë intolerancën e tyre ndaj një ushqimi dhe ndërpresin marrjen e tij, dhimbja e tyre e mesit lehtësohet dhe shpeshherë edhe zhduket. Gruri dhe sheqeri, për shembull, shkaktojnë inflamacion në trup. Domatja, patatja etj kanë qenë lidhur me artritin dhe me dhimbjen e përgjithshme të trupit. Stresi emocional mund të jetë gjithashtu shkak i dhimbjes së mesit. Prandaj, gjetja e mënyrave për të identifikuar dhe luftuar stresin është esenciale.

bja kur nga një pozicion ulur kaloni në pozicionin në këmbë. Shkak kryesor i tendosjes së muskulit iliopsoas është jeta sed-

entare duke përfshirë edhe periudhat e gjata të qëndrimit ulur.

**Si ndikon qëndrimi ulur**

### në dhimbjen e shpinës?

Njerëzit evoluuan për të funksionuar në mënyrë më efektive duke qëndruar drejt dhe lëvizur. Fatkeqësisht, qëndrimi ulur për periudha të gjata është bërë një normë. Duke qëndruar ulur, kofshët tuaj formojnë kënd 90° me bustin. Ky pozicion imiton vepërimin e mukujve iliopsoas i cili flekton (përkul) kofshën. Nëse qëndroni ulur për më shumë se një orë në ditë, moksuli mësohet me pozicionin ulur si pozicion normal. Kur ju ngriheni në këmbë, ju shtrini moksulin në një pozicion për të cilin moksuli nuk është përshtatur, duke shkatuar dhimbje. Meqënëse muskuli fiksohet në pjesën e poshtme të shpinës dhe është i shtrirë, dhimbja ndjehet në këtë pjesë të shpinës e ngjashme me dhimbjen e hernies diskale.

## Ja çfarë duhet të bëni...

Në mënyrë ideale, zgjidhja e problemit do ishte një qëndrim në këmbë dhe të paktën 30 minuta ushtrim fizik i moderuar çdo ditë. Gjithsesi, kjo mënyrë nuk është shumë praktike për pjesën më të madhe të personave. Aktiviteti tjetër më i mirë, për të lehtësuar simptomat, është streçingu. Një nga mënyrat më të lehta për të bërë streçing të këtij moksuli është qëndrimi i krevatit si asistentin tuaj.

■ Vendosni njërin gju në krevat me këmbën tjetër të vendosur në dyshemen e domës duke përdorur duart tuaja në krevat si stabilizues. Lehtësisht rrrëshqisni këmbën tuaj të vendosur në dysheme duke mbajtur këmbën tjetër në krevat. Kur nuk mund të rrrëshqisni më, përpiguni të mbani një qëndrim drejtë të shtyllës kurrizore. Ju do të arrini një pikë ku do të ndjeni një shtrirje të thellë në shtrirjen e legenit. Qëndroni në këtë pozicion për 10-15 sekonda dhe më pas përsëriteni ushtrimin në krahu e kundërt.

■ Ky është në thelb një zgjatim, por është më e lehtë për tu kryer dhe pak më specifike për muskulin iliopsoas. Duke bërë këtë ushtrim streçingu në mëngjes dhe në mbrëmje, mund të zgjasni shëndetin e shtyllës suaj kurrizore dhe eleminoni dhimbjet e mesit.



## Studimi

# Joga lehtëson e dhimbjen e mesit

**D**himbja e mesit është një nga darsyet kryesore pse njerëzit humbasin ditët e tyre të punës. Ata privohen nga shijimi i jetës së tyre dhe kryerjes së aktiviteteve që ata pëlqejnë. Fatmirësisht, studimet tregojnë se seancat e rregullta të jogës mund të jenë një mënyrë efektive për të luftuar dhimbjen e mesit.

100 të rritur me dhimbje mesit u bënë pjesë e një studimi në një qëndër shëndetësore ne Seattle, Sh.B.A. Për një periudhë dy javore, u vlerësuan përfitimet e jogas, ushtrimeve konvencionale fizioterape-

utike dhe instruksionet nga një libër shumë i famshëm mbi dhimbjen e mesit.

Njëri grup bëri senaca të rregullta joge, ndërsa në dy grupet e tjera, njëri ushtrime konvencionale dhe tjetri lexoi librin mbi dhimbjen e mesit.

Pjesëmarrësit që praktikuan 75 minuta jogë në javë përjetuan rritjen më të lartë të funksionit krahasuar me dy grupet e tjera.

Grupi i cili praktikoi joga kishte nevojë për më pak barna kundër dhimbjes. 60% e grupit të jogës ishin duke marrë medikamente për-

para fillimit të studimit. Në fund të 12 javëve, vetëm 21% e këtij grupi vazhdonin ende të merrnin barna kundra dhimbjes.

Në grupin që ishte duke bërë ushtrime konvencionale, përdorimi i barnave u ul në nivele minimale ndërsa në grupin që lexoi librin ky nivel u ulë në 50% nga 59%. Shumë persona që praktikojnë rregullisht jogën flasin për përfitimet që ata përjetojnë duke përfshirë edhe reduktimin e dhimbjes. Joga i ndihmon njerëzit të kuptojnë më shumë për mënyrën se si lëviz trupi.

Joga gjithashtu shtrir dhe oksigjenon trupin. Gjithsesi ka patur mungesë të dhënash që provojnë dobishmërinë e saj në trajtimin e dhimbjes së mesit.

**Shumë persona që praktikojnë rregullisht jogën flasin për përfitimet që ata përjetojnë duke përfshirë edhe reduktimin e dhimbjes**

# Estetikë

## Ndërhyrjet kozmetike jo-kirurgjikale? Rimendojeni!


Vendosni në peshore rreziqet dhe përfitimet

FJORDA KOROMANI

### 5 rregulla për të zgjedhur mjekun

- 1. Kualifikimet:** Kontrolloni kualifikimet, vetëm mjekët me licencë mund ta kryejnë këtë procedurë.
- 2. Titulli:** Mos u hutoni nga një titull i gjatë si : "Terapist apo praktikues estetik i avancuar". Kur kontrolloni titullin sigurohuni të gjeni titullin Doktor për personin që do ketë agën në dorë!
- 3. Trajtimi:** Praktikuesit e kësaj procedure kanë nevojë për trajtime dhe specializime të mëtejshme duke përfshirë këtu edhe mënyrën sesi të menaxhojnë reaksionin alergjik të shpejtë (anafilaksinë) apo efekte të tjera anësore.
- 4. Vendndodhja:** Trajtime si mbushja me botoks etj, duhet të kryhen vetëm në ambiente të pastra (sterile) për të evituar infeksionet. Nuk duhet të kryhen në ambiente si shtëpia, dhomë ku bëhen tatuazhet etj.
- 5. Substanca:** Kujdes, botoksi jepet vetëm me recetë dhe duhet të informoheni mbi efektet e tij didhe të mbushësve të tjerë. Mund të çojnë në dëmtime të qëndrueshme e të parikthyeshme.

**D**isa procedura kozmetike, si injeksionet e Botoksit, vërtet nuk bëjnë pjesë tek ndërhyrjet kirurgjikale, por kjo nuk do të thotë që nuk kanë risqe dhe efekte anësore. Si fillim, duhet t'i drejtoheni dikujt që eksperiencën e duhur në këto procedura. Procedurat kozmetike jo kirurgjikale përfshijnë produkte (si botoksi) dhe teknika të cilat kanë si qëllim të bëjnë lëkurën tuaj të duket më e lëmuar apo për të hequr shenja të ndryshme. Përpara se të kryeni një procedurë të tillë, kuptoni dhe informohuni mirë se në çfarë konsiston, çfarë risqesh ka dhe sa i mirë do jetë ndryshimi, pra peshoni rreziqet me përfitimet sidhe koston ekonomike.



#### Po sikur të ndihem keq pas procedurës?

Nëse keni bërë një ndërhyrje jo kirurgjikale dhe nuk ndiheni mirë, shkoni menjëherë të mjeku. "Prioritet është shëndeti," thotë Professor Kay. " Nëse keni simptoma alarmante si temperaturë, skuqje e lëkurës dhe njolla të kuqe, inflamacion dhe dhimbje shkoni te mjeku i përgjithshëm ose ambulancën më të afërt. Problemet më pak urgjente duhet të konsultohen me specialistin përkatës (mjekun që ju ka ndjekur).

#### Ku mund të kryej një procedurë jo kirurgjikale të sigurt?

Trajtimet kozmetike me injeksion (si Botoksi) duhet të kryhen vetëm nga mjekë specialistë të trajnuar mirë. Nuk duhet në mënyrë absolute të kryhen nga terapeutë të bukurisë të cilët nuk kanë fare formim klinik.

#### Cilat janë rreziqet e këtyre procedurave jo kirurgjikale?

"Procedurat jo kirurgjikale, zakonisht përfshijnë injeksione si të toksinës se botulinës ashtu dhe të mbushësve të tjerë dhe kanë më pak rreziqe se ndërhyrjet kirurgjikale," thotë Profesor Simon Kay, anëtar i British Association of Plastic, Reconstructive and Aesthetic Surgeons (BAPRAS). "Megjithatë, mbi-korrigjimi mund

të jetë i vështirë për tu kryer ashtu sidhe vendosja asimetrike e mbushësit apo reaksionet alergjike." Ai këshillon të pyesni se çfarë duhet të bëni nëse këto ndodhin dhe të jeni në dijeni për mbushësit dhe reaksioneve alergjike që jep secili prej tyre.

A më duhet të konsultohem

#### me mjekun para se të bëj botoks?

Po. Duhet me patjetër të takoni dhe bisedoni me mjekun para se te vendosni të përdorni botoks, disport, vistabel apo substancë të tjera dhe të siguroheni që mjeku është në dijeni të shëndetit tuaj të përgjithshëm dhe sëmundjeve të kaluara, por mbi të gjitha mbi arsyet që ju kanë çuar të vendosni për këtë ndërhyrje!

### Hollivud

## Dështimet e famshme të ndërhyrjeve

E dhe pse mund të kenë qënë në duart e specialistëve më të mirë, kanë qënë viktimat të dështimit të ndërhyrjeve estetike. Disa sepse kanë ditur të ndalen, disa ndoshta prej paaftësisë së mjekut, disa sepse nuk janë kujdesur mirë..... përfundimi është si më poshtë

Priscilla Presley ka qënë një prej vajzave më të bukura në Hollywood. E karakterizuar nga një bukuri klasike ishte shumë e përpitur ndërhyrja e saj me Botoks e pasuar dhe nga shumë ndërhyrje të tjera krejtësisht të panevojshme. Në tentativë për të kthyer rininë e saj, ka përfunduar me një fytyrë krejt të deformuar, buzë tepër të fryra, një ngjerdheshje për buzëqeshje!

Amanda Lepore është dhe një nga transkualët më të famshëm, ka patur një numër të madh ndërhyrjesh të cilat i ka filluar që në moshën 15 vjeçare. Tanimë, lëkura e saj e shtrirë në mënyrë të egzageruar ngjan si gomë. Nëse vazhdon kështu shumë shpejt do konkurojë Xhokerin te Batman.

Daryl Hannah ka qënë ikonë e

bukurisë në vitet 80' me filmin e saj "Splash" dhe e mbajti titullin edhe pas 20 vitesh në filmin "Kill Bill". Për fat të keq tani nuk njihet më, ka mbetur pothuajse asnjëgjë nga bukurshja e dikurshme. E ka humbur bukurinë natyrale duke tentuar të bëjë lifting të syve, botoks dhe implante të mollëzave. Ni-

kki Cox dikur një vajzë seksi, natyrale me çdo gjë në vendin e duhur, sot edhe pse është ende e re, pothuajse nuk njihet! Ajo ka ndërhyrë me injeksione në buzë dhe mollëza dhe implante. Sytë e tërhequr në atë mënyrë tregojnë se ka tentuar të bëjë lifting të syve, por pa sukses!




Amanda Lepore

### Çfarë trajtimesh jo-kirurgjikale ekzistojnë?

Ka një sërë procedurash në dispozicion duke përfshirë:

- Paralizë të muskullit, si injeksionet me toksinën e botulinës (botox) për relaksim dhe muskuje të fytyrës dhe për të bërë vijat dhe rruadat në fytyrë më pak të dukshme.
- Mbushës dermal (të lëkurës), injektohet brenda rrudhave duke i mbushur.
- Mikrodermabrazion, përdor kristale shumë të imët dhe vakum për të hequr qelizat e vdekura të lëkurës
- Lazer jo kirurgjikal dhe trajtime me dritë me intensitet të lartë si në rastin e depilimit definitiv.
- Disa nga këto trajtime mund ta lënë zonën e trajtuar të kuqe dhe shumë të ndjeshme me ja



Nikki Cox

# Kuriozite

## Pyetje doktorit pas birrës së tretë

Lloji i mbathjeve dhe lidhja me fertilitetin

JANA NANO



## Pickimi 3 hapat që duhen ndjekur

### A duhet ta thithni jashtë helmin kur ju pickon një gjarpër?

Fatkeqësisht kjo nuk është më një praktikë e pranuar. Thithja e pickimit jo vetëm që është ineffektive, por mund të çojë edhe në infektim të lëkurës së dëmtuar. Sipas parimeve të urgjencës, gjëja e parë që duhet të bëni në një aksident të tillë është:

1. Lani vendin e kafshimit me ujë dhe sapun.
2. Imobilizoni sipërfaqen ku ka ndodhur kafshimi dhe mbajeni nën nivelin e zemrës
3. Kërkoni ndihmë mjekësore.

### ■ Ekspertët e toksikologjisë sygjerojnë

Nëse e lidhni zonën mbi kafshim atëherë mund të ndaloni shpërndarjen e helmit në pjesë të tjera të trupit. Pacienti duhet të transportohet menjëherë pranë spitalit më të afërt për të marrë trajtimin e duhur.

### Pse meshkujt ngrihen në mëngjes të erektuar?

Këto lloj ereksionesh të pavetëdijshme ndodhin gjatë fazës REM të gjumit. Ajo karakterizohet nga një lëvizje e shpejtë e syve dhe është periudha kur "prodhohen" ëndrrat. Kjo fazë është shumë më e shpeshtë pak përpara zgjimit. Kjo është arsyeja pse shumë meshkuj ngrihen në mëngjes të erektuar.

### A ndikon forma apo lloji i mbathjeve që vishni në fertilitetin tuaj?

Çdokush ka një preferencë. Presidenti Bill Clinton u shpreh njëherë në kanalën muzikor MTV që ai preferonte bokset. Dikur mendohej se nëse vishje të brendshme të ngushta mund të ndikonte në infertilitetin mashkullor pasi rriste temperaturën e testeve duke frenuar prodhimin e spermatozoidëve. Në vitin 1998, Revista shkencore e Urologjisë, publikoi një studim i cili kishte analizuar problemet e fertili-



tetit të 97 meshkujve. Gjysma e tyre vishnin bokse, të tjerët të mbathur tradicionalisht. Kërkuesit matën temperaturën e brendshme, të lëkurës të të dy grupeve duke mos gjetur asnjë diferencë sinjifikante në cilësitë apo sasinë e prodhimit të spermatozoidëve. Qëllimi i qeses

skrotale, ku vendosen të dy testet, është të ruajë një temperaturë trupit më pak se 50 se pjesa tjetër e trupit. Prandaj, lloji i të brendshmeve që vishni nuk bën diferencë.

### A ka sperma vlera ushqyese?

Sasia e ejakulimit mesatar është në masën e një luge çaji. Aty përmbahen rreth 300 milion spermatozoidë, të cilët në total përbëjnë rreth 5 Kalori. Këto kalori vijnë nga proteinat enzimatike dhe sheqernat të sekretuara nga gjendra e prostatës pikërisht për të prodhuar energjinë e nevojshme që i duhet spermatozoidit "të notojë". Në lëngun seminal gjendet ujë, vitaminë C, fosfate, zink dhe prostaglandina. Tamam një mëngjes kampionësh!

### A ndihmon aplikimi i gjalp-it në lëkurë kur digjemi?

Jo, aspak! Vendosja e gjalp-it mbi lëkurën e djegur do të bllokojë nxehtësinë e lëkurës dhe do të zgjasë

akoma më shumë dhimbjen. Këshillohet të aplikojehet ujë i ftohtë. Në literaturën mjekësore indiane përdoret mjaltë dhe lëkura e patates së zjerë. Mjalti përdoret shpesh për vetitë e tij antibakteriale, ndërsa lëkura e patates ka një funksion hidratues. Gjithsesi, mënyra më e mirë kur digjen nga një tigan i nxehtë është të aplikoni ujë të rrjedhshëm të ftohtë e më pas ndoshta ndonjë krem me antibiotik.

### A ndihmon pasta e dhëmbëve kundër akneve?

Ka shumë mënyra sesi mund të kujdesemi për aknet e shëmtuara në kushte shtëpiake. Disa nga këto forma janë aplikimi i uthullës, kokrrave të kafesë, jodit, sheqerit, kripës dhe pasta e dhëmbëve. Shumë përdorin alternativën e fundit. Shkencërisht nuk është provuar asnjëherë që kjo mund të funksionojë në zhdukjen e tyre, ama mund të zhdukë shenjat e kuqe të inflamacionit.

## Kompjuteri


### Kujdesi ndaj syve për përdoruesit e tij

Kompjuterat tashmë janë pjesë e pandarë e ambienteve tona të punës. Kombinimi i posturës fikse, kontrakturës së trupit, mbingarkesës së punës dhe ambientit të papërshtatshëm mund të shkaktojë shumë probleme mjekësore si dhimbje të shpinës, shpatullave, kyçeve të duarve, qafës dhe natyrisht edhe shikimit.

Njeriu normal kapsit sytë rreth 16-20 herë në minutë. Kjo mbyllje e herëpashershme siguron lubrifikimin e vazhdueshëm të syrit. Nëse reduktohet në rreth 6-8 herë në minutë rezultojnë zhvillimin e atij që quhet "syri i tharë". Fokusimi nga afër për një kohë të gjatë shkakton tensionim të muskujve të syve.

Prandaj, në shumë persona instalohet një gjendje mjekësore e quajturë presbiopia që shprehet me nevojën për të mbajtur syze optike gjatë leximit. Simptoma të tjera përfshijnë dhimbjen e kokës, vizion i turbulluar, sy të thatë të irrituar, ndjeshmëri e shuar ndaj dritës, dhembje qafe apo shpine etj.

Faktorët që predispozojnë këtë gjendje janë: kushtet e vendit të punës, natyra e punës që kryeni, kohëzgjatja e qëndrimit përpara kompjuterit, gjendja shëndetësore e syve tuaj.



## Estetikë


### Veza, maskë për lëkurën

Përdorimi i vezës si maskë për lëkurën, vjen që nga antikiteti. E bardha e vezës pastron, tonifikon dhe shërben si eksoliant (largon qelizat e vdekura), e verdhja shërben si ushqyes dhe zbutës. Është e lirë, praktike dhe funksionale.

#### JU NEVOJITET:

- " Një vezë
  - " Disa pika limoni (sipas dëshirës)
- Përhapeni në lëkurën e fytyrës

dhe qafës me gishta (më parë ta keni larë dhe tharë fytrën me ujë dhe sapun të thjeshtë). Mos i leni sytë dhe buzët (nëse doni, mund të vendosni sipas dëshirës, rrota trangu ose bustina kamomili të zhytura më parë në ujë tek sytë). Shtrihuni, qetësohuni dhe mbajeni 20-25 minuta derisa të thahet. Shplaheni me ujë të vakët dhe përsëriteni procedurën dhe me të verdhën e vezës. Në fund shplaheni me pak ujë të ftohtë.



**Si të veproni:**  
Ndajeni të verdhën e vezës nga e bardha në dy tasa, kujdes të mos i përzieni. Nëse e keni lëkurën të yndyrshme, shtoni disa pika limoni tek e bardha e vezës, do ndihmojë në largimin e saj (mos shtoni limon nëse keni lëkurë të thatë).

## Këshilla praktike

- Një karrige komode ku këmbët tuaja pushojnë mbi dysheme. Këndi i gjurit duhet të jetë 90°. Krahet duhet të pushojnë në tavolinën e punës. Shpina juaj duhet të mbështetet përgjatë gjithë gjatësisë së saj në karrige.
- Drita duhet të jetë e përshtatshme. Raporti i dritës së tavolinës tuaj me ambientin e zyrës duhet të jetë 3:1.
- Monitori i kompjuterit duhet të mbahet rreth 13-15 cm nga sytë tuaj. Ideale do të ishte që pamja të qëndronte rreth 15 cm poshtë nivelit horizontal të syve tuaj
- Vendosini kompjuterit një ekran anti-reaklektues
- Aplikoni rregullin 20-20! Bëni pushime të shkurtra çdo 20 minuta, për 20sekonda dhe shikoni sa më larg
- Korigjoni problemet e shikimit me zyeve optike. Është mirë që edhe këto të fundit të kenë shtresën anti-refleks.
- Ata që përdorin lende duhet të lubrifikojnë sytë herëpashere.
- Ekzaminoni sytë tuaj të paktë një herë në vit



Padia, dhunon të atin pas martesës me gruan e dytë

Shtetasi A.T, është 56 vjeç, ai jeton në Paskuqan dhe është me prejardhje nga Dibra. Së fundmi ai i është drejtuar gjykatës së Tiranës pas dhunës që i biri 30 vjeç ushtronte ndaj tij. Shkak ishte fakti që burri ishte martuar sërish pas vdekjes së bashkeshortes, vendim ky që nuk është pritur aspak mirë nga djali. Gjykata vëren se "paditësi A.T. është martuar sërish dhe ky

fakt është bërë shkak për konflikte të vazhdueshme midis palëve. Konflikti i fundit ka ndodhur në dt.30.08.2012, ku ndërmjet palëve është acaruar dhe paditësi pretendoi se djali e ka goditur në mes të lagjes. Dhuna e përdorur nga djali dukej qartë në fytyrën e babait, pasi kishte të dallueshme disa pjesë të mavijosura. Në këto kushte paditësi paditësi ndihet tepër i kërcënuar për jetën".

Për këtë arsye babai ka kërkuar urdhër mbrojtjeje ndaj djalit. Dhuna në familje ka marrë një përshkallëzim të madh në tre vitet e fundit. Çdo ditë në Tiranë regjistrohen mesatarisht dy raste dhune në familje. Gjatë këtij viti në sallën operative të Policisë së Tiranës rezultoi të jenë kryer rreth 600 telefonata nga persona që denoncojnë dhunën në familje.


Zbardhet letra kreut Metalla drejtuar Kryeinspektores

KLD neglizhoi shkeljet në Durrës

Inspektoriati përpiloi raportin, nuk pati ndëshkime

Lajmi

Këshilli i Lartë i Drejtësisë është njoftuar zyrtarisht që në vitin 2009 për vonesat në zbardhjen e vendimeve nga disa gjykatës të Durrësit. Ka qenë vetë kreu i gjykatës që ka dhënë alarmin. KLD ka bërë një raport inspektimi por nuk u mor asnjë masë ndëshkuese ndaj gjyqtarëve përgjegjës.



Faksimile e kërkesës së kryetarit të Gjykatës së Durrësit drejtuar Inspektoriatit të KLD-së

dhe analizë të gjendjes në gjykatën e Durrësit, por y relacion është lënë më pas në hije dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim tjetër", - thanë burime nga KLD-ja.

TABAKU

Shkak i daljes në pah të këtyre dokumenteve të vjetra është skandali që përfshiu gjykatën e Durrësit kur u mësuara se gjykatësi Neritan Tabaku nuk kishte zbardhur prej disa muajsh vendimin e

Gjykatësi Tabaku u përfshi në epiqendër të një skandali gjyqësor pas ngjarjes së rëndë ndodhur muajin e kaluar në Shijak, ku mbeti i vrarë kryekomisari Adem Tahira

pafajësisë ndaj një emiri të njohur të botës së kriminit. Gjykatësi Tabaku u përfshi në epiqendër të një skandali gjyqësor pas ngjarjes së rëndë ndodhur muajin e kaluar në Shijak, ku mbeti i vrarë kryekomisari Adem Tahira. Vrasësi i Tahirajt ishte një kriminel i regjuri u quajtur Ilir Xhakja. Ai ishte arrestuar në vitin 2007 në bazë të një vendimi gjyqësor që e shpallte atë fajtor për një vrasje të kryer në vitin 1999. Pas arrestimit Ilir Xhakja mori dënimin edhe nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda. Ai këtë vendim e atakoi në Gjykatën e Lartë duke ngritur pretendimin se Gjykatat për Krimet e Rënda nuk ishin kompetente për çështjen që akuzohej ai, pasi akuzua nuk ishte për vrasje në rrethana cilësuese por për vrasje me paramendim. Gjykata e Lartë e gjeti të drejtë këtë pretendim të Xhakjës dhe në vitin 2009 vendosi gjykimin e çështjes së Ilir Xhakjës nga Gjykata e Rrethit të Durrësit e cila kishte të juridiksionin mbi ter-

Shpërdorimi

Tabaku, prokuroria shqyrton masën e sigurisë

Një vendim i një jave më parë i Këshillit të Lartë të Drejtësisë i hap rrugë hetimit të gjykatësit durrsak Neritan Tabaku. "KLD ja shqyrtoi Këshilli i Lartë i Drejtësisë, më mbledhjen plenare të datës 05.10.2012, pati në fokus të rendit të ditës, shqyrtimin e kërkesave për procedime disiplinore të disa gjyqtarëve. Me vëmendjen e veçantë të Këshillit, u trajtua kërkesa e Prokurorisë së Përgjithshme për dhënien e autorizimit për procedim, ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, z. Neritan Tabaku. Në respektim të Kushtetutës dhe të ligjit, Këshilli unanimisht miratoi këtë kërkesë, duke i dhënë rrugë procedimit penal ndaj gjyqtarit të sipërcituar, për veprën penale të 'Shpërdorimit të detyrës', - njoftoi zyrtarisht Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Pas dorëzimit të këtij vendimi në rrugë zyrtare në Prokurorinë e Tiranës, kjo e fundit mund të kërkojë edhe një masë sigurimi "arrest me burg" për gjykatësin nisur nga rrethanat e flagrancës në të cilat ai është konstatuar. "Ende nuk ka ardhur në rrugë zyrtare vendimi i KLD-së që i hap rrugën procedimeve nga ana jonë.

TIRANE

HABJON HASANI

Një kërkesë e Kreut të Gjykatës së Durrësit dërguar KLD-së në vitin 2009 hedh dritë mbi dënimin e plotë të institucionit të KLD-së mbi problemet që kishin shkaktuar disa gjyqtarë në Durrës me vonesat në zbardhjen e vendimeve. Shkresa është e Shtatorit të vitit 2009 dhe mban firmën e kreut të gjykatës Ervin Metalla, i cili i është drejtuar Inspektoriatit të KLD-së që të vinte në gjykatë dhe të inspektonte dosjet e disa gjykatësve të cilët rezultoni me vonesat të mëdha në zbardhjen e arsyetimit të vendimeve. Në kërkesën e dërguar nga Metalla janë bashkëlidhur edhe të gjitha vendimet e dyshimta të këtyre gjykatësve mes të cilëve është dhe gjykatësi Neritan Tabaku, që në këtë kërkesë të vitit 2009, rezultonte me të paktën 11 dosje dhe vendime të pazbardhura. Shqiptarja.com u interesua dje pranë KLD-së për të mësuara më shumë rreth reagimit të këtij institucioni pas ankesës së kreut të Gjykatës së Durrësit. "Disa javë pas mbërritjes së kësaj kërkesë është dërguar një grup inspektimi në vitin 2009, grupi ka bërë dhe një relacion të plotë



BLOG/ Joga dhe Ju NGA ANILDA NOCKA

Principet e praktikës së Jogës

Joga e vërtetë, e praktikuar në mënyrë korrekte, me teknikën, formën, pozicionimin e duhur, fokusin, frymëmarrjen e koordinuar, ka efekte shëruese. Në nivele dhe kategori të ndryshme. Hap horizonte të reja të mendimit, përqëndrimit dhe qartësisë në jetën e përditshme.

Joga është kaq e fuqishme. Gjithashtu me praktikën e përditshme Joga ndihmon për të humbur centimetra e tepërt, bazuar në principet e shërimit, rigjenerimit dhe forcimit. Është e qartë që në fillim të një praktike, si për instruktorin dhe praktikuesin, se si Joga ndihmon në humbjen e peshës. Kjo humbje ndodh nëpërmjet shërimit në thellësi të atyre aspekteve në trupin tonë që janë jo në balancë - organet e brendshme, katalizatorët e gjithë trupit: mëlcinë, metabolizimin, sistemin nervor, trurin, etj. Joga ndihmon në djegjen e kalorive me intensitet dhe inteligjencë. Praktika e Jogës është praktikë inteligjente, duke njohur veten dhe trupin dhe duke respektuar limitet si individ. Joga është pafundësisht e ndjeshme dhe e fuqishme në të njëjtën kohë, sepse punon në një tjetër nivel principesh.

Në Joga, vihet në përdorim shkenca e integriteti të frymëmarrjes, relaksimi dhe tensionimi i nervave, masazhet e brendshme të gjendrave kryesore të sistemit limfatik dhe organet e ndryshme që ndikojnë në qarkullimin e gjakut dhe të limfës në të gjithë organizmin. Në këtë mënyrë nëpërmjet praktikës krijohet në mënyrë konstante një energji dhe forcë të brendshme. Joga shëron nëpërmjet ngritjes së fluksit të gjakut, limfës, oksigjenit, elektricitetit dhe ndjeshmërisë brenda trupit. Në esencë Joga është energji që lëviz në mënyrë harmonioze dhe inteligjente në trup. Mendoheni Jogën si një kombinim të levizshëm, të mendimit dhe masazhit të brendshëm.

Joga jep energji dhe kërkon pak energji. Ju përdorni aq energji sa është e nevojshme për të qëndruar në çdo pozë dhe e ndjen energjinë në atë moment dhe më vonë. Në qoftë se menjëherë ndjehesh i rigjeneruar, relaksuar, më i qetë, i përqëndruar, krijues, atëherë e kupton se je nën efektin pozitiv të praktikës. Asnjëherë nuk është ide e mirë të forcosh apo shtysh veten më shumë se trupi të lejon në atë moment të praktikës. Duke e forcuar veten më shumë se duhet humbet pjesën më thelbësore të Jogës.

Sekretet e një praktike të rregullt personale është më gjokosh veten apo rezultatet e arritura në atë ditë; kryesore është të pranosh momentin dhe kënaqësinë e praktikës. Efekti është gjithmonë në anën pozitive.



### Dhunohej nga bashkëshorti, merret në mbrojtje gruaja

E dhunuar barbarisht nga bashkëshorti në mënyrë sistematike dhe e ofenduar, një grua 34-vjeçare ka kërkuar ndihmën e forcave të policisë. Burime zyrtare nga policia e Durrësit bëjnë me dije se 34-vjeçarja ka plotësuar kërkesë-padinë për lëshim urdhri mbrojtje të menjëhershëm. Sipas dëshmisë së 34-vjeçares në polici, bashkëshorti i saj 36-vjeç me iniciale L.N,

ka ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike ndaj saj. Menjëherë pas denoncimit, policia ka vënë në pranga bashkëshortin e saj. Ndërsa 34-vjeçarja është dërguar për mjekim në spital. Dhuna në familje vijon të jetë një problem mjaft shqetësues. Vijon te jetë i lartë numri i kërkesave për lëshim urdhri mbrojtje që bëhen në gjykatë. Ndërkohë që vetëm para dy

ditësh Gjykata e Tiranës la në qeli Edmond Dokun, i cili ekezkutoi me thikë bashkëshorten e tij. Rolanda Doku kishte kërkuar urdhër mbrojtje në gjykatë për shkak të dhunës sistematike të bashkëshortit. Vetëm katër ditë pas lëshimit të këtij urdhri, Edmond Doku u paraqiti në banesën e 36-vjeçares duke e vrarë.

## Gjyqtari Gurali Brahimllari mungon në seancë

LAJME SHKURT

### Krimi pasionant, arrestohet pas 19 vjetësh autori

Policia e Elbasanit ka vënë në pranga një 47-vjeçar të shpallur në kërkim për vrasje prej 19 vjetësh. Shtetasi Dervish Toska nga fshati Dragot, ka vrarë në 8 korrik të 1993 një 38-vjeçar për motive të dobëta. Gjykata e ka dënuar me 23 vjet burg, duke e shpallur fajtor për vrasjen e Agim Blogut, 38-vjeç. Vrasja është kryer në bashkëpunim me bashkëshorten e të ndjerit, Qerime Blogu, në atë kohë 36-vjeçe. Gruaja është dënuar me 20 vjet burg dhe aktualisht është duke vuajtur dënimin. Vrasja ka ardhur pasi bashkëshorti i saj ka zbuluar lidhjen intime mes Toskës dhe bashkëshortes. I arrestuari do të mbahet në qeli deri në përfundim të përgatitjes së dokumenteve, ku do të caktohet data e nisjes së vuajtjes së dënimin.

### Kanosi punonjës in e karburantit, pranga 29-vjeçarit

Ka kanosur me armë punonjës in e karburantit, ndërsa është arrestuar nga policia. 29-vjeçari Agron Karanxhaku nga fshati Tren i Devollit është vënë në prangat e uniformave blu nën akuzën e kanosjes dhe armëmbajtjes pa leje. Burime zyrtare nga policia thanë se Karanxhaku akuzohet se pranë një pike karburanti në Bllisht ka kanosur me armë zjarri tip pistolët punonjës in e kësaj pike karburanti. Pas identifikimit dhe ndalimit të 29-vjeçarit, materialet në ngarkim të tij i kanë kaluar Prokurorisë së Korçës për veprën penale kanosje dhe mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake.

### Lajmi

Dritan Dajti e ka komentuar si fitoren e tij të parë me drejtësisë tërheqjen e padisë së gjyqtarit Gurali Brahimllari. Në sallën e gjyqit i pandehuri ka kërkuar që të ishte prezent vetë gjyqtari, që e akuzoi për fyerje.

# Fyerjet e Dajtit tërhiqet gjyqtari

## Dritan Dajti: Kjo është pafajësia ime e parë

TIRANE

ANXHELA TATO

Kjo është pafajësia ime e parë", fjalët e Dritan Dajtit pas tërheqjes së padisë nga gjyqtari Gurali Brahimllari. Ndërsa ka insistuar që në sallën e gjyqit të ishte i pranishëm edhe vetë gjyqtari Brahimllari, i pandehuri Dritan Dajti e ka komentuar pushimin e çështjes si fitoren e tij të parë. I akuzuar si autor i masakrës së Durrësit, ku mbetën të vrarë katër efektive policie, Dritan Dajti ka kërkuar që të verifikohet nëse është dorëzuar shkresa për tërheqje padie nga ana e gjyqtarit. Pas marrjes së përgjigjes nga kryesuesi i çështjes Petrit Çomo se shkresa është verifikuar, Dajti ka kërkuar sërish fjalën duke pretenduar që gjyqtari Brahimllari të ishte prezent në sallë. I pandehuri ka kërkuar disa herë të flas para togave të zeza. Pasi është vënë në djeni se padia është tërhequr, Dajti është shprehur: "Pse të pushohet çështja, le të vashdojë gjykimi". "Ku është gjyqtari Brahimllari që më paditi mua, i qëndroj pretendimit tim që gjyqtari të jetë në sallën e gjyqit", ka reagur



Dritan Dajti



Gurali Brahimllari

Dajti. Ka qenë gjyqtari Gurali Brahimllari, i cili ka paditur Dritan Dajtin për fyerje. Në seancën e kaluar gjyqësore Dajti e ka quajtur këtë akuzë të qëllimshme. "Procesi është një farsë dhe i trilluar. Akuzat ndaj meje është e qëllimshme", fjalët e të pandehurit. Gjatë seancës së parë gjyqësore i pandehuri Dajti kërkoi që të thirreshin si dëshmitarë dy prokurorët e çështjes Eugen Beçi dhe Ardian Nezha, si dhe dy anëtarët të trupit gjyqës Ardit Mustafaraj dhe

Idriz Mulkurti. Me anë të këtyre dëshmiave Dajti pretendonte që të rrëzohej akuzat e ngritur ndaj tij nga gjyqtari Gurali Brahimllari. Ardit Mustafaraj, gjyqtari të cilin Dajti e kërkonte si dëshmitar, u kërcënua me anë të një letre me datë 9 shtator. Në këtë letër, bënin me dije burime të besueshme, gjyqtari paralajmërohej të kishte kujdes dhe të mos bëhej palë me atë çfarë kanë bërë të tjerët dhe të japë dorëheqjen nga gjykimi. Vepra për të cilën akuzohet Dritan

### Padia

## Kërcënimet e Dritan Dajtit ndaj gjyqtarëve

Në seancën gjyqësore të datës 2 prill i pandehuri Dajti konfliktohet me relatoren e çështjes Nertina Kosova duke lëshuar fraza ofenduese dhe kërcënuese ndaj togave të zeza. "E dini çfarë ju bëj? Kush kujtoni se jeni ju mo? Ju q... robt! Mos më rruani k... mua", fjalët e Dritan Dajtit në sallën e gjyqit. Ndërsa ka vijuar të ofendojë me fjalë banale edhe gjyqtarin Gurali Brahimllari. Në fund të seancës i pandehuri Dajti ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarës Nertina Kosova, kërkesë e aprovuar me datë 5 qershor nga gjykata. Për të vijuar më pas me përjashtimin e gjyqtarit Gurali Brahimllari nga procesi gjyqësorë. Me anë të kësaj strategjie i pandehuri arriti që të përjashtonte nga gjykimi dy prej gjyqtarëve, dhe kjo pas një morie kërkesash të bëra me motive të ndryshme.

Dajti është konsumuar prej tij në një nga sallat e Gjykatës për Krime të Rënda, në seancën e datës 2 prill 2012, të procesit të tij gjyqësor. Në këtë seancë, pas një konfliktimi me kryesuesen e trupës, gjyqtarën Nertina Kosova, Dajti lëshoi kërcënime dhe fraza fyese ndaj trupës gjyqësore. Për shkak të këtij episodi, më 5 qershor Gjykata pranoi kërkesën e Dajtit për

përjashtimin e kryesueses Kosova. Ndërsa më 26 qershor, Gjykata pranoi kërkesën e Prokurorisë për përjashtimin e gjyqtarit Gurali Brahimllari. Në anën tjetër, gjykimi ndaj Dritan Dajtit në Gjykatën për Krimet e Rënda nuk është zhvilluar normalisht prej disa seancash. Shkaku kryesor i zvarritjes është mosparaqitja e mbrojtjesve në gjykim.

### 21 Janari

# Vrasja e Hekuran Dedës urdhërohet të dëshmojë vëllai

TIRANE

Gjykata urdhëron shoqërimin e GZabit Dedes për të dëshmuar në procesin e 21 Janarit. Vendimi është marrë nga togat e zeza pas refuzimit të vëllait të protestuesit të vrarë Hekuran Deda, për tu paraqitur në gjyq. Ndërsa është kërkuar rinjofiti mi për dy deputetët e Partisë Socialiste Pjerin Ndreu dhe Tom Doshi. Dëshmitarët e radhës në seancën e djeshme gjyqësore kanë qenë Asim Rruçi dhe Andi Rruçi. Para togave të zeza Andi Rruçi ka pohuar hapjen



e zjarrit pa marrë urdhër nga Garda. "Nuk kam marrë urdhër për të hapur zjarr, por kam qëlluar duke zbatuar ligjin për Gardën e Republikës. Kam qëlluar disa herë në ajër për të larguar turmën. Rreth katër herë është shkelur vija e zjarrit nga protestuesit dhe unë tre herë kam hapur zjarr", është shprehur Andi Rruçi. Dëshmitari ka refuzuar që të ketë marrë urdhër për ndalim zjarri. Por pas reagimit të prokurorit të çështjes, dëshmitari i është përgjigjur: Komandanti Qani Kasa ka dhënë urdhër për ndërprerje zjarri".

### Lushnje

# Dhunohej për vdekje ish-oficeri i policisë

TIRANE

Një ish-efektiv i Policisë së Lushnjes është rrahur për vdekje ditën e djeshme. Mësohet se Arben Sopjani 45-vjeç, është dhunuar jashtë sallës së gjyqit. Burime të policisë bëjnë me dije se 45-vjeçari ka dalë nga gjyqi dhe ka nisur të debatojë me palën tjetër, me të cilën ishte në konflikt gjyqësor. Debat, i cili ka qenë për një çështje të vjetër, ka degjeneruar në konfrontime fizike dhe Sopjani ka marrë plagë të rënda, të cilave nuk ka



mundur ti mbijetojë. Sipas policisë, autorët e kësaj ngjarje janë Fatbardhë dhe Alush Rustemi. Dy autorët e ngjarjes janë arrestuar nga ana e policisë. Siç bëhet me dije nga uniformat blu konflikti mes dy familjeve Rustani dhe Sopjani e ka zanafillën që në vitin 1999, ku pas një konflikti ka mbetur i paralizuar një pjesëtar i familjes Rustani. Debatet mendohet se kanë nisur vite më parë ndërmjet këtyre dy fiseve për shkak të problemeve të pronësisë së një lirie përpunimi të ndereteve në luginë Shkumbin.



## Ligj i ri për paraplegjikët shoqata kundër

Presidenti i Shoqatës së të Verbërve reagon për mospërfshirjen e grupeve të interesit, në hartimin e projektligjit Integral për Aftësinë e Kufizuar, pasi sipas Sinan Tafajt, Shoqata është njoftuar vetëm një ditë më parë, ku i kërkohet të marrin pjesë në konsultime, por pa u konsultuar me anëtarësinë e tyre. Sipas Tafajt i parë në vija të përgjithshme, ky projektligj nuk njihet me si

pale Shoqatat Kombetare te Personave me Aftesi te Kufizuara, por disa fondacione te ngritura nga njerez, qe nuk kane lidhje me aftesine e kufizuar dhe qe perfitojne në emër të kësaj shtrese. Sipas Tafajt në kete projektligj nuk jane percaktuar perfitimet financiare te kesaj kategorije, por cenohet e ardhmja e te drejtave te fituara deri me tani. "Nuk percakton detyrimin se cili do të jete

niveli i këtij financimi, por sipas mundësive. Projektligji flet për diskriminim, pra nuk mund të kërkohet përshtatje nëse përbën barrë të tepruar. Pra projektligji është më shumë një përrallë ëndrrash, por në thelb mendojme se nuk ka mekanizmat e garantimit për t'u aplikuar dhe që në vetvete përbën një kërcënim për të drejtat tona në të ardhmen", u shpreh Tafaj.

100-vjetori i Pavarësisë, qeveria shpall super-amnisti për 2546 të burgosur

# Amnistia, të dënuarit që përfitojnë

Përfituesit 290 persona në burgje, 928 të rritur e 452 të mitur në Shërbim Prove dhe 876 persona, me vepra penale, që parashikon një dënim me burgim deri në dy vjet ose të lehtë

## Lajmi

Qeveria miratoi dje, projektligjin "Për dhënie amnistie", në kuadrin e 100 vjetorit të pavarësisë, për të gjithë personat e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për vepra penale me rrezikshmëri shoqërore të ulët apo për kategori të caktuara të personave të dënuar.

■ ■ ■ TIRANE

Mijëra persona që gjenden në burg apo që janë në proces hetimi, pritet që të përfitojnë nga një super-amnisti e shpallur gjatë mbledhjes së djeshme të qeverisë nga ana e kryeministrit Berisha. Sipas këtij të fundit, kjo amnisti e gjerë vjen me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë. "Këshilli i Ministrave miratoi dje, projektligjin "Për dhënie amnistie". Kryeministri Berisha tha se amnistia merret në kuadrin e 100 vjetorit të pavarësisë. Qëllimi i projektligjit është dhënia e amnistisë, të gjithë personave të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për vepra penale me rrezikshmëri shoqërore të ulët apo për kategori të caktuara të personave të dënuar. Projektligji "Për dhënie amnistie" është iniciativë e Ministrisë së Drejtësisë. Nga aplikimi i amnistisë përfitojnë rreth: 290 persona që gjenden në sistemin e burgjeve; 928 të rritur dhe 452 të mitur që ndodhen nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës dhe janë me masa alternative; 876 persona, të cilët deri në datë 31.08.2012 kanë qenë në hetim për veprat penale, për të cilat Kodi Penal parashikon një dënim me burgim deri në dy vjet ose çdo lloj dënimi tjetër të lehtë. Përzgjedhja e kategorisë së personave që përfitojnë amnisti është bërë duke u bazuar në këto kritere: Lloji dhe masa e dënimit - deri në dy vjet; Koha e mbetur e dënimit - deri në 1 vit; Moshë aktuale e personit të dënuar - 55 vjeç për gratë dhe 60 vjeç për burrat; Moshë e personit të dënuar në kohën e kryerjes së veprës penale - nën 18 vjeç. Të gjitha këto kritere, tha Kryeministri, kanë një emërues të përbashkët që është rrezikshmëria e ulët e personit apo veprës penale. Dhënia e amnistisë bazuar në këto kritere garanton mbrojtjen e interesit publik dhe nuk vë në rrezik sigurinë dhe rendin publik", thuhet në një njoftim të Kryeministrit.



## Kriteret

Përzgjedhja e kategorisë së personave që përfitojnë amnisti është bërë duke u bazuar në këto kritere: Lloji dhe masa e dënimit - deri në dy vjet; Koha e mbetur e dënimit - deri në 1 vit; Moshë aktuale e personit të dënuar - 55 vjeç për gratë dhe 60 vjeç për burrat; Moshë e personit të dënuar në kohën e kryerjes së veprës penale - nën 18 vjeç.

28 nëntor 2012 janë baraz ose mbi moshën 55 vjeç, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji; dh) Të dënuarit meshkuj, që në datën 28 nëntor 2012 janë baraz ose mbi moshën 60 vjeç, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji.

e) Të dënuarit me burgim, të cilët, në kohën e kryerjes së veprës penale, kanë qenë baraz ose nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të atyre që janë dënuar për vepra penale, të parashikuara në nenin 77, 78, 79 e 101, të Kodit Penal.

3. Të gjithë të dënuarve që nuk plotësojnë kriteret për të përfituar amnisti, sipas pikës 1, të këtij neni, u zbritet ¼ e dënimit të mbetur, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji. Në rastin e personave të dënuar për shkak të përsëritjes së të njëjtës veprë penale, nuk do të aplikohet zbritja sipas këtij paragrafi.

**NENI 4**  
Kriteri ndalues për përfitimin e amnistisë

Nuk përfitojnë nga kjo amnisti personat e dënuar për:

a) krime kundër njerëzimit, të

**Pushohen ndjekjet penale për çështjet në hetim, për çështjet e pashqyrtuara nga gjykatat dhe për kallëzimet, që ndodhen në këto organe dhe në organet e rendit publik**

parashikuara në nenin 73, 74 e 75, të Kodit Penal;

b) krime kundër jetës, të kryera me dashje, të parashikuara në nenin 76, 77, 78 dhe 79, të Kodit Penal, dhe vrasje të mbetur në tentativë, si dhe neni 77 i Kodit Penal Ushtarak;

## PROPOZIMI I PLOTE NENI 1

Qëllimi dhe parimet e ligjit

1. Qëllimi i këtij ligji është të përjashtojë nga ndjekja penale, nga vuajtja tërësisht ose pjesërisht e dënimit ose të bëjë zëvendësimin e dënimit me një lloj dënimi më të butë për të gjithë personat që plotësojnë kriteret sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Dhënia e amnistisë udhëhiqet nga parimet e humanizmit, arritjes së qëllimit të dënimit, rrezikshmërisë

**Nuk përfitojnë nga amnistia personat e dënuar për krime kundër njerëzimit, krime kundër jetës dhe vrasje të mbetur në tentativë, krime seksuale, etj**

së ulët të personave që amnistohen, si dhe mbrojtjes së interesit publik.

## NENI 2

I dënuar

I dënuar, në kuptim të këtij ligji, konsiderohet personi i dënuar nga

gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe që nuk i është shmagur ekzekutimi të dënimit të dhënë.

## NENI 3

Kriteret për përfitimin e amnistisë

2. Plotësojnë kriteret për të përfituar amnisti, sipas këtij ligji:

a) Personat e dënuar me burgim deri në 2 vjet, pavarësisht kohës së mbetur nga dënimi, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji;

b) Personat e dënuar ndaj të cilëve aplikohet një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji;

c) Personat e dënuar me gjobë, për pjesën e pashlyer të saj, pavarësisht masës së gjobës, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji;

d) Personat e dënuar me burgim, të cilëve, në datën 28 nëntor 2012, u ka mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në 1 vit, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji;

e) Të dënuarat femra, që në datën

c) vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, të parashikuara në nenin 86, 87 dhe 89/a, të Kodit Penal;

d) krime seksuale, të parashikuara në nenin 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 106 dhe 108, të Kodit Penal;

e) vepra penale kundër lirisë së personit, të parashikuara në nenin 109, paragrafi i dytë dhe i tretë, 109/b, 110, 110/a dhe 111, të Kodit Penal;

f) vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, të parashikuara në nenin 114, 114/a, 114/b, të Kodit Penal;

g) vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, të parashikuara në nenin 128/a dhe 128/b, të Kodit Penal;

h) vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, të parashikuara në nenin 135, 136, 138, 138/a, 139, 140, 141, 141/a, 143/a, në paragrafin e tretë, të nenit 152, të Kodit Penal dhe në paragrafin e dytë e të tretë, të nenit 59, të Kodit Penal Ushtarak;

i) krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues, të parashikuara në nenin 208, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 223, 224 e 225, të Kodit Penal;

j) krime, që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera, të parashikuara në nenin 226 e 228, të Kodit Penal;

k) vepra me qëllime terroriste, të parashikuara në nenin 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/d, 231, 232, 233, 234, 234/a e 234/b, të Kodit Penal;

l) krime kundër autoritetit të shtetit, të parashikuara në nenin 244, 245, 245/1, 248, 259, 259/a, 260, 270, paragrafin e i parë dhe të katërt, të nenit 278, 278/a, 279, 282/a, 283, 283/a, 283/b, 284, 284/a, 284/c, 284/d, 286, 287, 287/a, 288, 290 e 298, të Kodit Penal;

m) vepra penale kundër drejtësisë, të parashikuara në nenin 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/d, 319/dh e 319/e, të Kodit Penal;

n) vepra penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale, të parashikuara në nenin 333, 333/a dhe 334, të Kodit Penal.

## NENI 5

Pushimi i ndjekjes penale

Pushohen ndjekjet penale për çështjet në hetim, për çështjet e pashqyrtuara nga gjykatat dhe për kallëzimet, që ndodhen në këto organe dhe në organet e rendit publik, për veprat penale të kryera deri në datën 31 gusht 2012, për të cilat Kodi Penal parashikon dënim me burgim deri në 2 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të lehtë.



# Dokumentari

**"DUAM DRITË"** u shfaq dje në Akademinë e Filmit Marubi. Regjisori francez Vincent Hazard rrëfen sesi mediati e Francës dhe Europës krijojnë imazhin e keq për Shqipërinë dhe arsyet e një filmi për shqiptarët

TIRANE

DHURATA HAMZAI

## Shqipëria dhe shqiptarët në sytë e një regjisor francez

Vincent Hazard: Ju tregoj për xhirimet me babanë e Martaneshit

Regjisori francez Vincent Hazard kur e preku tokën shqiptare për herë të parë nuk dinte asgjë tjetër, përveç faktit se Shqipëria është një vend i vogël që ka jetuar 50 vjet nën diktaturë. Nuk dinte asgjë për historinë e këtij populli, për jetesën e tyre, për vlerat. Kontakti i parë ndodhi 9 vjet më parë, kur u përzgjodh si pjesëmarrës në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit të Shkurtër, TIFF 2003, në Tiranë. Para se të vinte në Shqipëri kishte dëgjuar nga lajmet mediatike "ca gjëra" për të cilat tregon se i dukeshin "shumë të çuditshme dhe monstruoze për të kuptuar qartë profilin e një populli". Lajmet për shqiptarët në Francë, apo Europë sikur ishin të përzgjedhura enkas për të krijuar një imazh të keq. Vincens Hazard rrëfen se dëgjonte shpesh lajme që kishin lidhje ose me mafian, me kanunin, për vrasjet e gjëra të tjera që s'merre dot me mend. Gjatë ditëve të festivalit ai takohet me shumë shqiptarë dhe ndesh një realitet tjetër shumë miqësor. Kështu i lindi ideja e filmit, që na e rrëfen në intervistën për "Shqiptarja.com". Në rrëfimin e tij zbulohet edhe historia e panjohur e një emigrantit shqiptar që në periudhën e tranzicionit postkomunist kthehet në atdhe për t'u bërë baba i teqesë në Martanesh. Ky është baba Hysni Shehu, njëri nga personazhet kryesorë të dokumentarit.



Në foto: (Lart) Regjisori francez Vincent Hazard (majtas) Vincent Hazard me protagonistët e filmit dhe baba Hysni Shehun



tanesh. I filmova ata për pak kohë atje në Martanesh, dhe pas dy vjetësh u takuan sërish. Bëmë një diskutim bashkë për të treguar jetën e njerëzve në Shqipëri, më Shqipërinë moderne.

**Pse ju jeni kaq shumë të interesuar për problemet e Shqipërisë dhe jetën shqiptarëve?**

-Në fakt unë e kam zbuluar Shqipërinë në 2003-in, sepse pata një film të shkurtër që u seleksionua në TIFF. Dhe nuk dija asgjë për Shqipërinë, por një nga miqtë e mi e njihje. Dhe i thashë që do të shkojë dhe kaq ishte. Pastaj gjeta shumë njerëz të këndshëm në Shqipëri dhe një shoqëri shumë interesante. Mënyra sesi janë njerëzit këtu më

duket shumë interesante dhe mendova dhe kjo është diçka me të cilën nuk jemi mësuar në Francë dhe mendova që aty ka shumë material për t'u treguar njerëzve Shqipërinë dhe për të bërë film. Kështu që vendosa të vij prapë për të treguar anët e mira dhe anët e këqija të shoqërisë shqiptare, nëpërmjet jetës së dy njerëzve. Pra po u tregoj dy njerëz të mirë, të cilët po arrijnë të bëjnë gjëra të rëndësishme, gjëra të cilat nuk mund t'i arrijnë dot të gjithë. Pra mendova të bëjë një dokumentar për njerëzit e Shqipërisë. Ne po i ndjekim ata, për t'u treguar njerëzve në Francë, ose në Europë realitetin e jetës shqiptare. Sot me ndryshimet e mëdha, me prurjet e laptovëve dhe të celularëve në Ti-

ranë dhe në shtëpinë e babait bektashi në fshat gjërat kanë ndryshuar.

**Për Shqipërinë dhe shqiptarët është krijuar një imazh i keq në Europë e në Botë, cili është opinioni juaj?**

-Kjo është interesante, sepse kjo është pikërisht një nga gjërat kryesore që doja të tregoja. Shumë herë kur flasim për Shqipërinë, flasim për gjërat e këqija që ndodhin. Gjëra për mafien ose kanunin ose gjëra të çuditshme si këto, por kur ka ndodhur, në cilat kushte, e se çfarë janë këta njerëz nuk ka asnjë koment. Kur njerëzit nga Franca ose Europa vinë këtu shohin një imazh komplet ndryshe të vendit. Duhet të them që

ka probleme, por ka dhe gjëra të mira që ndodhin. Gjëra që mund të frymëzojnë njerëzit në Francë ose në vende të tjera të Europës. Kjo është ajo për të cilën unë flas në film, gjithashtu interesant është edhe aspekti fetar. Për shembull, në aspektin fetar në Francë dhe në botën arabe ka shumë tensione. Ndërmjet feve, ajo e veçantë çfarë gjë këtu është se janë njerëz që jetojnë me fenë e tyre në paqe. Për mua kjo është shumë frymëzuese sepse tregon për cilësitë e një populli, ku njerëzit janë të gjithë shqiptarë dhe qofshin myslimanë, ortodoks, të krishterë nuk ka rëndësi. Ata jetojnë me fenë e tyre dhe askush nuk përpiqet t'i vrasë pse kanë një fe tjetër. Dhe e mendoj se është shumë e rëndësishme të tregohet se është mundur të bëhet kjo.

**A dini ju shumë për të kaluarin, për diktaturën, për Enver Hoxhën?**

-Po, po sigurisht. Kur mbërrita e dija që kishit pasur një regjim shumë të egër komunist. Por edhe bëra shumë kërkime, sepse filmi është për realitetin e vendit sot. Por është shumë influencuese ajo çfarë ka ndodhur në periudhën komuniste. Çdo gjë që sheh në film për shembull ndihet influenca. Tregojmë bunkerët, dhe bunkerët janë shembur me shpërthime të mëdha. E shohim këtë në fshatra, e shohim të njerëzit duke shkatërruar bunkerët. Duke shkatërruar bunkerët dhe duke marrë atyre metalin, në film del se njerëzit e dinë që këto bunkerë i ka ndërtuar Enver Hoxha, por nuk e dinë pse. Dhe kuptojnë që diktatori i tyre ishte pak i çmendur. E kaluara ndikon në jetën e njerëzve sot. Dhe situata është kjo, që ka një trashëgimi të viteve të komunizmit ndër shumë gjëra këtu. Gjëra që bëhen se mbeten zakona nga koha komuniste dhe gjëra që bëjnë njerëzit tani në reaktion komplet të kundërt kundër komunizmit. Është diçka interesante për t'u treguar, sepse ne në Francë ne nuk kemi pasur diktaturë për një kohë të gjatë dhe e di që është traumë për një vend të jetojnë në diktaturë. Spanja e di këtë, sepse kanë pasur diktaturë dhe dihet se kurrë e heq diktaturën, njerëzit kanë nevojë për shumë kohë që të rehabilitohen.

**Po për rolin e politikës aktuale sot dini donjë gjë?**

-Di, por unë nuk përfishim në politikë, sepse nuk di shumë si gjëra funksionojnë në përgjithësi. Mendoj se problemi juaj sot është që të kenë qeveririnë e duhur. Nuk është e lehtë. Unë nuk i gjykoj njerëzit, ose politikanët. Nuk është puna ime që të ndërhyjë, sepse unë nuk jam qytetar shqiptar. Unë mund të them për gjërat që janë mirë ose keq dhe nuk mund të gjykojë gjë tjetër, veçse artin shqiptar.

### Parashikimet

## Mediat suedeze, sot shpallet Çmimi Nobel për Letërsi

Sipas gazetave prestigjioze, siç është edhe Dagen Nyheter, një nga më të njohurat në Suedi, Çmimi "Nobel" për Letërsinë, ku është kandidat edhe shkrimtari shqiptar Ismail Kadare, pritet të ndahet sot më 11 tetor. Edhe sipas gazetës suedeze Dagen Nyheter një ndër emrat e spikatur si kandidatë është edhe shkrimtari i shqiptar Ismail Kadare, por më pak i lakuar si fitues. Komisioni për ndarjen e çmimit Nobel për literaturë akoma nuk njofton me detaje se kush do të jetë Nobelisti i sivjetshëm për krijimtari dhe literaturë. E gjithë kjo mbahet në fshehtësi nga komisioni,



Ismail Kadare

por sipas mediave suedeze shpallja përfundimtare do të bëhet nesër nga ky komision në një ceremoni speciale. Gazeta suedeze Dagen Nyheter si kandidatë të mundshëm parashikon emrat e shkrimtarit japonez Haruki Muakam, Mu Jan nga Kina, Daç nga Holanda, Ngugi Thoingo nga Kenia, dhe Adonis nga Siria. Këto janë informatat e para që i jep kjo gazetë dhe nuk hyn në detaje tjera. INA, Maqedoni, komenton se "komisioni i mban shumë sekrete këto informatat", ndërsa shkruan se "shpallja e fituesit do të bëhet zyrtarisht në 13.00 sipas orës europiane"

## 100-vjetori

**PASKALI**, ky mjeshtër i skulpturës, i pari pas një heshtjeje të madhe shekullore nuk duhet të denatyrohet për së dyti. Ai duhet ruajtur nga brezat për çdo gjë që ka bërë, siç i ka bërë dhe ku ka rënë dakord t'i vendos skulpturat e veta



ILMI KASËMI

TIRANË

Një skulpturë e bukur nuk është e thënë se çliron vlerat që bart në vetvete në çdo ambient ose siç rëndon thuhet- rri bukur kudo. U dëshën 25 burra që të jepnin mend se ku do të vendosej Davidi i Mikelanxhelos dhe njëri prej tyre që Leonardo da Vinci. Asokohe Mikelanxhelo që gjallë dhe pavarësisht nga mendimet e dhëna ai vendosi vet për veprën e tij. Davidi nuk u bë as me konkurs, as me një vend të paracaktuar, nuk u bë as me porosi dhe as me detyrim. Ai u konceptua, ideua e realizua duke parë mermerin e lënë nga dikush tjetër, për të bërë një gjë tjetër nga ajo që artisti i madh modelojë. Kjo ka ndodhur 500 vjet më parë.

Ç'na mëson kjo histori? Shumë, pasi veprimtari të tilla nuk duhet të konceptohen mbi parime ekzekucionari apo vendimmarrje, siç thuhet rëndom dhe siç rëndom operohet në fushën e politikës, e cila delegon problematikën tek institucionet dhe njerëzit që ajo ka për zemër në mënyrë që kështu të bëjë detyrën si me historinë ashtu edhe me financat brenda mandatit. Fusha e artit ka një infrastrukturë të vetën, të ndryshme nga ajo e rrugëve. Infrastruktura e asfaltit nuk është si ajo e bronzit. Bronzi është derdhur lumë edhe kur nuk ka pasur rrugë.

Unë mendoj se pas 500 vjetësh, për precizion, duhet të kuptojmë sa vijon: Davidi nuk është Dauti se kështu e dimë ne nga institucionet tona.

Da Vinci nuk është drejtor i GdU-së (Galleria degli Uffizi) që duhet të merret ene me konkursin e monumenteve të Firences.

Mikelanxhelo nuk është Paskali, që për fatin e keq të tij (dhe tomin), gjysma e jetës krijuese e biologjike i shkoi duke u përballur në heshtje me supermenët e rinj, dekan e jo dekan të soc-realizmit dhe të soc-tranzicionit.

Konkursin nuk janë konkursarët se kështu e dimë ne nga institucionet tona, të cilat mesa duket janë po ato që diktonin në vitin 81 të shekullit të kaluar kur është modeluar statuja e I. Qemalit, ideuar, konceptuar e destinuar për një ambient të caktuar, me distanca të caktuara dhe me sfond të modeluar dydimensionalisht në funksion të figurës në bronzi.

Vendi nuk është të kuvendi ashtu sikundër triptiku në beton me pushkë, kazma, lopata, pemë, drapërinj, llulla, llapa, krah shqiponje e yll në Selinë e kryeministrit. Këto do të ketë përballë Skënderbeu i dytë shqiptar?! Natyrisht syri në bronzi nuk sheh pasi jemi ne që e shohim këtë sy, është psikika e syrit tonë, e të gjallëve, që vepron ndaj të ngjashmërit në bronzi. Këtë na e ka mësuar Aristoteli shumë kohë më parë.

Natyrisht Paskali nuk është gjallë dhe s'ka se si të na thotë gjë, por në



Në foto: Shtatorja e Ismail Qemalit nga Odise Paskali dhe perojktet i vendit ku do të vendoset

## Të dalë ku të dalë se kemi Paskal

Problemi i ngritjes së shtatores së Ismail Qemalit në Tiranë

kondicione imagjinare mund të thuhet se do ta kundërshtonte minimalisht vendosjen në një kënd udhëkryqi pasi supozoj se nuk do ta donte skulpturën e tij të vendosur si roje blloku me bllok në dorë. Mund ta ribente më elegant, në mënyrë që të

**Tamam pas 99 vjetësh Shqipëria ka më shumë se 99 skulptorë, jo 99 gurskalitës si ata të epokës së tamamit**

krijonte jo vetëm figurën historike, fotografike, biologjike apo fizike, por atë artistike, simbolike, metafizike domethënë përtej të dukshmes, ashtu siç ka vepruar edhe me Skënderbeun kur ka qenë i lirë para luftës së dytë botërore dhe luftës së parë sh-

qiptare. Natyrisht që ne kemi një statujë tashmë të kryer ashtu sic edhe e kërkonte një sallë muzeu e për më tepër plazmuar në epokën e metodës dogmatike të kohës. Edhe kjo skulpturë nuk i ka shpëtuar së ashtuqajturës eufori heroistike apo patetizmit dhe librave nëpër duar, situata apo simbolika që organizatorët e konkursit apo kadilerët e tranzicionit i patën kontestuar pasi i panë me bollëk në projektet e parqitura të bëra enkas për monumentin. Këto abuzivizma terminologjike kanë jetë vetëm 24 orë, sepse të marrim për shembull patetizmin apo librin ato i gjejmë tek Moisiu, Sibilat, statuja poetësh e shtetarësh e profet të tjerë në skulptura e piktura.

Ka ardhur koha që për vepra të mëdha, histori të mëdha e personalitete të mëdha mos të veprohet me teorinë e pragmatizmit postmodern

duke krijuar kriza artificiale në konform me situatën reale të mjeshtërvës shqiptarë të skulpturës. Shqipëria ka para dhe skulptorë, po jo nga ata një shqiptar e gjysmë apo një gjerman e gjysmë, të propaganduar me zell në media si me qenë tamam në vitin 1912, në kohën kur kjo fjalë thuhej tamam për gjendjen e asaj kohe. Tamam pas 99 vjetësh Shqipëria ka më shumë se 99 skulptorë, jo 99 gurskalitës si ata të epokës së tamamit. Fatkeqësisht këta të 99 të shtetit apo 100-vjetorit të pavarësisë kombëtare detyrohen që për bukën e gojës të pranojnë ofeza nga nomenklatura e institucionalistëve anadollak të shkolluar në Oksident, e kështu të pranojnë e mbyllin gojë duke skulptur oxhaqe për vilat që po i bëjnë tamam si në epokën e cilfligjeve, natyrisht me një ndryshim nga cifligarët e tokave, këta regjim-sa janë bërë pronarë njerëzish dhe

### Problemi

Shqipëria ka 99 skulptorë. Pse nuk u realizua shtatorja origjinale për Ismail Qemalin. Skulptorët janë kthyer në oxhakbërës të vilave. Konkluzioni i I.Kasëmit: një oxhak i qeveritarëve paguhet më tepër se shtatorët e personaliteteve

veprash me trajta njerëzish. Kostoja e një oxhaku për kulturë që realizohet në vilën e një supermen-biznesmeni ndoshta ja kalon edhe një statujë në bronzi dhe ne presim që personalitetet e oxhaqeve dhe dyerve të mëdha të kombit të realizohen nga këta oxhakllarë të rinj të cilëve nuk u lejohej as oxhak me bait, kashtë e bajga në tokën e shqiptarëve. Kotë e kemi që polemizojmë me erën. Sot më 2012 jemi si më 1981 duke folur për një veprë që është kryer në një kohë dhe një metode artistike të refuzuar tashmë. Të paktën kadilerët të mos na bëjnë karshillëk me metodën e demagogjisë e të na dalin në televizor si pedagogët e hipokrizisë. Sa i përket Paskalit më duhet të them se ky mjeshtër i skulpturës, i pari pas një heshtje të madhe shekullore nuk duhet të denatyrohet për së dyti. Ai duhet ruajtur nga brezat për çdo gjë që ka bërë, siç i ka bërë dhe ku ka rënë dakord t'i vendos skulpturat e veta. Ky nuk është historizim, por respekt për historinë e vendit, veprës së artit dhe autorit. Në qoftë se do të qe vepruar me metoda të tilla"- të dalë ku të dalë se kemi Paskal -"veprat e artit do të lëviznin nga vendet e origjinës sipas fushatave elektorale apo edhe tekave e qejfeve individuale të politikanëve, edhe për Davidin do bëhej nami që me vendim të posaçëm të një komisioni, ai më mirë do të qe prapa galerisë Uffizi kandidat për gëlqere.

Davidi për ta ruajtur e futën brenda dhe atje ku qe jashtë në shi bënë një kopje tjetër pasi Fiorentinët nuk bëjnë dot pa të.

Si përfundim Ismail Qemalit duhet t'i bëhet monumenti në Tiranë, e jo sa për të kaluar radhën të gërmohet se mos gjendet ndonjë efigjë (portret me ngjashmëri fizike).


(Shënim-red: Autori i shkrimit është një ndër skulptorët më të talentuar në Shqipëri)

### Aktori shqiptar

## Praq Rado arrestohet gjatë shfaqjes së filmit në SHBA

TIRANË

31 vjeçari Praq Rado, një aktor shqiptar i cili kishte më shumë se 11 vjet që jetonte në mënyrë ilegale në Amerikë, u arrestua nga agjentët federalë të emigracionit gjatë kohës që po shkante në premierën e filmit mbi jetën e tij si emigrant në Amerikë, në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Hamp-ton. Filmi në fjalë mban titullin "Dreaming American" dhe është një film me metrazh të shkurtër bazuar në jetën e Rado-s. Aktori shqiptar duhet të mbante një fjalim gjatë shfaqjes së filmit, por kjo nuk u bë e mundur pasi ai u



Praq Rado

ndalua. Rado është në rolin e aktorit kryesor në filmin, i cili zgjat 24 minuta, ku flitet për historinë e tij të emigrimit, përfshirë mënyrën sesi arriti të arratisej nga Shqipëria pa letra. Në Amerikë, Rado u përpoq të mbijetonte dhe të gjente punë pa numër sigurancioni social, duke bërë punë të ndryshme si kërcimtar nëpër klube homoseksuale. Ai përfundoi duke u bërë një model mjaft i suksesshëm si dhe nisi të merrej me aktrim. Gjatë kohës që Rado punonte si furnizues ushqimesh ai u njoh me fituesin e çmimit Award Lee Percy i cili ishte skenaristi dhe regjisori i filmit "Dreaming American". Sipas agjentëve

të emigracionit, rezultoi se Rado ka kaluar kufirin Amerikan në vitin 2001 në Detroit, dhe vetëm në 2007-n oficerët morën urdhrin për ta dëbuar. Rado ka punuar në Los Angeles por jetonte në New York dhe nuk është larguar asnjëherë nga qyteti që prej kohës kur kishte ardhur, madje as kur të dy prindërit e tij vdiqën të dy në Shqipëri. Pas përfundimit të procedurave në zyrat e mbrojtjes së kufirit në Buffalo, Rado do të dërgohet në një qendër federale, për t'u marrë në pyetje dhe për të pritur vendimin për t'u rikthyer në vendlindje. Nga ana tjetër avokatët e tij po luftojnë për të ndaluar këtë kthim.

LAJME  
NGA BOTA

BE kundërshton  
dënimin me vdekje

Bashkimi Evropian kundërshton dënimin me vdekje në të gjitha rastet dhe në të gjitha rrethanat e mundshme, është kumtuar nga Komisioni Evropian me rastin e 10 tetorit, Ditës Botërore kundër Dënimit me Vdekje. "Dënimin me vdekje është i vrazhde, johuman dhe akt i padiskutueshëm me të cilin shkelet e drejta e njeriut për jetë dhe dinjitet. Në rast të lëshimit të drejtësisë, ndaj të cilave asnjë sistem ligjor s'është imun, ajo paraqet humbje të tmerrshme dhe të pakthyeshme të jetës", ka thënë në mënyrë një njoftimi përfaqësuesja e lartë e BE-së, Catherine Ashton.

SHBA-ja kritikon  
Armeninë

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Armeni, John Heffernan ka thënë se akuzat penale të ngritura kundër ministrit të Jashtëm armen, Vartan Oskanian "janë të këqija për drejtësinë dhe demokracinë në Armeni". Oskanian është thirrur nga Shërbimi për Siguri Kombëtare më 8 tetor dhe është akuzuar formalisht për shpërdorim e rreth 1.4 milionë dollarëve.

Panetta kërkon ekipe shtesë  
nga NATO-ja për Afganistanin

Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Leon Panetta u ka bërë thirrje aleatëve të NATO-s që të ndihmojnë për të plotësuar mungesën e ekipave ndihmëse të sigurisë në Afganistan. Panetta i ka bërë këto komente në takimin e ministrave të mbrojtjes së vendeve anëtare të NATO-s në Bruksel.

Iraku kundër ndërhyrjes  
së NATO-s në Siri

Kryeministri i Irakut, Nuri al-Maliki i ka bërë thirrje NATO-s të mos ndërhyjë në konfliktin sirian, nën pretekstin e mbrojtjes së Turqisë. Al-Maliki ka thënë se raportet e Turqisë për sulme vdekjeprurëse nga Siria "janë të ekzagjeruara" dhe ka akuzuar Ankarën se po bën përpjekje të fusë NATO-n në Siri.

Nobelin për Kimi  
e merr dyshja amerikane

Çmimi Nobel për Kimi këtë vit ka shkuar për dy hulumtuesit amerikanë, Robert Lefkowitz dhe Brian Kobilka. Të dy ata kanë studiuar proteinat që u mundësojnë qelizave të trupit t'u përgjigjen sinjaleve nga jashtë. Dje, shkencëtarët francezë dhe amerikanë, Serge Haroche dhe David Wineland, janë nderuar me Çmimin Nobel për Fizikë për punën e tyre në optikën kuantike.

Lirohet njëra  
anëtare e "Pussy Riot"-it

Gjykata e Apelit në Moskë ka liruar me kusht njëra anëtare të grupit "Pussy Riot", ndërsa ka urdhëruar qëndrimin në burg për dy anëtarët e tjerë të grupit. Gjykata ka lëshuar lirimin me kusht për Yekaterina Samulosevichin. Tri vajzat janë dënuar për huliganizëm, "të motivuar nga urrejtja fetare", pas një performance në një katedrale të Moskës kundër presidentit Vladimir Putin.

Franca arreston  
12 terroristë të dyshuar

Autoritetet franceze thonë se kanë gjetur materiale për krijimin e bombave dhe dy armë gjatë hetimit të disa të dyshuarve islamikë. Prokurori i Parisit, Francois Molins, tha se policia ka gjetur materialet që përfshijnë nitrat kaliumi, sulfur dhe drita të kuqe në një zonë parkimi në periferi të kryeqytetit dhe ka arrestuar 12 të dyshuar për terrorizëm, transmeton REL.

Toyota tërheq  
mbi 7 milionë automjete

Toyota ka paralajmëruar se do t'i tërheqë 7 milionë e 430 mijë automjete në gjithë botën, për të rregulluar një defekt në butonin e dritareve. Prodhuesi gjigant i automjeteve japoneze njoftoi se më shumë se 12 modele të automjeteve të Toyotas, disa të prodhuara edhe ndërmjet viteve 2005 e 2010, do të tërhiqen. Ky vendim më së shumti ka ndikim në automjetet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kinë dhe Evropë.

DIGITALB

TOKESORE  
KANALI 48

Do na ndiqni në  
gjithë Shqipërinë

VALË UHF

NË PREFEKTURAT:  
TIRANE - DURRES - LEZHE - FIER

DIGITALB

SATELITOR  
KANALI 51

Do na ndiqni në gjithë Shqipërinë,  
Maqedoni, Kosovë, Itali, Greqi  
dhe në pjesën tjetër të Europës

ABCOM

KANALI 158

Çdo ditë në

A1 REPORT!

Origjina e Lajmit



Rubrika e intervista të ndryshme:

Shkrimtarë mjekë artistë

profesionistë të fushave të ndryshme

Alba Malltezi  
Drejtoresh e Përgjithshme  
e Free and Fair Media Group

Anila Basha  
Drejtoresh e Shqiptarja.com  
Arben Rrozhani  
Kryeredaktor

Politika: Jakin Marena  
Ekonomia: Genc Kondi  
Kronika: Habjon Hasani

Sociale: Esmeralda Keta  
Kulturë: Admirina Peçi

Design: Altin Aliaj  
Genti Manelli  
Website: Suela Gera  
Indrit Maraku

Departamenti i Marketingut:  
Cel: +355696060419  
marketing@shqiptarja.com

Shpërndarja:  
Saimir Zenelaj  
cel: +355696060418  
Ermal Kacaniku  
cel: +355696088847